



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosova



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitina

***INFORMATË (RAPORT) PËR PUNËN E KRYETARIT TË KOMUNËS
JANAR – DHJETOR 2018***

PËRMBAJTJA

| | |
|------------------|---|
| Përmbajtja | 2 |
|------------------|---|

KAPITULLI I

| | |
|--|----------|
| Përmbledhje ekzekutive | 3 |
| - Fjala Hyrëse e Kryetarit të Komunës, z. Sokol HALITI | 3 |

KAPITULLI II

| | |
|---|----------|
| Raportet e Zyrave të Kryetarit | 6 |
| - Njësia e Auditimit të Brendshëm | 6 |
| - Njësia e Personelit | 8 |
| - Njësia e të Drejtave të Njeriut | 10 |
| - Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete | 10 |
| - Zyra për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar | 11 |
| - Zyra për Barazi Gjinore | 12 |
| - Zyra e Prokurimit | 13 |
| - Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun | 14 |
| - Zyra Ligjore | 15 |
| - Zyra e Avokatit Publik të Komunës | 15 |
| - Zyra për Integritet Evropian | 16 |
| - Zyra për Projekte | 17 |
| - Lektor | 17 |

KAPITULLI III

| | |
|--|-----------|
| Raportet e Drejtorive | 18 |
| - Drejtoria e Administratës | 18 |
| - Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim | 22 |
| - Drejtoria e Inspeksionit | 26 |
| - Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë | 33 |
| - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | 36 |
| - Drejtoria për Arsim | 47 |
| - Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit | 51 |
| - Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural | 54 |
| - Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi | 59 |
| - Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | 62 |

KAPITULLI I

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE: Fjala Hyrëse e Kryetarit të Komunës, Sokol HALITIT

I nderuar z.Kryesues i Kuvendit!

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit!

Të nderuar Drejtorë, Përfaqësues të Institucioneve të Komunës, Media dhe Shoqëri Civile!

Kam nderin dhe kënaqësinë, që sot para Juve të paraqes Informatën (Raportin) për Punën njëvjeçare të vitit 2018.

Në këtë informatë (raport), janë dhënë detajet e nevojshme të angazhimit tonë për periudhën paraprahe njëvjeçare, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës sonë. Fjalën time hyrëse e kam përpiluar në formë të një përmbledhje ekzekutive të informatës (raportit), gjersa për detaje dhe punët specifike sipas drejtorive dhe zyrave, ju lus t'i referoheni raportit në plotësinë e tij.

Që nga marrja e mandatit të qeverisjes sonë, të mirëfilltë dhe efektive, kemi qenë shumë të angazhuar dhe përkushtuar në mirëqenien e qytetarëve tanë, e që realisht Vitinë e kemi kthyer tanimë në një komunë meritore për qytetarët e saj. Mirëpo, sukseset tona të deritanishme, nuk kanë qenë pa sfida dhe pa barriera, siç edhe mund të paramendohet, por besoj, se sukcesi ynë më i madh, i përbashkët, ka qenë bashkëpunimi i Kryetarit dhe i Kuvendit me Qytetarët, ku kërkesat e tyre i kemi shndërruar në projekte investive të ndryshme, që ndikojnë në përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve.

Viti 2018 ishte vit i sukseseve, ishte vit i realizimit të programeve të mëdha në shumë fusha, mbi të gjitha vit i partneriteteve të Komunës me organizata mjaft të fuqishme vendore e ndërkombëtare.

Me bashkëpunim të ndërsjellë, me mirëkuptim dhe punë të palodhur, ne kemi arrit, që në vitin 2018 të realizojmë me sukses një sërë projektesh, që janë jetike për të ardhmen e Komunës së Vitisë.

Informata (raporti) që po e prezantojmë sot, përfshinë detaje nga këto të arritura dhe suksese të qeverisjes sonë me prioritetet, si në vijim:

- Rritja e efikasitetit në Administratë;
- Zhvillimi i bujqësisë;
- Shëndetësia, Arsimi, Kultura dhe Sporti;
- Infrastruktura lokale;
- Shërbimet publike;
- Zhvillimi ekonomik;
- Përkujdesja për shtresat e varfra dhe grupet e marginalizuara;
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile, donatorët dhe investitorët;
- Mbrojtja e ambientit dhe kualiteti i jetës.

Administrata:

- Drejtoria për Administratë, ka ofruar shërbime shumë kualitative për qytetarët.
- Janë lëshuar 51.984 dokumente.
- Numri i qytetarëve të cilët e kanë kryer verifikimin në gjendjen civile është 51292.

Bujqësia:

- Aplikimi i 2040 fermerëve për subvencione.
- Sektori i Bujqësisë, ka përcjellë procesin e korrje shirjeve në 5006 hektarë me grurë, mirëpo për shkak të kushteve atmosferike, rendimenti ka qenë më i ultë, 3800 kg për ha.

- Me 1 Gusht, është mbajtur panairi regjional "T'i ruajmë vlerat tona tradicionale", për nder të Ditës së Diasporës.
- Kanë përfunduar shumë fermerë, si në: serra, farë patatesh, makina bujqësore, 13 kiosqe, fidaneve të bimëve mjekuese aromatike.
- Vlera totale e investimeve në bujqësi, nga komuna, ministria dhe donatorët, është 1,297,883.8 €.
- Janë pyllëzuar 15 ha me pisha në Fshatin e Ri dhe 5 ha në Beguncë.

Arsimi:

- Ngritja e kapaciteteve në mësimdhënie dhe mësimnxënie si dhe krijimin e kushteve më të mira në shkolla.
- Përfundimi me sukses i procesit mësimor me rezultate të kënaqshme në testin e arritshmerisë dhe testin e maturës 75%.
- Renovimit të 14 objekteve shkollore me të hyra vetanake.
- Renovimin e çerdhes "Gëzimi Ynë", Viti.
- Vendosja e rrethojave në oborret shkollore.
- Rregullimi i parqeve dhe ambienteve në oborret e shkollave.
- Digjitalizimi i procesit mësimor, shpërndarja e llaptopëve, projektorëve, printer-copy.
- Inventarizim dhe rregullim i bibliotekave dhe kabinetet e informatikës.
- Ngritja profesionale e mësimdhënësve përmes trajnimeve, konferencave dhe seminareve.
- Rritja e bashkëpunimit me organizatat vendore dhe ndërkombëtare.
- Zhvillimi i shumë aktiviteteve jashtëshkollore dhe shënimi i datave të rëndësishme.
- Rekrutimi i personelit arsimor, bazuar në dispozitat ligjore ne fuqi.

Financa, Ekonomi dhe Zhvillim:

- Përgatitja e të gjitha projekteve kapitale;
- Inkasimi i tatimit në pronë 80%;
- Trajnimi i shumë bizneseve për menaxhim biznesi;
- Mbështetja e bizneseve për aplikim te donatorët;
- Mbështetja e investitorëve për investime në komunë.

Kulturë, Rini dhe Sport:

- Vazhdimi i palestrës sportive në Drobesh;
- Vazhdimi i renovimit dhe ndërtimit të stadiumit KF "Vitia";
- Renovimi dhe ndërtimi i stadiumit të KF "Vllaznia" në Pozheran;
- Ndërtimi i stadiumit ndihmës në Sadovinë të Jerlive;
- Ndërtimi i 8 fushave sportive në lokalitete;
- Shuma e subvencioneve për sport dhe rini për vitin 2018 është 52.175€.

Urbanizëm dhe Mbrojtje e Ambientit:

- Shqyrtimi i 16 kërkesave për leje ndërtimore;
- Shqyrtimi i 10 kërkesave për pëlqim urbanistik;
- Shqyrtimi i 9 kërkesave për kushte të ndërtimit;
- Viti 2018 është shpallur vit për pastrimin e ambientit;
- Shënimi i datave me rëndësi për pastrimin e ambientit;
- Vizita në teren;
- Aktivitete tjera kontinuele.

Shërbime Publike dhe Emergjenca:

- Ndërtimi i objektit të zjarrfikësve;
- Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit veror dhe dimëror;
- Eliminimi i deponive ilegale nëpër fshatra;
- Mirëmbajtja e kanalizimeve dhe ujësjellësve;
- Pastrimi i hapësirave publike;
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik;
- Dekorimi i qytetit;
- Inspektimi i objekteve publike dhe private nga inspektori i preventives ndaj zjarreve;
- Intervenime nga shërbimi i zjarrfikjes.

Shëndetësia:

- Promovimi i shëndetit përmes ligjëratave për qytetarët për sëmundje të ndryshme;
- Ofrimi i shërbimeve për qytetarët në mjekësinë primare dhe specialistike, ku numri i shërbimeve të ofruara për vitin 2018 është 421651;
- Janë mbajtur trajnime për stafin mjekësor dhe atë infermierik;
- Renovimi i disa hapësirave të QKMF-së në Viti;
- Renovimi i AMF-ve;
- Digjitalizimi i rëntgenit;
- Kompletimi i laboratorit me aparaturë medicinale;
- Vendosija e klimave në objektet shëndetësore;
- Rregullimi i ambientit të jashtëm në objektet shëndetësore.

Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi:

- Shqyrtimi brenda afatit ligjor i kërkesave të adresuara nga qytetarët, e që në numër janë 6000;
- Avancimi dhe modernizimi i shërbimeve kadastrale;
- Realizimi i të hyrave mbi 100%;
- Tërheqja e investimeve për çështje pronësore;
- Rindërtimi i informacioneve kadastrale në Pozheran, Sllatinë, Sadovinë e Jerlive dhe Zhiti.

Inspeksioni:

- Implementimi i të gjitha ligjeve në lëmin e inspektoratit;
- Inspektimi për ndalimin e ekonomisë jo formale për bizneset në Komunën e Vitisë;
- Inspektimi i kushteve sanitare dhe ushqimeve mbi cilësinë e tyre në të gjitha hipermarketet, marketet tregtare dhe bizneset tjera;
- Preventiva në kontrollin e sëmundjeve tek kafshët dhe asgjësimi i kafshëve të ngordhura në mënyrën më të mirë të mundshme;
- Vazhdimi i lirit të hapësirave publike për projektet komunale;
- Vazhdimi i sinjalistikës vertikale dhe horizontale për siguri në komunikacion;
- Kontrollimi i vazhdueshëm i ujit nëpër shkolla dhe për qytetarë.

KAPITULLI II

Raportet e Zyrave të Kryetarit

Njësia për Auditim të Brendshëm (NJAB)

Në kuadër të këtij Raporti të punës, Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB), për punën e vet është bazuar kryesisht në Planin strategjik 2018/2020, i cili ka siguruar bazën për hartimin e Planit vjetor të punës për vitin 2018, i cili përfshinë aktivitetet e auditimit të brendshëm të cilat do të përkufizojnë temën, fushëveprimin, objektivat dhe kërkesat e burimeve për zbatimin e secilës detyrë të auditimit.

Pikësnyimi kryesor i auditimeve ka qenë kryesisht vlerësimi i funksionimit të kontrollit të brendshëm, të ushtruar nga ana e menagjerëve të drejtorive komunale, lidhur me minimizimin e rreziqeve që kanë pasur të bëjë me realizimin e objektivave të drejtorive gjegjëse, si dhe respektimin e kërkesave ligjore për të arritur një siguri të arsyeshme mbi respektimin e bazueshmërisë ligjore gjatë procesit të të hyrave, shpenzimeve, ruajtjes së pasurisë komunale si dhe proceseve të tjera.

Sipas Planit vjetor të NJAB-së, për vitin 2018, kanë qenë të planifikuara të kryhen këto auditime, si vijon:

| Nr. | Njësia e synuar e auditimit | Indeksi rrezikut | Prioriteti | E planifikuar për vitin 2018 | Nr. i detyrës së auditimit |
|-----|---|------------------|------------|------------------------------|----------------------------|
| 1. | Procedurat e e-Prokurimit Publik; | 2.90 | Lartë | X | DSHS 18/01 |
| 2. | Menaxhimi i pasurisë në të gjitha organet buxhetore të Komunës /Vitisë; | 2.80 | Mesëm | X | DSHS 18/02 |
| 3. | Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim -Zyra e tatimit në pronë; | 2.72 | Lartë | X | DSHS 18/03 |
| 4. | Shpenzimet për mallra, shërbime komunale dhe subvencione në A. Komunale ; | 2.28 | Mesëm | X | DSHS 18/04 |
| 5. | Menaxhimi i personelit /Sistemi i pagave në Arsimit; | 2.20 | Mesëm | X | DSHS 18/05 |
| 6. | Të hyrat në Drejtorinë e Kadastrit, Gjeo dhe Pronës. | 2.13 | Mesëm | X | DSHS 18/06 |
| 7. | Menaxhimi i personelit /Sistemi i pagave në A.Komunale | 1.70 | Ulët | X | DSHS 18/07 |

Njësia e Auditimit të Brendshëm, sa i përket efikasitetit ka qenë afër realizimit të planit vjetor, sepse në O. Buxhetore për vitin 2018 ka lëshuar shtatë (7) Raporte finale për auditimet e kryera dhe një është në proces të përfundimit nga 7 sa ishin të planifikuara me planin vjetor të NJAB-it dhe atë si vijon:

| |
|---|
| <u>1. Auditimi Nr. DSHS-18/01</u> Tema e Auditimit: Të hyrat nga tatimi në pronën e paluajtshme për vitin 2017; |
| <u>2. Auditimi Nr. DSHS-18/02</u> Tema e Auditimit: Menaxhimi i personelit /Sistemi i pagave në Arsimit , për periudhën e vitit 2017 dhe 1/2018; |
| <u>3. Auditimi Nr. DSHS-18/03</u> |

| |
|--|
| Tema e auditimit: Shpenzimet për mallra, shërbime komunale dhe subvencione në A. Komunal periudhën 2017 dhe TM-1/2018v; |
| <u>4. Auditimi Nr. DSHS 17/04</u> Tema e Auditimit: <u>Procedurat e Menaxhimit të Pasurive jo financiare për periudhën TM-2/2017 deri 2/2018;</u> |
| <u>5. Auditimi Nr. DSHS 2018/05</u> Tema e Auditimit: Zbatimi i Procedurave të Prokurimit Publik për periudhën 30.09.2017 deri 30.09/2018; |

NJAB për secilin auditim të brendshëm ka dhënë të gjeturat kryesore, konkluzionet dhe rekomandimet.

Auditimet e kryera sipas vlerësimit të rrezikshmërisë:

Aktivitetet tona kanë qenë kryesisht në përmbushjen e planit vjetor të auditimit të paraparë për këtë vit. Me planin vjetor për vitin 2017, kemi planifikuar t'i kryejmë shtatë (7) auditime, kurse ne i kemi kryer pesë (5) auditime. Tri (3) prej tyre kanë qenë auditime me rrezikshmëri të lartë, dy (2) auditime me rrezikshmëri të mesme, kurse auditimi i gjashtë (6) është me rrezikshmëri të mesme dhe jemi në proces të përfundimit.

Arsyeja për mospërmbushjen e plotë të planit, ka qenë mosofrimi me kohë i dokumentacionit nga disa zyrtar, ku janë kryer auditimet dhe mungesa e stafit të duhur në NJAB.

Numri i rekomandimeve në raportet e auditimit/planet e veprimit dhe numri i rekomandimeve të zbatuara në periudhën raportuese:

- Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit që janë kryer është 22

Vlen të ceket se menaxherët e njëjësive audituese nuk na kanë dorëzuar planin e veprimit të menaxhmentit për adresimin e rekomandimeve tona, prandaj deri në hartimin e Raportit përfundimtar të NJAB-it për vitin 2018, ne do të rishikojmë zbatimin e rekomandimeve tona, ku do të njoftoheni për veprimet e marra të menaxhmentit të Drejtorive për nivelin e adresimit të rekomandimeve për vitin 2018. Prandaj, deri në rishikimin e adresimit të rekomandimeve të dhëna, ne konsiderojmë se adresimi i rekomandimeve është në proces të zbatimit.

Raportimet e NJAB-së dhe disa nga aktivitetet e tjera për zhvillimin e auditimit të brendshëm;

NJAB përveç auditimeve të kryera, ka kryer edhe punë të tjera si vijon:

- Raporti Vjetor i punës së NJAB për vitin 2018;
- Raporti për tremujorin TM-1/2018, gjashtëmujorin TM-2/ 2018. Këto raporte i janë dorëzuar Njësisë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), Kryetarit të Komunës dhe Komisionit për Auditim të Brendshëm, të gjitha janë dorëzuar brenda afatit kohor të paraparë me ligj.
- Stafi i NJAB-së, në mënyrë të veçantë ka pasur angazhime me të gjithë drejtuesit dhe zyrtarët të cilët me një formë ose tjetër kanë qenë të kyçur në procesin e shpenzimeve ,të hyrave dhe proceseve tjera ku janë kshilluar dhe u janë dhënë instruksione të nevojshme në procesin e menaxhimit të rreziqeve të cilat janë pengesë në përmbushjen e objektivave të tyre.
- Është bërë monitorimi i seancave punuese të Kuvendit Komunal. Ky monitorim ka pas për qëllim informativ për vendimmarrjet e Kuvendit Komunal, si dhe ndryshimet eventuale në legjislacionin e aplikueshëm.

- Gjatë auditimit të jashtëm që është kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) në organizatën tonë buxhetore për vitin 2017. NJAB ka pasur një bashkëpunim të ndërsjellë, ku nga aktiviteti i NJAB-it i është ofruar me kërkesën e tyre Plani vjetor 2018 dhe Plani Strategjik 2018/2020. Në të njëjtën kohë zyrtarëve të auditimit të jashtëm i janë dhënë Raporti vjetor për vitin 2017 dhe raportet tjera të kryera gjatë këtij viti. Poashtu janë dhënë edhe Raportet përmbledhëse për çdo tremujor të vitit 2018.

NJAB ka pasur bashkëpunim me ZKA me rastin e auditimit të ndërmjetëm Memorandumi i Auditimit për Komunën e Vitisë për vitin 2018 ku i është ofruar i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga ata gjatë procesit të auditimit.

- Ne vazhden e obligimeve vijuese të parapara sipas Ligjit të A.Brendshëm, Drejtori i NJAB ka hartuar edhe Planin vjetor për 2019 dhe Planin strategjik për vitin 2019/2021 i cili pritet të miratohet nga Kryetari i Komunës dhe Komiteti i Auditimit dhe brenda afatit ligjor një kopje i do ti dërgohet edhe NJQH-së të MEF-it në Prishtinë.

Marrëdhëniet e NJAB-it me Komitetin e Auditimit të Brendshëm (KAB):

Komiteti i Auditimit të Brendshëm (KAB), ka pasur për detyrë sipas Ligjit të Auditimit të Brendshëm, që të ketë së paku katër (4) takime, e më së shumti gjashtë (6) takime brenda një viti.

Kryetari dhe anëtarët e Komitetit të Auditimit (KA), në bashkëpunim me drejtorin e NJAB-it për këtë vit kanë mbajtur 3 takime me pikat e rendit të ditës, të shqyrtuara ashtu si parashihet edhe me praktikën ma të mira për funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Në këto mbledhje është mbajtur edhe procesverbali i këtyre takimeve, ku janë shqyrtuar të gjitha pikat e parapara në rendin e ditës, i përcaktuar nga kryetari i këtij Komiteti dhe në fund një kopje e këtij procesverbali i është dërguar kryetarit të Komunës, një kopje për NJAB dhe një kopje ka mbetur në dosjet e Komitetit të Auditimit.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, do të përgatit raportin vjetor për punën e tij për vitin 2018 dhe do të ia dorëzoj Kryetarit të Komunës.

Njësia për Personel

Gjatë periudhës kohore Janar – Dhjetor 2018, Njësia e Personelit ka kryer punët në bazë të kompetencave dhe autorizimeve të cilat dalin nga Ligji për Vetqeverisje Lokale, Ligji për Shërbimin Civil, Ligjin mbi Pagat, Ligjin mbi Administratën Shtetërore, Ligjin e Punës si dhe aktet tjera nënligjore, Statuti i Komunës dhe Vendimi mbi organizimin e organeve komunale dhe aktet tjera nënligjore, të cilat rregullojnë fushën e marrëdhënies së punës.

Njësia e Personelit vazhdimisht ka insistuar që të vuhet rendi në Administratën Komunale, duke iniciuar trajnime për shërbyesit civil, me qëllim të profesionalizimit të tyre dhe të rritjes së njohurive të tyre për punën dhe disiplinën në punë, me qëllim që në administratën komunale të ketë më pak shqiptim të masave disiplinore si dhe akuza të ngritura për vepra penale, shpërdorim i detyrës zyrtare. Njësia e Personelit, konform akteve të përmendura me lartë, së pari ka bërë rregullore, kjo e cila parasheh sistematizimin, gradimin e të gjithë shërbyesve civil në Administratën Komunale.

Njësia e Personelit, gjatë vitit 2018 ka bërë skenimin e dosjeve personale të shërbyesve civil dhe njeherit ka qenë obligative të emërtohen edhe çdo skenim me emrin e aktit, andaj është kërkuar kohë shumë e gjatë për ta bërë një veprim të tillë, pasi që ka dosje që ka më tepër se 30 dokumente.

Njësia e Personelit, përkundër të gjitha kërkesave që janë kërkuar nga ministrinë e ndryshme dhe agjencione, gjithmonë me kohe ju janë dërguar edhe raportet për të cilat janë kërkuar nga agjencionet e ndryshme rreth shërbyesve civil dhe politik.

| Nr. | Emri i aktit të lëshuar | Nr.i lëndëve të kryera |
|-----|---|------------------------|
| 1 | Mbajtja evidencave te pushimeve vjetore me kërkesa | 213 |
| 2. | Kërkesa MF-së për aprovim | 9 |
| 3. | Vërtetime mbi marrëdhënien e punës | 63 |
| 4. | Vërtetime të ndryshme për praktikantët të cilët i kanë në Administratën Komunale. | 8 |
| 5. | Shpallje të konkurseve | 10 |
| 6. | Formular mbi pagat | 52 |
| 7. | Formular për punëtor të rinj | 8 |
| 8. | Formular për ndryshime | 42 |
| 9. | Formular për pagesa retroaktiv | 0 |
| 10. | Intervistim me shkrim | 9 |
| 11. | Intervista me gojë | 9 |
| 12. | Përshkrimi i vendeve të punës | 9 |
| 13. | Fletëparaqitje disiplinore të bëra nga përgjegjësit kom | 3 |
| 14. | Ankesa të shërbyesve civil dhe qytetarëve | 11 |
| 15. | Kontrata me SH.V. për 4 muaj | 6 |
| 16. | Kompletim i dosjeve personale | 150 |
| 17. | Dërgimi i formularëve për deklarim te pasurisë për te këshilltaret | 43 |
| 18. | Formular për ndryshime, për ndërrim te llogarive rrje | 18 |
| 19. | Vendime për punëtorë të pensionuar parakohshëm | 0 |
| 20 | Aktemërimet | 9 |
| 21 | Vendim për largim nga puna ME VDEKJE | 0 |
| 22 | Vendim për pensionim të pleqërisë | 0 |
| 23 | Anulim te konkursit | 3 |
| 24 | Lëshime të vendimeve për të pensionuarit-Kompens page. | 0 |
| 25 | Kërkesa për MAPL-në për shpallje të konkursit | 11 |
| 26 | Konkurse me shërbime të veçanta | 3 |
| 27 | Raporte për MAP- 3mujorshe | 3 |
| 28 | Përgjigje në ankesë KPMK | 9 |
| 29 | Përgjigje në informata të kërkuara nga KPMK | 8 |
| 30 | Vendime të pushimeve të lehonisë | 0 |
| 31 | Vendime për rifillim te punës | 0 |
| 32 | Numri i përgjithshëm për vlerësimet e punës të shërbyesve civil | 138 |
| 33 | Transfer prej KK.Viti ne organizata tjera | 0 |
| 34 | Vendim te pensionimit te parakohshëm | 0 |

Njësia për të Drejtat e Njeriut

Funksionon në përputhje me legjislacionin sekondar-udhëzimin administrativ të MAPL-së nr. 2007/08.

Brenda kësaj periudhe, një prej aktiviteteve kryesore të NJDNJK, është organizimi i konferencës: Roli i shkollës në Edukimin për Barazi Gjinore dhe të Drejtat e Njeriut. Të pranishëm në këtë konferencë, ishin përfaqësues të USAID-it-Programi për të Drejtat Pronësore, udhëheqës komunal, drejtor të drejtorive, drejtor të shkollave dhe mësimdhënës, si dhe përfaqësues të organizatave e shoqatave të tjera që veprojnë në Komunën e Vitisë. Kryetari i Komunës së Vitisë Sokol Haliti, tha, se kjo ngjarje e cila na ka bërë bashkë sot, padyshim se është një ngjarje me rëndësi të madhe në aspektin e emancipimit të vet shoqërisë dhe të respektimit të Lirive themelore dhe të Drejtave të Njeriut. Në këtë konferencë, foli edhe Brian Kemple, drejtor për të Drejtat pronësore, projekt ky që financohet nga USAID-i amerikan, ndërkaq ka folur edhe Lirije Kajtazi, anëtare e komisionit për të Drejta të Njeriut dhe Barazi Gjinore të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe Merita Limani, Specialiste për Barazi Gjinore dhe të Drejta Pronësore, USAID PRP.

Kam diskutuar duke ofruar të dhënat dhe angazhimi i NJDNJK në Komunë në funksion të promovimit dhe mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut. Të pranishmit në këtë konferencë, në pjesën e dytë kanë parashtruar disa pyetje, ndërkaq në fund u konkludua se në aspektin e të drejtave të njeriut, është arrit progres, kurse ajo e të drejtave pronësore mbetet sfidë për të ardhmen.

Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete

Funksionon në përputhje me legjislacionin sekondar-rregulloren Nr.02/2010 për Zyrat Komunale Për Komunitetet dhe Kthim.

Komunitetet, në përputhje me Ligji Nr. 03/L-047, përkufizohen si grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare tradicionalisht të pranishme në Republikën e Kosovës të cilat nuk janë shumicë. Komuna e Vitisë, përmes kësaj zyre, mbron dhe promovon të drejtat e komuniteteve, siguron që të gjitha komunitetet të kenë qasje të barabartë në shërbimet publike si dhe krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar.

Aktivitetet e kësaj zyre, në vazhdimësi dhe gjatë kësaj periudhe raportuese, janë fokusuar në ofrimin e Këshillave dhe bashkëbisedime me pjesëtarët të komuniteteve, duke promovuar të drejtat e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Lista e aktiviteteve:

- Më 27 Qershor 2018, është mbajtur mbledhja e rregullt e Komitetit për Komunitetet me rendin e ditës: Ndërtimi i trotuarit Binçë-Viti Gjatë diskutimit për pikën në fjalë, është theksuar nevoja për përfundimin e trotuarit në drejtimin e “Moravës së Binçës” – fshati Binçë. Anëtarët e Komitetit, miratuan njëzëri një rekomandim, që komuna të vazhdon të ndërtojë trotuarin dhe të përfundojë projektin, sepse aktualisht nuk është i përfunduar rreth 600 metra drejt këtij fshati. U theksua shqetësimi, se mospërfundimi i këtij aksi me trotuar, përbën një rrezik, sepse të gjithë nxënësit e përdorin këtë rrugë deri në qytetin e Vitisë dhe anasjelltas.

- Më 29.06.2018, Ministria për Komunitete dhe Kthim, ka kërkuar informata për vështirësitë që përballen personat e zhvendosur, me theks kur ata kanë nevojë për të marrë dokumente personale në shërbimet komunale. Informatat janë kërkuar, me rastin kur të njëjtit marrin dokumentet e patentshoferit, dokumentacionin personal për arsim fillor dhe të mesëm. Grupi funksionon në kuadër të Grupit Teknik për zbatimin e Planit të Veprimit në kuadër të "Procesit të Shkupit".

- Më 19.07.2018, është mbajtur takimi i V i Komitetit për Komunitete të Komunës së Vitisë. Mbledhja diskutoi pikën e rendit të ditës: punësimin e pjesëtarëve të komunitetit pakicë në Komunën e Vitisë.
- Më 03.04.2018, kam pasur një takim me delegacionin e organizatës zvicerane "Terre des Hommes". Në këtë takim kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesi i komunitetit Ashkali, z.Rifat Aniçi. Takimi kishte të bëjë me krijimin e një grupi punues të përfaqësuesve të të gjitha komuniteteve minoritare nga Komuna e Vitisë. Grupi punues, do të adresonte problemet e këtyre komuniteteve, për më tepër do të bëheshin përpjekje për zgjidhjen e sfidave dhe problemeve eventuale nëpërmjet institucioneve, duke paraqitur më mirë këto probleme dhe duke zgjidhur ato në një mënyrë më të mirë.
- Më 08.10.2018, kam marr pjesë në takimin me përfaqësues të UNHCR-it nga Prishtina. Tema e takimit ishte, nëse komuna ishte në gjendje që të ofroj tokë komunale të kthyerve për të ndërtuar një shtëpi. Disa familje rome që kthehen nga Maqedonia janë në pyetje. Këto familje nuk kanë jetuar në komunën tonë para luftës. Iu është shpjeguar se ata duhet të flasin me kryetarin e komunës dhe se një vendim i tillë duhet të miratohet nga Kuvendi i Komunës së Vitisë. Në të njëjtën ditë, kemi pasur takim me përfaqësuesit e OSBE-së, Zyra në Viti. Përfaqësuesit e OSBE-së ishin të interesuar për bashkëpunim në mes të Zyrës së Kthimit me udhëheqjen e komunës, si dhe për kthimin e personave të zhvendosur.
- Më datë 03.09.2018, është mbajtur mbledhja e rregullt e VI e Komitetit për Komunitete me rendin e ditës: Shqyrtimi i pagave të punëtorëve të arsimit në sistemin e Republikës së Kosovës.
- Më 07.09.2018, është mbajtur punëtorja "Punëtori për Ngritjen e Ndërgjegjësimit mbi Procedurat e Trashëgimisë për Kroatët e Kosovës në Komunën e Vitisë". Në këtë takim morën pjesë z.Raif Fazliu, Gjyqtar i Gjykatës Themelore, noteri Naser Pajaziti, si dhe Fadil Hoxha, shefi i Kadastrit në Komunën e Vitisë.
- Më 21.09.2018, është mbajtur mbledhje e organizuar nga Ministria e Financave dhe OSBE-në, e cila u mbajt në hotelin "Emerald".
- Më 30 tetor 2018, është mbajtur mbledhja e VII e Komitetit Komunal për Komunitete, me rendin e ditës: punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë.
Njëzëri është bërë një rekomandim për t'i kushtuar më shumë vëmendje punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në organet komunale, me fokus në projektet e financuara nga bashkësia ndërkombëtare dhe qeveria qendrore.
- Më 13 nëntor 2018, kam marrë pjesë në punëtorinë për implementimin e Rregullores së re të Ministrisë së Kthimit në lidhje me themelimin e Komiteteve Komunale të Kthimit. Ky takim është mbajtur në Gjilan. Komisioni i Kthimit do të punojë në mënyrë të ngjashme me Komisionin e Riatdhesimit.
- Më 27 nëntor 2018. Projekti "Ndriçimi i Rrugëve në fshatin Binçë" u përfundua nga IOM përmes programit BE-CSP III. Projekti arriti në 14,496 €, nga të cilat Komuna e Vitisë ka marrë pjesë në vlerë financiare 2000 €.
- Më 30 nëntor 2018 është mbajtur mbledhja e VIII e Komitetit për Komunitetet. Në këtë mbledhje si pikë e veçantë ishte: Ndhima për komunitetin kroat. Pas diskutimeve, është përgatitur një rekomandim për të ndihmuar Komunitetin Kroat në formën e ndihmës me druve të zjarrit dhe një pako ushqimore bazë.

Zyra për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar

Procesi i Riintegrimit të personave të riatdhesuar ka vazhduar edhe në vitin 2018. Trendi i ardhjeve nga bota e jashtme e qytetarëve të Republikës së Kosovës edhe në këtë gjashtëmujorin e parë dhe të dytë është i ulët.

Zyra për Riintegrim ka proceduar këto lëndë sipas ardhjeve dhe kërkesave të parashtruara nga të riatdhesuarit.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2018 janë kryer këto aktivitete:

1. Janë riatdhesuar nga Gjermania me familje 5 kryefamiljar, (një çift bashkëshortor, tri familje 4 anëtarshë, një familje 6 anëtarshë); pa familje (kryesisht të pamartuar) 5 persona.
2. Nga Zvicra 1 person.
3. Nga Franca një familje 3 anëtarshë; 3 persona të pamartuar.
4. Nga shtetet e tjera-asnjë

Gjithsej të riatdhesuar gjatë këtij viti (deri më 12.12.2018) janë 32 persona.

Ndihmë-përfitues, bazuar në rregulloren 13/2017 janë:

- Banim përmes qirasë 2 familje (4 anëtarshë dhe 5 anëtarshë);
- Pako ndihmëse për dimër, 2 familje (4 anëtarshë dhe 5 anëtarshë);
- Trajtim mjekësor – s'ka;
- Rindërtim - renovim të shtëpisë – s'ka;
- Pakoja e orendive shtëpiake – s'ka;
- Kërkesa – 5;
- Përgjigje - 5

Komisioni Komunal për Riintegrim dhe Riatdhesim ka mbajtur 5 takime. Vendime janë gjithsej 4 (dy vendime për strehim të përkohshëm dhe pako dimërore dhe dy vendime janë refuzue kërkesat për ndihmë për përfitime Emergjente). Janë monitoruar 21 raste në lokalitete të ndryshme komunës sonë në bashkëpunim me zyrtarin e Zyrës Regjionale në Gjilan dhe zyrtarin e Zyrës së Punësimit në Viti, kryesisht familjet dhe personat e riatdhesuar që kanë qenë përfitues të programit për vetëpunësim. Monitorimi është bërë gjatë muajit Prill dhe maj, por edhe tetor dhe nëntor (të gjithë përfituesit janë monitoruar së paku nga 2 herë). Kanë përfillë (respektuar) rregulloren 13/2017 - 12 raste/familje. Nuk e kanë përfill (respektuar) rregulloren 13/2017 - 9 raste/familje.

Bashkëpunim me organizata, si: CRP/K-Programi për të Drejtat Civile në Kosovë, Partners Kosova, AWO-ja (organizatë që ndihmon të riatdhesuarit nga një regjion i Gjermanisë me seli në Nürnberg).

Takime me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Trajnime: 3 trajnime tre ditore me Partners Kosova dhe 2 trajnime dy ditore nga MPB.

Zyra për Barazi Gjinore

Në raport janë prezantuar aktivitetet të cilat pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara përgjatë vitit 2018, ku prej tyre veçojmë:

- Takime dhe tryeza me shoqërinë civile, OJQ-të, komunitetin e të rinjve për implementimin e ligjeve të aplikueshme në funksion të të barazisë gjinore (2 takime).
- Përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjes “Njih të Drejtat“ – prezantimi i të drejtave për trashëgiminë dhe pronën, konform ligjeve në fuqi, gjegjësisht LTK-së.
- Analiza gjinore dhe përgatitja e buxhetimit gjinor në kategoritë ekonomike: paga mëditje dhe subvencione.
- Sigurimi i të dhënave statistikore nga këto sfera:
 - zhvillim ekonomik;
 - punësim / mirëqenie sociale;

- shëndetësi;
 - procesin e vendimmarrjes.
 - Organizimi i trajnimit për buxhetim gjinor.
 - Dhënia e rekomandimeve në fushën e barazisë gjinore në përgjithësi për aktet normative komunale të aprovuara në KK përgjatë vitit 2018 (harmonizimi i tyre me ligjet që janë në funksion të barazisë gjinore).
 - Studim, analizë, raport për përkatësinë gjinore në arsimin e Komunës së Vitisë.
 - Organizimi dhe mbajtja e ligjëratave për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore, ku përfitues nga këto ligjëratë ishin 480 nxënës nga dy shkollat e mesme të larta të Komunës së Vitisë.
 - Trajnim për riintegrimin e viktimave të dhunës në familje me Mekanizmin Koordinues kundër Dhunës në Familje.
 - Fillimi i realizimit të projektit “Transformimi i mundësive ekonomike të grave” në partneritet me organizatën Partners Kosova (projekt trevjeçar).
 - Fuqizimi ekonomik i grave (bizneseve për vetëpunësim) përmes ndarjes së garantëve për zhvillimin e bizneseve (biznese për përpunimin e ushqimit), në partneritet me UNDP.
 - Realizimi i projektit për të drejtat pronësore (trashëgiminë pronësore të grave) në partneritet me USAID-in (Projekt trevjeçar).
 - Bashkëpunimi me Avokatin e Popullit për të pranuar ankesat e qytetarëve të Komunës së Vitisë për shkelje të të drejtave të njeriut nga institucionet.
- Si dhe aktivitete tjera kontinuele.

Zyra për Prokurim

Zyra e Prokurimit, në kuadër të aktiviteteve dhe përgjegjësi të veta të zhvilluara, bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik, ka përmbledhur aktivitetet e prokurimit të zhvilluara për ofrimin e shërbimeve, plotësimin e nevojave të komunës, sipas kërkesave të njëjësive shpenzuese, si dhe për realizimin e investimeve kapitale të planifikuara për vitin 2018.

Gjatë vitit 2018, janë zhvilluar 67 aktivitete të prokurimit, prej të cilave 17 aktivitete me lëndë prokurimi, Shërbime, 18 aktivitete me lëndë prokurimi, Punë dhe 32 me lëndë prokurimi, Furnizime. Duke shtuar se ZP-ja ka kryer edhe 9 aktivitete, janë zhvilluar si procedura me vlerë minimale, te cilat në të shumtën lidhen me furnizime të vogla, por të domosdoshme për kryerjen e funksioneve të komunës dhe njëjësive të saja shpenzuese.

Prej këtyre aktiviteteve, 62 aktivitete të prokurimit janë përmbyll me procedura dhe janë finalizuar me nënshkrimin e kontratave. Ndërsa 3 aktivitete janë procedurë e sipër, ndërsa dy aktivitete janë në OSHP në procedurë e sipër; (mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve dhe mirëmbajtja dhe pastrimi i hapësirave gjelbëruese, parqeve, lumit dhe varrezave të Dëshmorëve në qytetin e Vitisë).

Zyra e Prokurimit ka proceduar pagesa për Operatoret Ekonomik që kanë kryer punë, furnizime apo shërbime sipas kontratave që kanë me komunën tonë. Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar 1070 urdhërbërje për pagesën e OE të kontraktuar, janë udhëhequr lëndët për kompletim dhe janë dërguar në thesar për pagesë.

Zyra e Prokurimit gjatë vitit 2018, ka kryer punë dhe shërbime të ndryshme sipas kërkesave dhe nevojave të të gjithë njëjësive shpenzuese, duke ofruar këshillime dhe shërbime profesionale, me qëllimin e mbarëvajtjes së punëve në komunë, gjithmonë duke u thirrur dhe respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

Shuma e planifikuar për vitin 2018, bashkë me Memorandumet e nënshkruara gjatë vitit janë 4,866,433.47 €, ndërsa Shuma e kontratave të lidhura është 3,503,747.10 €.

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Gjatë vitit 2018, respektivisht periudhës janar-dhjetor, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun e Komunës së Vitisë, ka qenë e angazhuar në informimin sa më objektiv dhe të shpejtë për zhvillimet aktuale të Institucioneve komunale.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer këto punë:

- Organizuar takime me media;
- Janë përcjell mbledhjet e bordit të drejtorëve;
- Aktivitetet e kryetarit të komunës, solemnitete e manifestime si dhe përrurime projektesh nga terreni i komunës sonë për të njoftuar publikun e gjerë për zhvillimet e gjithmbarshme në Komunën e Vitisë. Gjitha këto ngjarje janë pasqyruar në publikim në Web faqen e komunës kk.rks-gov.net/viti si dhe në adresën e komunës së Vitisë në rrjetin social Facebook.
- Që nga muaji janar i këtij viti, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, ka bartur gjitha të dhënat prej vitit 2010 deri në 2018 nga Web faqja e vjetër në Web faqen e re.
- Zyra për Informim Publik, për gjatë 12 muajve të këtij viti, ka organizuar 8 konferenca shtypi me gazetar, ku është prezantuar puna e drejtorive komunale.
- Zyra për Informim Publik, në vazhdimësi ka njoftuar opinionin e gjerë më zhvillimet aktuale përmes Web faqes zyrtare: kk.rks-gov.net/viti, në të cilën janë postuar lajmet ditore, ndërsa njoftimet, shpalljet e konkurset e ndryshme të institucioneve komunale të Vitisë, janë bërë publike në bashkëpunim me zyrtarin e IT-së.
- Një bashkëpunim të ndërsjellët dhe shumë të mirë, kemi pasur me mediat lokale dhe ato qendrore. Përmes adresave elektronike, gjitha mediave të shkruara, elektronike dhe agjencive të lajmeve u janë dërguar lajmet për ngjarjet nga komuna e Vitisë edhe përmes fotografive.
- Zyra për Informim Publik, ka qenë e angazhuar në marrjen e shtypit ditor të gazetave kosovare, analizimin e shkrimeve që kanë të bëjnë me Vitinë dhe ato t'i kopjoj dhe arkivoj. Gjithashtu ato në vazhdimësi i janë prezantuar zyrës së kryetarit.
- Zyra për Informim Publik ka përcjell gjitha aktivitetet e kryetarit të komunës, apo edhe zyrtarëve të tjerë komunal në terren.
- Pritjen e delegacioneve vendore dhe të huaj në komunën tonë.
- Po ashtu është kujdesur për shkrimet e botuara në gazeta dhe agjensionet e lajmeve për saktësinë e shkrimit dhe në raste të caktuara të reagoj apo sqaroj opinionin e gjerë për informatën e caktuar.
- Zyra për Informim Publik, ka përcjell gjitha seancat e Kuvendit Komunal, ku është përkujdesur për teknikën e zërimit në sallë si dhe ka bërë incizimin e mbledhjeve.
- Zyra për Informim Publik ka përcjell edhe gjitha mbledhjet e Komitetit për Politik e Financa për të cilat ka njoftuar edhe gazetarët.
- Seancat e Kuvendit janë incizuar dhe transmetuar në mediat lokale na bazë të kontraktimit me to dhe Zyra për Informim i ka monitoruar gjatë transmetimit.
- Zyra për Informim është angazhuar edhe në përgatitjen e reportazhit për punën njëvjeçare të Institucioneve komunale, ku përfshihen projektet e realizuara gjatë këtij viti.
- Në kuadër të zyrës janë bërë specifikimet e shpenzimeve për publikime: Shpallje, Konkurse, tenderë, Njoftime etj.

- Ndërkaq në kuadër të punës së Zyrës për Informim Publik, edhe pse ende vazhdojnë të vijnë kërkesa për qasje në dokumente publike, me që edhe dy javë janë deri në fund të vitit (nga koha kur po e bëjmë raportin e punës) janë pranuar 33 Kërkesa për Qasje në Dokumentet Publike, prej tyre 2 janë të refuzuara kurse 31 janë të lejuara.

Zyra Ligjore

Bazuar në dispozitat ligjore, neni 74, pika d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, lidhur me dispozitat ligjore neni 46 të vendimit të Kryetarit të Komunës për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës Komunale, Zyra Ligjore në kuadër të ushtrimit dhe përgjegjësi, autorizimeve si dhe në funksion të zbatimit të ligjeve dhe akteve me fuqi nën-ligjore, gjatë vitit 2018 ka bërë një punë cilësore, duke kryer harmonizimin dhe korrigjimin e akteve nënligjore të propozuara nga Kryetari i Komunës dhe nga drejtorët e drejtorive si dhe hartimin e rregulloreve që janë në kompetencë të Komunës sipas ligjit mbi vetëqeverisjen lokale Nr.03/L-040.

Zyra Ligjore për vitin 2018 ka harmonizuar bazën ligjore të këtyre dokumenteve:

- 10 propozime vendime;
- 33 vendime;
- 4 propozim rregullore;
- 19 përgjigje në kërkesa dhe ankesa;
- 22 interpretime ligjore;
- 2 memorandume mirëkuptimi.

Zyra për Avokatin Publik të Komunës

Avokati publik i Komunës funksionin e vet e kryen në bazë të Kushtetutës dhe Ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës, si dhe në bashkëpunim me të gjitha instancat gjyqësore.

Avokati publik i Komunës e përfaqëson Komunën në të gjitha instancat gjyqësore, duke filluar nga Gjykata Themelore e deri në Gjykatën Kushtetuese në kontestet gjyqësore qofshin ato penale apo civile. Avokati publik përfaqëson Komunën, në të gjitha fazat, për të gjitha çështjet kontestuese për të cilat Komuna na paraqitet si palë ndërgjyqësore.

Për vitin tani për të cilën po raportojmë janar-dhjetor-2018, avokati publik i Komunës ka kryer këto punë:

Lëndët e regjistruara gjyqësore për vitin për të cilën tani që po raportojmë, të të gjithave procedurave gjyqësore, janë **74 lëndë të regjistruara**, **37** lëndë janë lëndë nga procedura civile në procedurë kontestimore të natyrave të ndryshme, **3** lëndë janë të procedurës jashtëkontestimore dhe **22** lëndë janë të procedurës penale, për të cilat lëndë janë ushtruar kallëzime penale, të cilat sipas detyrës zyrtare i udhëheqë prokurori i shtetit. 6 lëndë edhe këto të natyrës kontestimore me bazë juridike pagesa pas pensionimit e 3 pagave jubilarë dhe 3 paga përcjellëse.

Prej lëndëve kontestimore në procedurën civile, të cilat në numër janë **37**, ku avokati kundër këtyre lëndëve ka ushtruar **29** përgjigje në padi, kundër paditësve dhe 9 padi të gjitha këto lëndë janë duke u zhvilluar në procedurë gjyqësore, ndërsa nga lëndët e bartura nga vitet paraprake të cilat janë përfunduar me aktvendim, aktgjykim të formës së prerë janë 8 lëndë të përfunduara në këtë periudhë për të cilin po raportojmë Janar-Dhjetor-2018. Ndërsa 37 lëndët kontestimore, civile të cekura më lartë për periudhën tani që po raportojmë për vitin 2018, këto lëndë janë të gjitha në procedurë gjyqësore, disa janë në

procedurë të shqyrtimit, disa janë duke u zhvilluar me mjete juridike të **rregullta**, me ankesë, ku kemi ushtruar 12 ankesa, 14 prapsime dhe me mjete të **jashtëzakonshme** në instancat më të larta gjyqësore. Ndërsa 22 lëndët penale për veprat penale për uzurpime të pronës komunale shtetërore nga neni 332 parag.1 i KPRK-ës, që sipas detyrës zyrtare i udhëheq Prokurori i Shtetit. Të gjitha këto janë në procedurën e shqyrtimit gjyqësorë, ndërsa lëndë penale të bartura nga vitet paraprake në vitin 2018 për të cilin po raportojmë janë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë 9 lëndë .

Për periudhën që tani po raportojmë Avokati publik ka pranuar nga gjykatat tona edhe 6 lëndë kontestimore me padi, ku paditësit janë punëtorët e pensionuar gjatë viteve paraprake, ku të njëjtit me kërkespadi kërkojnë pas pensionimit edhe nga 6 paga, tri paga jubilarë dhe tri paga përcjellëse pas pensionimit. Meqenëse Komuna e Vitisë nuk ka mjete të ndara nga Qeveria e Kosovës për këto pagesa pas pensionimit të punëtorëve të saj, andaj avokati i Komunës, duke u bazuar në këto arsye ne kemi ushtruar 6 përgjigje në padi të natyrës së këtillë, duke i kundërshtuar nga arsyet e sipërcekura. Të gjitha këto lëndë janë në procedurë gjyqësore. Lëndët civile që kanë të bëjnë me kontestet e punës të regjistruara janë 2, lëndë e që janë në procedurën gjyqësore ku Komuna e Vitisë paraqitet si paditëse në Gjykatën themelore në Prishtinë –departamenti administrativ. Ndërsa lëndët që I përkasin procedurës jashtëkontestimore, që fillojnë me propozim, të cilat kanë të bëjnë me gjetjen - rregullimin e sinorëve - mexhave tokësore të paluajtshmërive, për kohën që po raportojmë fatmirësisht nuk kemi (-).

Sa i përket mjeteve të jashtëzakonshme, Revizioni, Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe propozimi për përsëritjen e procedurës, qoftë në procedurë penale, apo civile, të cilat ushtrohen vetëm kundër aktvendimeve, aktgjykimeve të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës. Komuna e Vitisë për këtë që po raportojmë ka ushtruar 2 revizione, 1 përgjigje në revizion për të cilat ende nuk kemi vendime, aktgjykime nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.

Meqenëse nëpër gjykatat tona ka shumë lëndë të cilët kërkojnë zgjidhje, ende nuk janë treguar për shqyrtim kryesor për shkak të të numrit të madh të lëndëve që kërkoj shqyrtim, 33 lëndë të viteve paraprake janë bartur për shqyrtim në vitin që po raportojmë 2018, të cilat ende janë duke u zhvilluar në procedurë gjyqësore, në të gjitha instancat gjyqësore, në bazë të mjeteve të rregullta juridike, dhe mjeteve të jashtëzakonshme juridike, të cilat i cekem edhe më lartë, të cilat në tërësi janë lëndë kontestimore, civile të natyrave të ndryshme.

Zyra për Integritet Evropian

Zyra Komunale për Integritet Evropian, zyrtari për integritet evropian gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2018, ka kryer këto aktivitete:

1. Kemi profilizuar Planin Kombëtar për Integritet Evropian 2018 dhe iu ka rekomanduar Zyrës së Kryetarit të Komunës, Zyrës së Kryesuesit të Kuvendit, drejtorive komunale dhe zyrave ndihmëse të Kryetarit të Komunës, për plotësimin e objektive që dalin nga Plani Kombëtar për Integritet Evropian 2018.
2. Kemi mbajtur takim njoftues me Zyrën e Kryetarit të Komunës, Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit, drejtoritë komunale dhe zyrat ndihmëse të Kryetarit të Komunës
3. Kemi marrë pjesë në Raportin e parë për financimin publik të OSHC-ve, në Republikën e Kosovës.
4. Kemi marrë pjesë në takimin e Kolegjiumit të ZKI-ve, me AKK dhe MAPL-në.
5. Kemi përcjell punimet e takimeve të KPF-së.
6. Kemi përcjell punimet e seancave të Kuvendit të Komunës .

7. Kemi marrë pjesë në komisionin për riintergrim, në bordin e drejtorve.
8. Kemi udhëhequr me komisionin për hapjen e kutive të ankesave ,si dhe një varg aktivitete të ndryshme të organizuar nga Kryetari i komunës,dhe drejtoritë përkatëse.

Zyra për Projekte

Bazuar në detyrat e punës nga Zyra e Kryetarit të Komunës dhe kërkesat e Zyrës së Projekteve gjatë periudhës Janar - Dhjetor të vitit 2018, kemi punuar në hartimin e projekteve, raporteve të pranimit të tyre dhe mbikëqyrjes së zbatimit të projekteve.

Përveç hartimit të projekteve të lartpërmendura, kemi kryer edhe këto punë, si:

- hartimin e detyrave projektuese;
- Pranimin teknik të hartimit të projekteve të ndryshme;
- Pranime teknike të projekteve të përfunduara;
- Komisione të ndryshme për vlerësim;
- Menaxhimi i zbatimit të projekteve.

Angazhime tjera shtesë sipas kërkesave të menagjmentit.

Lektori

Gjatë periudhës kohore Janar - Dhjetor 2018, si lektor i Komunës dhe i Kuvendit të Komunës së Vitisë, kam kryer punë dhe detyra të punës sipas përgjegjësisë zyrtare dhe përshkrimit të detyrave të vendit të punës. Kam lekturuar dokumente zyrtare për Zyrën e Kryetarit, për Kuvendin e Komunës, për drejtoritë, për njësitë dhe zyrat komunale etj.

Gjatë periudhës kohore Janar – Dhjetor 2018 kanë lekturuar këto dokumente:

1. Informata vjetore e Kryetarit të Komunës me drejtorit komunale 2017; Informatë për punën e Kryetarit të Komunës për periudhën Janar – Qershor 2018, vendime, fjalime, Vitia rreth agjendës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm.
2. Konkursët e DKA-së, si: 13.02.2018; 21.03.2018; 23.04.2018; 11.05.2018; 25.07.2018; 13.08.2018; 01.09.2018; 02.10.2018; 09.10.2018; 20.11.2018; rinjoftim për shprehje interesi; Propozim rregullorë për mbledhjen dhe shpenzimin e të hyrave vetanake nga arsimi dhe aftësimi për të rritur.
3. Propozim vendimet e kadastrit, si: 15.02.2018; 11.04.2018; propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të parkingjeve.
4. Kërkesat DSHMS-në, si: 13.03.2018; 14.03.2018.
5. Vendimet e DSHPE-së, si: 08.03.2018; 08.03.2018.
6. Konkursët e Njësisë së Personelit, si: 02.02.2018 (2).
7. Zyra Ligjore, kontratën e datës 07.06.2018.
8. Procesverbalet e Këshillit të Drejtorëve, procesverbali I, II, III, IV, V.
9. Procesverbalet e Kuvendit Komunal, procesverbali I, II, III, IV dhe V, VII, VIII, IX, X si dhe procesverbalet e mbledhjeve solemne. Vendimet e Kuvendit: 26.07.2018 (6); 30.08.2018 (4); 27.09.2018; 31.10.2018 (2); 03.12.2018 (4), njoftim 24.09.2018, rregullorë 26.07.2018.
10. Procesverbalet e KPF-së, procesverbali I, II, III, IV dhe V, VII, VIII, IX, X, XI; ftesë 16.10.2018.
11. Procesverbalet e KKS-së, mbledhja I, II, III, IV, V.
12. Procesverbalet e komitetit për Komunitete, procesverbali I dhe II, IV, VII.

Gjithashtu kam ndihmuar edhe gojarisht zyrtarët sipas ndonjë kërkesë me gojë që më është shtruar dhe kam kryer punë shtesë.

KAPITULLI III

Raportet e Drejtorive

Drejtoria për Administratë

Misioni i Drejtorisë për Administratë është zbatimi i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, ligjeve tjera që aplikohen në Administratë, Udhëzimet Administrative të nivelit qendror, Statutit të Komunës së Vitisë dhe akteve tjera komunale të aprovuara nga Kuvendi i Komunës.

Shërbimet e përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera të kësaj drejtorie përfshijnë:

- Ofrimi i shërbimeve dhe kryerja e punëve administrative mbështetëse për punën e Kuvendit të Komunës, trupave të Kuvendit të Komunës dhe Këshillit të Drejtorëve.
- Përgatitja e akteve të cilat i nxjerr Kryetari i Komunës, Këshilli i Drejtorëve.
- Harton propozim rregullore, propozim vendime në fushën e Administratës.
- Kujdeset për përkthimin e materialeve të Kuvendit, trupave të kuvendi dhe Këshillit të drejtorëve duke respektuar gjuhët zyrtare.

Drejtoria e Administratës, ka realizuar objektivat të cilat dalin nga Plani i Punës së Drejtorisë për vitin 2018.

Drejtoria për Administratë ka hartuar planin e veprimit për muajt Korrik dhe Gusht 2018 për arsye të kryerjes së shërbimeve administrative për bashkatdhetarët që vijë nga bota e jashtme për pushime verore.

Në vazhdim do të paraqesim punën e sektorëve të kësaj drejtorie.

I. SEKTORI PËR PUNË ADMINISTRATIVE

Sektori për punë administrative ka kryer punët dhe detyrat e punës për nevojat e Kuvendit të Komunës së Vitisë, kryetarit të Komunës, Këshillit të Drejtorëve dhe drejtorit të Drejtorisë për Administratë.

Ky sektor ka përgatit ftesat dhe materialet tjera për mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, Këshillit të Drejtorëve, Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, etj. Kuvendi i Komunës ka mbajtur 11 seanca të rregullta dhe 6 seanca solemne, 2 të jashtëzakonshme dhe 0 inauguruese. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta. Komiteti për komunitete ka mbajtur 9 mbledhje dhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur 7 mbledhje të rregullta.

Kuvendi i komunës ka miratuar 6 rregullore dhe 59 vendime të ndryshme. Të gjitha këto akte normative të Kuvendit janë përgatit për procedurë për nënshkrim dhe protokollim dhe janë dërguar në Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal për vlerësim të ligjshmërisë së këtyre akteve. Janë përgatit 11 procesverbale të seancave të Kuvendit të Komunës, 12 procesverbale të Komitetit për Politikë dhe Financa, 9 procesverbale të Komitetit për Komunitete, dhe 7 procesverbale të KKS-së.

Gjatë kësaj periudhe raportuese Këshilli i Drejtorëve ka mbajtur mbledhje konsultative javore dhe mbledhje të rregullta, ku janë shqyrtuar materialet të ndryshme të cilat janë përcjellë për shqyrtim dhe aprovim në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin Komunal. Për mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve është përgatit materiali si dhe janë hartuar procesverbale për këto mbledhje.

Për nevojat e Kryetarit të komunës për këtë periudhë raportuese janë hartuar gjithsejtë 389 dokumente. Prej tyre 70 vendime, 22 Marrëveshje të ndryshme, kërkesa dhe shkresa të ndryshme. Vendimet e hartuara janë të natyrave të ndryshme: Propozim vendime për kuvend, të ndarjes së ndihmave financiare,

vendime për formimin e komisioneve të ndryshme për pranimin e mallit, vendime për caktimin e menaxherit për mbikëqyrjen e punëve, vendime për pranimin teknik të punëve, etj.

Zyrtari për përkthim ka përkthye në mënyrë simultante në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, Komitetit për Politikë dhe Financa, Këshillit për Siguri në Bashkësi, Komitetit për Komunitete dhe Këshillin e Drejtorëve. Gjithashtu ka përkthye edhe të gjitha materialet të cilat kanë dal nga mbledhjet e Kuvendit, KPF, KKSBB, Komitetit për Komunitete dhe Këshilli i Drejtorëve.

II. SEKTORI I GJENDJES CIVILE

Në vazhdim po e paraqesim numrin e dokumenteve të lëshuara nga Sektori i Gjendjes Civile për periudhën Janar –Dhjetor 2018:

| Nr. | Përshkrimi I Lëndëve | Totali |
|-----|---|---------------|
| 1 | Ekstrakt Lindje | 21539 |
| 2 | Çertifikata Lindjes | 12436 |
| 3 | Çertifikata martesës | 4604 |
| 4 | Çertifika e Vdekjes | 2058 |
| 5 | Çertifikata Vendbanimi | 1172 |
| 6 | Çertifikata e Bashkësisë familjare | 5045 |
| 7 | Çertifikata e Statusit Martesor | 1004 |
| 8 | Çertifikata e Shtetësisë | 718 |
| 9 | Vërtetim nga Arkivi | 1256 |
| 10 | Vendimet | 276 |
| 11 | Aktvdekjet | 206 |
| 12 | Vërtetim i Mjeteve | 58 |
| 13 | Vizita | 50 |
| 14 | Regjistrimet në LAL të jashtme | 354 |
| 15 | Regjistrimet në LAL të brendshme | 0 |
| 16 | Regjistrimet në LAV (vdekje të jashtme) | 75 |
| 17 | Regjistrimet në LAV (vdekje të brendshme) | 157 |
| 18 | Regjistrimet në LAM të jashtme | 121 |
| 19 | Kurorëzime të reja | 455 |
| 20 | Shkurorëzime | 62 |
| 21 | Humbje Shtetësisë | 82 |
| 22 | Totali: | 51.984 |

Numri i përgjithshëm dokumenteve të lëshuara për periudhën Janar – Dhjetor 2018 është **51984** dokumente. Numri i qytetarëve të cilët janë futur në sistemin e Gjendjes Civile në Komunën tonë është **51292**. Efikasiteti dhe azhureteti i punës në Sektorin e Gjendjes Civile kishte me qenë edhe më i madh po të mos mungonte hapësira e nevojshme për punë.

III. SEKTORI I ZYRES PRITËSE DHE ARKIVIT

Zyra Pritëse dhe Arkivit në kuadër të aktiviteteve të saj të cilat i ka kryer për këtë periudhë raportuese për vitin 2018 janë, si: regjistrimin e të gjitha kërkesave dhe parashtrësive, shërbimet postare për organet e Administratës Komunale, ofrimin e ndihmës juridike qytetarëve për plotësimin e kërkesave dhe regjistrimin e kërkesave në protokoll.

Numri i kërkesave të pranuar në zyrën pritëse është paraqit në formë tabelare.

| | |
|---|---|
| Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Vdekurve -L.A.V nga jashtë dhe brenda | 1 |
| Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Martuarve -L.A.M nga jashtë | 1 |
| Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Lindurve -L.A.L nga jashtë | 4 |
| Numri i kërkesave në zyrës pritëse nga Shtetet e jashtme si : LAL, LAM dhe LAV | |
| TOTALI - 815 | |
| Deklaratat e nxjerra pran zyrës pritëse : | |
| Deklarata për vendqëndrim | |
| Deklarata për trashëgimi | 2 |
| Deklarata për përkujdesje financiare | |
| Deklaratë për regjistrimin në LAL | |
| Deklarata për regjistrim në LAV | 9 |
| Gjithsejtë: | |

Lëndët e arkivuara

| Drejtoritë | Nr. i lëndëve arkivuara |
|---|-------------------------|
| Drejtoria për Shërbime Publike dhe emergjencë | 377 |
| Drejtoria për Administratë | 41.156 |
| Drejtoria për Arsim | 597 |
| Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural | 114 |
| Drejtoria për Financa Ekonomi, dhe Zhvillim | 9.191 |
| Drejtoria për Kulturë , Rini dhe Sport | 403 |
| Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mjedisit | 188 |
| Drejtoria e Inspeksionit | 168 |
| Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | 999 |
| Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër | 8.296 |
| Kuvendi i Komunës | 31 |
| Zyra e Kryetarit | 389 |
| Zyra për Komunitete | 8 |
| Totali | 61.917 |

IV. SEKTORI I ADMINISTRIMIT

Ky sektor përfshin shërbimet që kanë të bëjnë me mbështetjen logjistike të organeve të administratës dhe atë:

- Kujdesit për mirëmbajtjen e auto-veturave zyrtare të organeve të administratës, sigurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve komunale.

Vërejtje: Për pune me efikase dhe menaxhim me te suksesshëm ne këtë sektor, duhen të bëhet renovimi i objekteve komunale, autoparkut dhe krijim i hapësirave të nevojshme për punë.

Në vazhdim po i prezantojmë shpenzimet e mirëmbajtjes, karburanteve dhe shpenzime tjera për automjete dhe gjeneratorë për periudhën Janar – Dhjetor 2018.

Shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve dhe gjeneratorëve për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë për periudhën raportuese janë 24.669,00 euro.

- Administrata.....9.660,00€,
- Shëndetësia7.530,00€, dhe
- Njësia e zjarrfikëseve7.479,00€

Shpenzimet për derivate të naftës për automjete, nxehe qendrore, gjenerator dhe autorizime për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë janë 58.972.00 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për automjete, për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Vitisë janë 43.729 litra.

- Administrata23.939 litra,
- Shëndetësia12.584 litra, dhe
- Njësia e zjarrfikës7.206 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për nxehe qendrore për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë janë 13123 litra naftë.

- Administrata10172 litra
- D. Kulturës1191 litra
- Shëndetësia1760 litra,
- Njësia e zjarrfikësve 0 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për gjenerator për të gjitha njësit shpenzuese janë: 2121 litra.

- Administrata1426 litra,
- Shëndetësia 143 litra,
- Njësia e zjarrfikësve217 litra.
- Dka-ja (shkollat).....335 litra.

Zyra e IT-së ka udhëhequr dhe kontrolluar punën e sistemit të teknologjisë informative me qëllimin e zbatimit të standardeve dhe ofrimin e shërbimit më cilësorë, në veçanti:

- Ka zbatua hardware, softwerin Kompjuterik dhe të qasjes me internet.
- Mirëmbajtjen e infrastrukturës për internet dhe kyçje sipas nevojave të ndryshme për organet komunale.

Për periudhën 03.01.2018 e gjerë më 31.12.2018

| Nr. | Emërtimi | Nr. Intervenimeve | Vërejtje |
|-----|--|-------------------|----------|
| 1 | Risetimi password të Domenit | 160 | |
| 2 | Hapja e Userve të Domenit | 20 | |
| 3 | Hapja e Userave të Intranetit | 18 | |
| 4 | Intervenimet në Usera | 95 | |
| 5 | Intervenimet në rrjetin qeveritar | 33 | |
| 6 | Intervenimet në programe | 82 | |
| 7 | Konfigurimi i swiqit | 5 | |
| 8 | Intervenimet në Gjendjen Civile | 17 | |
| 9 | Intervenimet në Tatimin Pronë | 30 | |
| 10 | Futja e kompjuterëve në Domen | 60 | |
| 11 | Instalimi i software | 80 | |
| 12 | Instalimi i compjuter hardware devices | 80 | |
| 13 | Rregullimi kablllove të internetit | 30 | |

| | | | |
|---|--|-------------|--|
| 14 | Intervenimet në E-mail | 140 | |
| 15 | Hapja E-mail Zyrtar të reja për zyrtar Komur | 58 | |
| 16 | Intervenimet në Intranet | 55 | |
| 17 | Monitorimi i Kuvendit përmes Teleprezencës | 12 | |
| 18 | Drejtoria Arsimit | 16 | |
| 19 | Qendra për punë sociale | 22 | |
| 20 | Telefonave VOIP | 5 | |
| 21 | Skanimi kompjuterëve nga viruset | 15 | |
| 22 | Intervenimet ne Shtëpinë e Kulturës | 50 | |
| 23 | Vizitë në Komunën e re vendosja server njohjen e Kartelave Identifikuese | 3 | |
| Gj i t h s e j t ë | | 1056 | |
| 1. Mirëmbajtja e Serverit çdo ditë 2. Mirëmbajtja e Intranetit çdo ditë 3. Mirëmbajtja e webfaqes çdo ditë 4. Mirëmbajtja e Gjendjes Civile çdo ditë 5. Mirëmbajtja e pasurisë çdo ditë 6. Sistemi për Menaxhimin dhe Arkivimin Elektronik të Dokumenteve çdo ditë | | | |

Zyrtari për pranimin e mallit

- Pranimin e mallrave ne Sistemin e Menaxhimit te Financave ne Republikën e Kosovës (free balance), ku kam kryer mbi **900** (nëntëqind) lëndë, ku vlera e tyre kap shifrën mbi **2.706.824.77€**, për periudhën **Janar- Dhjetor 2018**.
- Pranimin dhe rexhistrimin e mallrave ne Sistemin e menaxhimit te Pasurive (E-Pasuria), ku në të përfshihen materialet shpenzuese si dhe asetet komunale, ku vlera e këtyre materialeve është mbi **75.332.30€** apo dikun mbi 160 lëndë.
- Kam plotësuar formularët për kërkesën e furnizimit me material për zyre dhe inventarë ne mbi 300 kërkesa.
- Kam bërë furnizimin me material shpenzuese si dhe inventarë për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë, duke e përfshirë Zyrën e Kryetarit dhe të gjitha drejtoritë tjera dhe komunitetet.
- Kam përgatitur disa paramasa për furnizime me materiale shpenzuese për të gjitha njësitë shpenzuese.
- Kam kryer edhe detyra tjera që më janë besuar nga menaxhmenti i Komunës.

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim

I. Sektori i Financave

Gjatë kësaj periudhe janë kryer këto punë:

- Janë regjistruar 2023 kupona të shpenzimeve në SIMFK (sistemi i menaxhimit të financave të Kosovës) përmes transferit me procedurë të prokurimit dhe aprovimit në vlerë prej 2,948,783.44 euro.

- Janë certifikuar 2023 pagesa përmes transferit me procedurë të prokurimit dhe aprovimit në vlerë prej 2,948,783.44 euro.
- Gjatë kësaj periudhe në programin e Administratës Komunale dhe Arsimit parauniversitar janë dorëzuar në MAP – divizioni i pagave (punëtorë të ri, largime dhe ndryshime) 1034 ndryshimet nga QKMF-ja dhe 553 kopje të pranuar të cilat janë përfshirë në evidencën e përgjithshme.
- Është bërë barazimi i të hyrave vetanake në baza mujore në mes të hyrave të arkëtuara dhe të hyrave të paguara.
- Janë pranuar, evidentuar, protokolluar 2025 faktura, kontrata, vendime dhe të njëjtat janë dorëzuar për zotim dhe vijim të procedurës të mëtejme deri te ekzekutimi.
- Janë pranuar 1250 raporte nga drejtorit që inkasojnë të hyra vetanake në vlerë nën 10 euro dhe janë bërë 140 deponime në bankë.

II. Sektori i buxhetit dhe thesari

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2018 janë kryer këto punë:

- Regjistrimi i obligimeve të pa paguara për periudhën Janar-Dhjetor 2018.
- Përgatitja e pasqyrave financiare për periudhën janar-mars dhe janar-qershor dhe janar shtator 2018.
- Sistemitimi i të gjithë punëtorëve në sistemin e pagave nëpër të gjitha programet sipas planifikimit të buxhetit vitit 2018.
- Janë përgatit të gjitha deklaratat e disponueshmërisë së mjeteve për pagesë të projekteve duke u bazuar në planifikimin e buxhetit e vitit 2018.
- Dhënia e informacioneve për të gjithë udhëheqësit e programeve buxhetore mbi gjendjen e rrjedhjes së parasë së gatshme për tërë vitin 2018.
- Barazimi i regjistrave të pasurive mbi dhe nën 1.000 euro, të regjistruara në frebalanc/E pasuria si dhe regjistrimi në regjistra intern.
- Janë bërë zotimet e mjeteve për të gjitha programet buxhetore dhe kategoritë ekonomike, varësisht nga kërkesat e autorizuesve të buxheteve përkatëse.
- Përpilimi i raportit të shpenzimeve për MF për TM-1 2018 dhe TM-2 2018 dhe TM-3 2018.
- Raportimi i obligimeve të pa kryera në MF, në departamentin e thesarit për çdo muaj dhe është bërë përgatitja e pasqyrave financiare për TM-1, TM-2 dhe TM-3 të vitit 2018.
- Përgatitja e qarkores së parë interne komunale 2019/01, e datës 15.05.2018, për të zhvilluar procesin buxhetor komunal 2019-2021.
- Përgatitja e Kornizës Afatmesme të Buxhetit (KAB) komunal për vitin 2019-2021, të datës 15.06.2018.
- Konsultimi i vazhdueshëm me drejtorët e drejtorive rreth inicimit të shpenzimeve të ndryshme komunale.

III. Sektori i Tatimit në Pronë

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2018 janë kryer këto punë:

- Afrimi i shërbimeve për qytetarët e komunës për kryerjen e obligimit të tatimit në pronë .
- Afrimi i shërbimeve për qytetarët e komunës për pagesën e taksës komunale për automjete.
- Lidhja e marrëveshjeve me tatimpagues për pagesën e detyrimit tatimor sipas kushteve të parapara nga DFEZH dhe dhënia e këshillimeve palëve për kushtet e pagimit të tatimit në pronë.

- Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2018 janë shërbyer 13636 palë me vërtetime (struktura: 8300 vërtetime për regjistrim të automjeteve, 678 vërtetime për raste sociale dhe 4460 vërtetime për nevoja të katastrit).
- Është kryer shtypja dhe shpërndarja e mbi 11327 faktuarve dhe shpërndarja e tyre për çdo qytetar në Komunën e Vitisë.
- Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2018 janë inkasuar 329,525.20 euro nga tatimi në pronë dhe 91,720.00 euro nga taksa komunale për automjete.
- Realizimi i planit për tatimin në pronë shprehur në përqindje është realizuar 82.38 %, kurse taksa komunale për automjete është realizuar 115.37 %.
- Kemi përgatitur një plan të veprimit nga një komision kompetent për rritjen e shkallës së inkasimit të tatimit në pronë.
- Është përpiluar lista e borxheve të qytetarëve sipas fshatrave dhe paraqitja e përqindjes së realizimit të obligimeve për çdo lokalitet.

IV. Sektori për ekonomi dhe zhvillim

Gjatë periudhës janar - dhjetor të vitit 2018, janë kryer këto punë:

- Kemi bërë dorëzimin e raportit të punës për vitin 2018 dhe planin e punës për vitin 2018.
- Kemi bërë shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve për marrjen e pëlqimeve për shfrytëzimin e parcelave të Agjencionit pyjorë dhe të pronave nën menaxhimin e AKP-së.
- Kemi bërë kërkesat pranë Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, për marrjen e lejeve të kërkuara nga Zyra e Projekteve.
- Me kërkesë të MTI-së, përkatësisht Divizioni i Turizmit, ne bëmë grumbullimin e informatave, gjegjësisht bëmë identifikimin e produktit turistik për rajonin e Anamoraves - Komuna e Vitisë.

V. Projektet e investimeve kapitale për vitin 2018 të financuara nga buxheti i Komunës së Vitisë (te paguara deri me 31.12.2018)

| | |
|---|--------------|
| 1. Revitalizimi i ujësjellësve gypi Viti - Letnicë (proc. të ekzek.- dy vjeçar) | 55,115.00 € |
| 2. Asfaltimi i rrugëve rurale (proces të ekzekutimit - dy vjeçar) | 545,884.32 € |
| 3. Rregullimi i kanalizimeve (proces të ekzekutimit - dy vjeçar) | 160,618.91 € |
| 4. Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimi publik (proces të ekzekutimit - dy vjeçar) | 327,863.55 € |
| 5. Rregullimi i fushave sportive | 96,779.40 € |
| 6. Rregullimi i tregut të kafshëve dhe tregjeve tjera | 29,498.28 € |
| 7. Renovimi i shkollave | 96,924.44 € |
| 7.8. Rregullimi i Stacionit të Autobusëve në Viti | 19,520.10 € |
| 8.9. Rregullimi i rrethojave shkollore | 25,558.54 € |
| 9.10. Revitalizimi i stadiumit në Viti e Pozheran (proces të ekzek.- dy vjeçar) | 50,000.00 € |
| 10.11. Asf. i rrugës Germovë-Goshicë (proces të ekzekutimit - dy vjeçar) | 77,913.49 € |
| 11.12. Ndërtimi i urës në fshatin Letnicë | 18,916.40 € |
| 12.13. Rregullimi i lumenjve dhe prockave | 46,177.96 € |
| 13.14. Rregullimi i hapësirave gjelbëruese - publike | 30,000.00 € |
| 14.15. Renovimi i ambulancave | 44,851.45 € |
| 15.16. Furnizim me aparatura dhe digjitalizim | 55,860.00 € |
| 16.17. Rregullimi i rrugëve me zhavorr | 127,970.43 € |
| 17.18. Atestete, hartimi dhe mbikëqyrja e projekteve | 40,831.56 € |

Gjithsej 1,850,284.12 €

Projektet investive të financuara nga niveli qendror (bashkëfinancim me Komunën e Vitisë)

| | |
|--|----------------|
| 1. Nder. i parkut industrial ne Budrikë (projekt dyvjeçar 2017-2018).. | 286,250.20 € |
| 2. Nder.i Pales.Sportive ne Drobesh-Viti (proj. trevjeçar 2017-2019) | 1.167,997.08 € |
| 3. Renovimi i Shtëpisë se Kulturës ne Viti (MKRS)..... | 248,605.00 € |
| 4. Asf. i rrugëve rurale në Viti (projekt dyvjeçar 2017-2018)..... | 82,272.00 € |
| 5. Rregullimi i urave te lumit “Morava” (projekt dyvjeçar 2017-2018) ... | 219,904.00 € |
| 6. Asf.i rrugës Germovë – Goshicë (projekt dyvjeçar 2017-2018)..... | 289,455.00 € |
| 7. Asf. i rrugës Mogillë-Skifteraj (projekt dyvjeçar 2017-2018.) | 212,638.00 € |
| 8. Ndërtimi I shkollës fillore në Pozheran (projekt trevjeçar)..... | 1.385,000.00 € |
| 9. Zgjerimi i rrugës Drobesh-Mogille (pr. dyvjeçar 2018-2019)..... | 341,406.00 € |
| 10. Zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës Sod.Jerlive-Dardani (pr.2018-2019) | 292,324.00 € |
| 11.Renov.ndrt.i infrast. mbrojtëse te lumit “Morava” (pr.2018-2020) | 1,098.649.00 € |
| 12. Rregullimi i trotuarit dhe ndriçimit publik (MAPL)..... | 79,930.18 € |
| Gjithsej | 5,704,430.46 € |

Projektet investive të financuara nga donatorë të jashtëm (bashkëfinancim me Komunën e Vitisë)

| | |
|--|-----------------------|
| 1. Proj. për përkujdesje shëndetësore (Caritas Kosova) | 16,000.00 € |
| 2. Ujës. në fshatin Smirë dhe Vërban (proj. dyvjeçar – CDI)..... | 513,000.00 € |
| 3. Ujes. ne fshatin Stubell (proc. ekzek- dyvjeçar – CDI) | 281,408.00 € |
| 4. Nd. i gypit te ujit Viti–Letnic (proj. dyvjeçar CDI) | 328,938.00 € |
| 5. Ndihmë për bizneset fillestare – Kosova Luksemburg | 76,669.36 € |
| 6. Programi për të drejtat pronësore (proj. trevjeçar USAID) | 200,000.00 € |
| 7. Projekti aftësitë për punësim rural (Helvetas) | 29,673.00 € |
| 8. Pr. zhvillimi i bujqësisë ne Komunën e Vitisë (IKC)..... | 19,800.00 € |
| 9. Projekti i BE.Cross-Border (2018-219) | 116,493.50 € |
| 10. Renovimi i shtëpisë se kulturës (BE) | 182,000.00 € |
| 11. Rregullimi i urës te Germi (Demos)..... | 37,530.30 € |
| 12. Renovimi i çerdhes “Gëzimi Ynë” (Demos) | 54,300.43 € |
| 13. Rregullimi i ndriçimit ne fsh. Binçë (IOM)..... | 14,000.00 € |
| 14. Projekti i UNDP për gjenerim dhe formalizmin te punësimit..... | 30,000.00 € |
| Gjithsej | 1,899,812.59 € |

Realizimi i këtyre projekteve gjatë vitit 2018 do të ndikoj drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës të qytetarëve.

VI. Zyra për regjistrimin e bizneseve

- Gjatë periudhës janar-dhjetor 2018 janë regjistruar 179 biznese të reja
- Gjatë kësaj periudhe janë shuar 34 biznese.
- Numri i përgjithshëm i të punësuarve është 234 punëtorë.

Drejtoria për Inspeksion

Drejtoria për Inspeksion vepron sipas organogramit të Drejtorisë së Inspeksionit dhe atë: tregut, ambientit, sanitarisë, komunikacionit, bujqësisë, veterinarisë, pronës dhe ndërtimtarisë.

Detyrat e drejtorisë janë implementimi i të gjitha vendimeve të Kuvendit Komunal, që kanë të bëjnë me punën e inspektorëve në terren dhe të gjitha ligjeve përkatëse në fuqi të Kuvendit të Kosovës sipas specifikave të lëmive të inspektorëve.

Inspektorët e tregut

- 102 procesverbale mbi legalizimin e veprimtarisë së subjekteve të biznesit dhe pajisje me leje pune dhe mbikëqyrjet tjera në aspektin e zbatimit të Ligjit Nr. 06L/183 për legalizim të veprimtarisë si dhe pajisje me pranim teknik të lokaleve, si dhe bizneset që kanë ndërru selinë e veprimtarisë apo kanë zgjeruar hapësirat afariste janë detyruar që të harmonizojnë veprimet e tyre në pajtim me ligjet në fuqi.
- 8 aktvendime –vërejtjet të fundit mbi eliminimin e të metave të konstatuara me procesverbal.
- 3 fletëparaqitje në gjykatën Themelore në Gjilan dega në Viti.
- 15 procesverbale, kryesisht ka mbizotëruar urdhri për largimin e etiketës me përmbajtje apo emërtim tjetër, në kundërshtim me emërtimin zyrtarë të Republikës së Kosovës. Kontrollat janë shtrirë së pari në pikat e shpërndarjes me shumicë, pastaj në Hipermarketet, supermarketet dhe në dyqanet tjera tregtare, dhe nga të gjitha vizitat është konstatu një numër i madh i artikujve në qarkullim me etiketat e furnizuesve që kanë qenë në kundërshtim me emërtimet ligjore. Si artikuj që kanë pas fluksin më të madh ishin PERWOL dhe MERIX, sasia në shumë monetare 20.000 €, ku është urdhëruar ndalim qarkullimi i artikujve me mbishkrime në kundërshtim me dispozitat e ligjit Nr.06/L-034. Të gjitha bizneset e kanë zbatuar me mirëkuptimin më të madhe dhe Operatori ekonomik si furnizues i këtyre artikujve qysh në ditën e dytë të paralajmërimeve tona, ka filluar eliminimin e kësaj të metë.
- 3 procesverbale kanë të bëjnë për ndalim qarkullimi dhe konfiskim të artikujve lodra, që janë verifikuar si produkte që nuk plotësojnë kërkesat ligjore për qarkullim në tregun e brendshëm, gjegjësisht që paraqesin rrezik për konsumatorin. Nga kjo pikë janë inspektuar të gjitha biznesit në Komunën e Vitisë, të cilat sipas informatave kanë produkte apo që mund të kenë të tilla në qarkullim, e vetëm në 3 biznese është hasur produkti, Barrel-0- slim, në vlerë afërsisht 100 €, me çka janë konfiskuar dhe asgjësuar. Gjithashtu nga këto inspektime janë shpërndarë fotot produkteve të rrezikshme, me çka kemi informuar të gjitha bizneset për rreziqet e posedimit, mbajtjes dhe tregtimit me produkte të tilla të rrezikshme për jetën dhe shëndetin si të vetë shitësve, njashtu edhe për konsumatorët.
- Janë bërë matjet dhe verifikimet e peshës së Bukës në të gjitha furrat në territorin e Komunës së Vitisë. Ka ngritje të çmimeve dhe çmimet janë unike në të gjitha furrat 0.30 €. Janë obliguar të gjitha furrat të kenë të shpallur deklaracionin mbi përbërjen dhe peshën dhe nga mbikëqyrjet janë konstatuar, se pesha mesatare e bukës në deklaracion është 0.400 kg.
- 15 Kontrolle të përbashkëta me PK, njësia në Pozheran, kontrolle që kanë qenë në fokus pranimit teknike të lokalit dhe zbatimit të rregulloreve dhe procedurave në zbatim të Ligjit mbi Tregëtinë e Brendshme dhe Ligjit mbi Inspektoratin e Tregut.
- 7 kontrolle gjate natës në mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve të tregtisë dhe ligjeve në koordinim me inspektorët tjerë në bashkëveprim të përbashkët.
- 14 Kontrolle mbi kualitetin, cilësinë, sigurinë e produkteve në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve, së bashku me inspektorët sanitarë, të veterinarisë, ku janë asgjësuar sasi e konsiderueshme e mallit të rrezikshëm për jetën dhe shëndetin e konsumatorëve.

- Nga kontrollet e bëra, janë urdhëruar bizneset që të shpallim edhe njoftimet për ndalim shitjen, shërbim dhe dhurimit e duhanit dhe pijeve alkoolike personave nën moshën 18 vjeçare.
- 20 kontrollime mbi te drejtat e autorit - kontrolle nga aspekti i ligjshmërisë së tregtimit dhe ndalim i tregtimit me artikujt – emër tregtarë të kopjuar dhe nga kontrollimet e tregut është konstatuar, se disa operator ekonomik bëjnë furnizime pa licencë – markë tregtare dhe si artikujt janë veçuar llojet e çajit te zi, si Moni Brand, Vicianum, Emona Brand, Euro Brand, Pajtimi Brand, Vicianum etj, si dhe artikujt pampers nina-s.
- 57 kërkesa mbi pranimin teknik te lokalit ne shume prej 3.311,00 €.
- 56 pranime teknike te lokaleve.
- 1 kërkesë nuk ka plotësuar kriteret për tu pajisur me pranim teknik te lokalit, nga arsyeja e mosfunksionalizimit të lokalit nga aspekti teknik.
- 16 vizita dhe kontrolle ne tregjet ne Viti e Pozheran, si ne tregun e gjelbër njashtu edhe të kafshëve.
- 3 vizita dhe aksione për largimin e shitësve nga vendet jo te përshtatshme për tregtim, sidomos ne lokacioni para tregut të gjelbër ne viti, se bashku me inspektorët tjerë te drejtorisë.
- 150 Vizita tjera ne biznese ne aspektin e zbatimit te dispozitave te ligjit Nr:03/L-181, dhe dispozitave tjera mbi peshën dhe njësitë matëse, çmimet e artikujve, shpallja e emërimit biznesit, kushtet e ushtrimit të veprimtarisë, e sidomos pajisje me leje pranim teknik të lokalit, ku është kontribue shume ne Drejtorinë e Financave, që të inkasojnë mjete financiare.

Inspektori i veterinarisë

- Inspektim tregun e kafshëve dhe tregun e gjelbër në Viti dhe Pozhoran.
- Inspektim ne fsh. Stubëll në fermën e dhive me rastin e ngordhjes dhe abortit të dhive, ku është dyshuar në sëmundje infektive. Kemi marrur mostra gjaku për analiza. Mostrat janë dërguar në laborator, rezultatet kanë rezultuar negativ.
- Inspektim në fshatin Letnicë me rastin e ngordhjes se gjedheve.
- Inspektim ne fsh. Sallatinë së bashku me inspektorin e ambientit kemi pasur në fshatin Buzovik, Lubisht, Beguncë, Navosellë, Ramjan, këto kafshë jan marrur dhe janë groposur.
- Inspektimi i thertores në Pozhoran në 90 raste të kontrollës dhe vulosja e mishit, ku mjete te grumbulluara kemi 360 €.
- Pajisjen e fermerëve me çertifikata të transportit. Mjetet e grumbulluara jen gjithsej 37 €.
- Inspektim marketeve për mishin e bluar të ngrirë, si: ETC, Viva fresh, Emi center, Elacenter Drobesh, Beni Impex –Smir, Toni Market Sodovin, Real Center, Prescomi Viti, pas ndalimit të shitjes së mishit. Mishi i cili është gjetur si i pasigurt është asgjësuar. Kjo procedurë është bërë së bashku me inspektorët e AUV-së.
- Mostra gjaku për dyshime në sëmundje infektive janë marrë në këto fshatra: Stubell, Debellde, Remnik rezultatet kanë rezultuar negativ.
- Marrje mostrave në fermën e gjedheve „Nëna Naile” në fsh. Sllatinë, ku kanë rezultuar pozitiv në sëmundjen e brucelozës 10 krerë, ku pas disa dite janë asgjësuar. Procedurat e marrjes së mostrave ka vazhduar çdo 45 ditë, deri në shëndetësimin e fermës.
- Inspektim në fsh. Ballancë në fermën e lopëve, ku pas vaksinimit të lopëve kundër sëmundjes Gungore të gjedhit, nga Veterinerët e kontraktum nga AUV-ja e Kosovës.
- Inspektim e dy bletorëve me rastin e paraqitjes së s’mundjës Pesta Amerikane. Janë marrur mostra hoje bletësh, kanë rezultuar pozitiv, më pas janë asgjësuar 13 koshere bletë.

- Inspektim Bletoren në fsh. Letnic, me rastin e ankesës të një qytetare. Kemi dalur në vend të ngjarjes tri herë, dhe kemi informuar edhe inspektorët Regjional, rast ende në shqyrtim.
- Përcjellja e aksionit gjatë kapjes së qeneve endacak nga Abulancat Veterinare të kontraktuara nga A.U.V - së Kosovës.
- Anëtar komisioni për vlerësimin e dëmeve në Bujqësi gjatë tërë vitit, ku kemi bërë vlerësimin e një numri të madh të kafshëve të ngordhura nga sëmundjet dhe fatkeqësitë natyrore.

Inspektori i pronës

Gjatë këtij vitit kalendarik 2018, sektori i pronësisë ka kryer punë kryesisht në terren dhe në identifikimin e rasteve të uzurpimeve në këto zona kadastrale:

- Zonën kadastrale Pozheran, 4 uzurpime;
- Zonën kadastrale Kabash, 1 uzurpim;
- Zonën kadastrale Binçë, 3 uzurpime;
- Zonën kadastrale Smirë, 6 uzurpime;
- Zonën kadastrale Lubishtë, 3 uzurpime;
- Zonën kadastrale Viti, 5 uzurpime;
- Zonën kadastrale Radivojcë, 3 uzurpime;
- Zonën kadastrale Pozheran; 4 uzurpime
- Zonën kadastrale Sllatinë e Ulët, 3 uzurpime;
- Zonën kadastrale Drobesh, 2 uzurpime.

Gjithsej 30 vendime për lirimin e pronës publike, ku prej të gjitha rasteve kemi iniciuar procedurë gjyqësore dhe 16 kallëzime penale, kurse 7 të tjera janë në procedurë.

Iu kemi përgjigjur në nëntë (9) kërkesave zyrtare të inicuar nga banorët e fshatit Tërpezë, Beguncë, Sadovinë e Qerkezëve, Vërban, Radivojcë në lidhje me përcaktimin e kufijve të rrugëve publike, në pronësi të Komunës së Vitisë, ku kemi dalur në terren dhe kemi ekzekutuar kufijtë zyrtar të parcelave pranë rrugëve përkaj të implementimit të projekteve të rrugëve.

Gjatë këtij viti kemi ekzekutuar lirimin edhe të hapësirave publike në zonën kadastrale në Pozheran, tek stadiumi “Ibrahim Kurteshi” në Pozheran dhe disa objekte ndërtimore dhe baraka tek objekti i ri i zjarrfikësve në Viti.

Gjatë kësaj kohe, inspektori i pronës ka bërë **19** përfaqësime në Gjykatën Themelore në Gjilan – Dega në Viti, ku të gjitha kanë qenë në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së pronës publike komunale.

Inspektori i mbrojtjes mjedisore

- Mbikëqyrja e largimit të mbeturinave në qytet dhe lokalitete ku janë të pajisur me kontejner.
- Shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve.
- Implementimi i Ligjeve dhe Rregulloreve Mjedisore.
- Zbatimin e Udhëzimit Administrativ për Ndëshkimet me Gjoha Mandatore.
- Implementimi i Rregullores për Leje Mjedisore Komunale.
- Në vazhdimësi kemi përcjell gjendjen mjedisore në shumë lokalitete.
- Inspektim enteve shëndetësore, lidhur me Zbatimin e Udhëzimit Administrativ për Administrimin e Mbeturinave Shëndetësore.
- Janë inspektuar shumica e veprimtarive që duhet të pajisen me Leje Mjedisore Komunale e që ka rezultuar me marrjen e lejeve të tilla.

- Janë inspektuar të gjitha shkollat, lidhur me mirëmbajtjen e hapësirës jashtë objekteve shkollore (oborret), e që është konstatuar se ka përmirësime të dukshme.
 - Janë inspektuar lumenjtë në territorin e komunës, e që në zonat urbane nuk ka pasur dëmtim të tyre, ndërsa për zonat rurale kemi njoftuar Komisionin për Miniera dhe Minerale për dëmtimin e tyre.
 - Janë kontrolluar disa veprimtari , lidhur me shkaktimin e zhurmës , e në dy raste është bërë matja e zhurmës: një rast ka rezultuar se nuk ka pasur tejkalime, ndërsa një rast ka pasur tejkalim e që lënda është në procedurë.
 - Kemi inspektuar të gjitha rrjetet e kanalizimit kolektiv të ujërave të zeza, ku një pjesë e tyre nuk përfundojnë në gropa septike dhe nuk kanë mbikëqyrje nga kompanitë kompetente.
 - Në dy raste kemi intervenuar(me kërkesë zyrtare) në komunën e Klllokotit për probleme mjedisore dhe kemi zgjidhur kontestet.
 - S’bashku me Policinë e Kosovës kemi inspektuar në fshatin Binqë, në qytetin e Vitisë, Fshatin Goshicë, me policinë kufitare rr. Shushtë- Samakaovë e që kemi inicuar padi kundërvajtje dhe gjoba mandatore për hedhësit e mbeturinave në vende të ndaluara .
 - Në disa fshatra kemi shpërndarë njoftime publike lidhur me ruajtjen e mjedisit dhe pasojat ligjore për ndotësit e mjedisit.
- Kemi pasur dy takime pune me Komisionin për Miniera dhe Minerale dhe akterët tjerë (Prishtinë dhe Gjilan) lidhur me eksploatimin e inerteve .
- Kemi marrë pjesë në asgjësimin e mbetjeve të tekstiti në fabrikën „ Vitex” në Viti dhe kemi urdhëruar që mbeturinat të dërgohen në deponi përkatëse(janë dërguar në komunën e Istogut që është dëshmuar me faturë)
 - Kemi marrë pjesë në aksionin e pastrimit të mjedisit me 22 Prill „ Dita e Tokës” dhe 5 Qershorin „ Dita e Mjedisit” si dhe aksionin tremujor për pastrimin e mjedisit nga mbeturinat me moton „ Ta Pastrojmë Kosovën”.
 - Në rr. „ Muhamet Muarremi” në drejtimin Viti – Drobesh kemi evidentuar se janë dëmtuar disa drunj dekorativ(pesë) dhe rastin e kemi lajmëruar në polici.
 - Kemi marrë iniciativë për funksionalizimin e deponive të mbeturinave të ngurta (ndërtimore) dhe janë caktuar tri pika : Binqë, Radivojc dhe pika mes të fshatit Sllatinë e Epërme –Trestenik.
 - Kemi marrë pjesë në Gjykatë për shqyrtimin e lëndëve.
 - Kemi kryer edhe punë tjera sipas kërkesës të eprorit.
 - Në këtë vit kemi ndërprerë 35 aktivitete ndotëse.
 - Largimi i plehrave të kafshëve 11.
 - Ndalimi i rrjedhjes të ujërave të zeza në ambient të hapur 10.
 - Largimi i mbeturinave në vende të ndaluara 12.
 - Marrje e masave për zvogëlimin e ndotjes së ajrit në 2 furra.
 - Konstatim: gjendja mjedisore në territorin e komunës nuk është e kënaqshme sidomos (mbeturinave dhe ujërave të zeza), në lokalitetet ku mungon menaxhimi i mbeturinave përmes kompanisë dhe rrjeta e kanalizimit kolektiv.
 - Mungojnë gropat septike të kanalizimit kolektiv.
 - Nuk janë marr masa nga Komuna e Ferizajt për rrjedhjen e ujërave të zeza nga kanalizimi kolektiv në fshatin Sllatinë e Epërme dhe Sadovinë e Qerkezëve.

Edhe pse disa fshatra kanë shpreh interesim për menaxhimin e mbeturinave komunale përmes kompanisë, nuk ju kanë ofruar shërbim.

Pasqyra tabelare e dokumenteve të pranuar dhe të përcjellura
Dokumentet e pranuar

| Kërkesa të pranuar | Nga viti kal | Kërkesa pranuar | Të shqyrtua | Në procedurë | Të përfunduara |
|--------------------|--------------|-----------------|-------------|--------------|----------------|
| 4 | / | 4 | 4 | 1 | 3 |
| / | / | / | / | / | |

Dokumentet e përcjellura

| Vërejtje | Cedim | Kërkesa | Njoftime | Kërkesë gj përkundërvajte | Gjobë mandatore |
|----------|-------|---------|----------|------------------------------|-----------------|
| 3 | / | / | 8 | 4 | 4 |

Inspektimi dhe proceset

| Inspektime | Procese sipas kërkesave | Procese sipas detyrës zyrtare |
|------------|-------------------------|-------------------------------|
| 630 | 66 | 4 |
| / | Gjithsej procese | 70 |

Inspektori i komunikacionit

Në bazë të planit vjetor të punës për vitin 2018, sipas dinamikës së punëve kemi realizuar këto objektiva:

Zbatimi i Ligjeve dhe Rregulloreve në Fuqi si:

1. Ligji i Transportit Rrugor Nr.04/L-179.
2. Ligji i transportit për mallra të rrezikshme Nr.2004/6.
3. Ligji i Trafikut Nr.02L-70, si dhe Rregullorja Komunale për Organizimin e Transportit Brenda territorit të Komunës së Vitisë me Nr.01-13/764, të datës 30.05.2014, Vendimi mbi rregullimin e Komunikacionit në qytetin e Vitisë dhe territorin e saj, si dhe rregulloret tjera komunale që lidhen me komunikacion. Aktivitetet dhe detyrat sipas urdhrave të drejtorisë dhe eprorëve të tjerë nga Komuna e Vitisë.

Bazuar në Planin e punës sipas dinamikës kemi pasur këto aktivitete:

- ❖ Përgatitja e planeve dhe raporteve të punës sipas periudhave mujore.
- ❖ Koordinimi i bashkëveprimit me Policinë e Kosovës, Stacioni Policor në Viti.
- ❖ Bashkëpunimi me Gjykatën Themelore Gjilan - Dega në Viti D. për Kundërvajtje.
- ❖ Organizimi i aktiviteteve të transportit me Operatorët e Transportit Publik dhe të mallrave në Komunën e Vitisë.
- ❖ Kontrollimi i infrastrukturës rrugore, furnizimi dhe vendosja e shenjave vertikale dhe horizontale të komunikacionit.
- ❖ Bashkëpunimi me përfaqësues të Komuniteteve.

- ❖ Koordinimi me Policinë e Kosovës, Stacioni Policor në Viti
- ❖ Kemi pasur veprime të përbashkëta me Policinë Kosovës, në bazë të planit operativ të hartuar që më parë , mbi kontrollimin e transporteve, ndërsa sa i përket dëmtimit të shenjave të komunikacionit kemi pasur një ngecje duke mos u thirrur në kompetencat e përbashkëta, por vetëm në rastet kur unë kam hapur ndo një rast të veçantë edhe pse ligji autorizon edhe Policinë e Kosovës që të merret me angazhimin rreth ruajtjes së shenjave të komunikacionit.
- ❖ Gjithashtu kemi organizuar veprime të përbashkëta me kolegët nga Komuna e Gjilanit, dhe kemi pasur takime pune edhe me kolegët nga Ferizaji, Kamenica, Shtimja e Kaçaniku.
- ❖ Gjithashtu kemi koordinuar dhe harmonizuar të gjitha linjat Urbano-Periferike me Autobus, ku kemi një transport publik të kënaqshëm, në të gjitha linjat.
- ❖ Në kudër të kompetencave dhe përgjegjësiive tona, kemi kontrolluar të gjitha rrugët publike ku në disa raste kemi intervenuar në sanimin e gjendjes apo dëmtimeve të rrugës, mbylljen e kanaleve të hapura, apo mënjanimin e pengesave në rrugë pa ndo një leje përkatëse.
- ❖ Gjithashtu vlen të potencohet se kemi pasur shpesh prerje të rrugëve publike por në shumicën e rasteve ishim të kufizuar për të ushtruar detyrën tonë.
- ❖ Gjithashtu kemi lejuar vendosjen e Pengesave të ashtu quajtura (Polic i shtrirë) prej të cilave disa në mënyrë alternative nga gjysmë pengesa në të dy anët e shiritit të rrugës si në Kabash, Sllatinë e Poshtme, Smirë, Sodovinë e Jerlive, Sodovinë e Qerkezve etj.
- ❖ Në kuadër të furnizimit dhe vendosjes së shenjave Vetikale dhe Horizontale të Komunikacionit, në bazë të planit paraprak mbi kontratën për shërbime kemi furnizuar me shenja Vertikale dhe Horizontale të gjitha rrugët e qytetit të Vitisë, Rrugën Viti-Pozheran, Viti-Binçë, Viti–Ramnishtë–Beguncë, Skifteraj, Radivojc, Tërpezë, Remnik, Sllatinë e Epërme, Sodovinë e Jerlive, Sodovinë e Qerkezëve, Goshicë, Vërban etj.
- ❖ Kemi shënuar të gjitha vendkalimet për këmbësor, të cilat pas riasfaltimit përsëri janë shënuar, por kësaj radhe me material plastik një komponentësh dhe të plastifikuara 2 komponentësh.
- ❖ Kemi sinjalizuar me shenja horizontale si Vendkalime etj. Edhe rrugët Rajonale në Drobesh, Gërmovë, Sodovinë e Jerlive, etj.
- ❖ Ndërkaq gjatë këtij viti janë asfaltuar edhe shumë rrugë të tjera të cilat i kemi vendosur në prioritet për sinjalizime me shenja të Komunikacionit horizontale dhe vertikale. Kemi lejuar vendosjen e të ashtuquajtura (Polic i shtrirë), me qëllim të rritjes së sigurisë në rrugë, në të gjitha vendet ku kemi konsideruar rrezik permanent.
- ❖ Në kuadër të bashkëpunimit me komunitete, kemi qenë gjithherë në dispozicion për një bashkëpunim të mirëfilltë.
- ❖ Kemi shqyrtuar të gjitha kërkesat e parashtruara nga qytetarë të ndryshëm, si dhe subjekte, si Operatorët e Transportit, po njashtu kemi pasur bashkëpunim të ngushtë me të gjithë përfaqësuesit e Auto-Shkollave, dhe subjektet tjera që ishin të lidhur apo të interesuar për Gjendjen në Komunikacion, si Shoqëri civile Media etj.
- ❖ Kemi bërë **187** kontrollime të mjeteve të transportit publik dhe të mallrave.
- ❖ Në këtë vit kemi bërë 5 (pesë) vërejtje me shkrim për personat që kanë ndërhyrë në forma të ndryshme në rrugët publike.
- ❖ Kemi hartuar 16 (gjashtëmbëdhjetë) procesverbale sipas detyrës zyrtare si leje, vërejtje, njoftime etj.

- ❖ Kemi lëshuar 1 (një) pëlqim për kyçje dhe ç'kyçje në rrugë publike për operator të transportit të mallrave.
- ❖ Kemi bërë 96 procesverbale mbi shikimin e automjetit për transport publik –taxi.
- ❖ Kemi bërë 97 fletëpagesa për taksa komunale dhe atë 96 mbi shikimin e automjetit në vlerë prej 10 €, 1 pëlqim për kyçje në rrugë në vlerë prej 20 €.
- ❖ Kemi lëshuar 9 vërtetime për studentë për distancën gjeografike nga qendra e studentëve deri në vendbanimin e studentit/es.
- ❖ Kemi lëshuar 5 (pesë) leje për vendosjen e pengesave në rrugë.
- ❖ Kemi lëshuar 3 (tre) dëshmi për palët që punojnë apo nuk punojnë taxi.
- ❖ Kemi bërë pranimin teknik të lokaleve së bashku me Ins. E Tregtisë dhe atë Sanitarë.
 - Pranimi i punimeve dhe hartimi i raporteve nga kontraktori Studio Reklama "Krosa", për vendosjen e shenjave të komunikacionit, në të cilin komision jam i angazhuar si menaxher me vendim të kryetarit të Komunës.
 - Pastaj kemi qenë edhe nëpër komisione të ndryshme të pranimit të punimeve me vendime nga kryetari, si kanalizime, rrjete të ujësjellësit rrugë trotuare etj.
 - Dhe shumë punë e detyra të tjera të ngarkuara nga eprorët.
- ❖ Linjat urbano-periferike për vitin 2018 në komunën e Vitisë. Gjithsej i kemi të mbuluara 29 vendbanime me 31 vendndalje për transport publik. Nga këto vendndalje 10 janë të shenjëzuara në rrugët rajonale, ndërsa të tjera janë të pashenjëzuara.

Inspektorët e ndërtimit

Bazuar në Planin e punës sipas dinamikës kemi pasur këto aktivitete:

Në kuadër të aktiviteteve sipas detyrës zyrtare kemi pasur mjaftë angazhime rreth kontrollimit të ndërtimeve në komunën e Vitisë, ku kemi konstatua këtë gjendje, se në disa raste të ndërtimit pa leje përkatëse, pas intervenimit tonë dhe hartimit të procesverbalit, shumë nga ndërtuesit i kemi detyruar që të pajisen me leje përkatëse të ndërtimit, ku në disa raste kemi bërë edhe vendime për ndërprerjen e punimeve dhe janë vendosur shiritat për ndalimin e punimeve të mëtutjeshme.

Gjatë këtij viti përpos angazhimeve tona zyrtare, kemi pasur edhe disa kërkesa nga ana e qytetarëve në lidhje me ndërtimet, si ato banesore dhe të rrugëve, ku një mori kërkesash i kemi shqyrtuar së bashku me kolegët tanë në afatin optimal.

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisve tona, në këtë vit kemi hartuar 70 procesverbale nga vendi i ngjarjes.

- Aktivitete në teren kemi pasur **320 raste të kontrollimeve**.
 - Vendime për ndërprerjen e punës 61 sosh.
 - Vendosjen e shiritave për ndërprerjen e punimeve në 52 raste
 - Kemi përgatitur mbi 6 lëndë, të cilat i kemi të proceduar në Prokurorinë themelore në Gjilan.
 - Kemi përgatitur 36 lëndë, të cilat i kemi proceduar në Gjykatën Themelore Gjilan - Dega në Viti, divizioni për kundërvajtje.
 - Kemi hartuar 11 Vendime për rrënime të arsyeve të ndryshme.
 - Kemi përfaqësuar në Gjykatën Themelore në Gjilan dega në Viti, D. për kundërvajtje në 25 lëndë të cilat janë përfunduar , ku kanë mbetur në procedurë edhe 11 lëndë.
 - Gjithashtu në kuadër të aktiviteteve tona kemi qenë të angazhuar me Vendim të Kryetarit të komunës edhe në shumë raste të pranimeve teknike si: kanalizime, shtrirje të rrjetit të ujësjellësit, rrugë të ndërtuara, trotuare, ku për secilin rast kemi hartuar raporte pune veç e veç.

Inspektori i sanitarisë

| Nr. | INSPEKTIVE | | Shprehur ne numra |
|-----|--------------------------------------|--|---------------------|
| 1 | Inspektive te objekteve afariste | | 165 |
| 2 | Pranime teknike te lokaleve | | 25 |
| 4 | Procesverbale | | 165 |
| 5 | D>D>D | | 22 |
| 6 | Inspektive të ujërave të pijshëm | | 28 |
| 7 | Inspektive të ujërave të zeza | | 1 |
| 8 | Mostra të ujërave rurale | | 17 |
| 9 | Mostra te ushqimeve | | 10 |
| 10 | Pëlqime Sanitare | | 10 |
| 11 | Aktvendime | | 10 |
| 12 | Kundërvajtje | | 3 |
| 13 | Vepra Penale | | 0 |
| 14 | Libreza Sanitare | | 70% |
| 15 | Inspektive te tregut | | 4 |
| 16 | Asgjësimit te artikujve ushqimor | | 22.754,88 kg |
| 18 | Urdhëresa | | 8 |
| 19 | Inspektive te objekteve shkollore | | 15 |
| 20 | Inspektive te objekteve shëndetësorë | | 14 |
| 21 | Inspektive te pishinave | | 4 |
| | Inspektive gjithsej | | 215 |

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë

- Janë mirëmbajtur të gjitha rrjetet e ujësjellësit dhe kanalizimeve në tërë territorin e Komunës së Vitisë.
- Janë mirëmbajtur të gjitha rrugët lokale në tërë territorin e Komunës së Vitisë gjatë sezonit të verës dhe dimrit.
- Hapësirat e hapura publike janë mirëmbajtur nga kompania e kontraktuar.

- Ndiriimi publik është mirëmbajtur në tërë territorin e Komunës së Vitisë.
- Është bërë dekorimi i qytetit për festat e fundvitit më 15.12.2018.
- Menaxhimi i mbeturinave është bërë nga shpk “Eco-higjiena” dhe gjatë vitit 2018, është arritur që në sistem të futen edhe fshatrat: Binçë dhe Lubishtë, ndërsa kanë mbetur jashtë sistemit të menaxhimit vetëm fshatrat: Devajë, Letnicë dhe Debelldeh.
- Eliminimi i deponive ilegale, janë eliminuar mbi 28 deponi ilegale me mbi 512 tonë mbetje ndërtimore, 243 tonë mbetje të përziera dhe 3008 thasë (120 l) mbetje komunale.
- Janë bërë të gjitha përgatitjet dhe masat e nevojshme për mbarëvajtjen ceremonisë fetare të “Zojës së Madhe” në fshatin Letnicë.
- Është intervenuar në sanimin e gjendjes pas vërshimeve të cilat kanë ndodhur në Komunën tonë më datë 03.02.2018 dhe 23.07.2018.
- Aktivitetet gjatë sezonit veror për minimizimin e dëmeve nga zjarret fushore – malore.
- Puna në hartimin e planeve:
 - a. Plani për menaxhimin e emergjencave
 - b. Rishikimi i planit për menaxhimin e mbeturinave
 - c. Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave

Sektori i Shërbimeve Publike

- Gjatë këtij viti ka pranuar gjithsej 308 kërkesa të natyrave të ndryshme, të cilat i kemi kryer në afatin ligjor.
- Përmes arkivit kemi pranuar 308 (treqind e tetë) kërkesa të ndryshme nga qytetarët e Komunës së Vitisë dhe varësisht nga natyra e kërkesave i kemi shqyrtu dhe ju kemi kthyer përgjigje në afatin kohor në bazë të rregulloreve komunale në fuqi.
- Kemi lëshuar vendime dhe ngarkesa për shfrytëzimin e hapësirave publike për vitin 2018, si dhe janë bërë pagesat për shfrytëzimin e hapësirave publike, vendosjen e reklamave etj.
- Kemi përcjell edhe punët e kompanisë për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve si: Pastrimi i rrugëve lokale nga akulli dhe bora, bartjen e disa kafshëve të ngordhura dhe varrosjen e tyre, mbushjen e gropave me kubza betoni nëpër rrugë të asfaltuara, furnizimin me zhavor nëpër rrugët e rendit të katërt, mbushja e gropave me asfalt nëpër rrugë të asfaltuara.
- Vazhdimi i lejeve të punës për Auto Taxi dhe ndërrimi i të dhënave.
- Lejimi i lejeve të punës për Auto Taxi.
- Leje për parkim të rezervuar.
- Përgatitja e propozim vendimeve për DSHPE-në.
- Leje të transportit të veçantë publik në komunën e Vitisë.
- Leje të transportit të veçantë dhe leje tjera.
- Përgjigje, kërkesa, njoftime, cedim të kërkesave, raporte, vërtetime, padi.
- Kontrata për shërbime të veçanta.
- Pjesëmarrja në komisione të ndryshme në zyrën e prokurimit, etj.
- Sektori I trafikut dhe transportit publik të udhëtarëve organizohet përmes kompanive private të transportit dhe taksistëve individual si transport urban. Kompanitë e transportit publik urban periferik janë tetë (8). Kompanitë e transportit ndërurban janë tri (3).

Intervenimet e SHZSH-së

- Numri i përgjithshëm i daljeve 291;
- Zjarre, 185;

- Shërbime, 48;
- Intervenime teknike, 19;
- Aksidente rrugore, 6
- Vërshime, 33;
- Të lënduar, 12;
- Të vdekur 1, rasti në fshatin Smirë, që ka qenë më datë 26.11.2018, ku ka rezultuar me gjetjen e viktimës në mal.

Inspektori i parandalimit të zjarreve

- Inspektime të përgjithshme të rregullta dhe verifikuese, 60;
- Inspektim në sektorin privat, 56;
- Inspektim në sektorin shoqëror, 4;
- Janë shqiptuar 185 vërejtje;
- Numri I propozimit të masave 185;
- Shikime në vendngjarje të zjarreve, 23;
- Raporte zjarre për njësitë hetuese të policisë, 12;
- Kërkesa nga palët, 5;
- Vërtetime zjarri për palët e dëmtuara, 5.

Punët me Skipin e Komunës gjatë vitit 2018

- Hapja e kanaleve të ndryshme;
- Rregullim të kanalizimeve nëpër fshatra dhe qytetin e Vitisë;
- Rregullimin e ujësjellësve nëpër fshatra dhe qytetin e Vitisë;
- Largimin e borës nga rruga;
- Largimin e mbeturinave;
- Varrosjen e kafshëve të ngordhura;
- Mbyllja e rrugëve malore;
- Rregullimi i hapësirave publike;
- Rregullimi i rrugëve nga gërryerjet erozive.

Pra me skipin e komunës janë kryer punë të ndryshme dhe atë ne total 659 ore pune.





1. Ndërtimi I objektit të zjarfikëseve, realizimi I këtij projekti është dyvjeçar.
2. Puna në Planin Bazik Emergjent, bazuar në vendimin e Kryetarit të Komunës-vazhdon punën Grupi punues
3. Bashkëpunimi me OJQ-në, “Iniciativa ta pastrojmë Kosovën” në pastrimin e ambientit–eliminimin e deponive ilegale.
4. Realizimi i projektit me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërmarrjen shpk “Ekohigjiena dhe Komuna e Vitisë, Punë Publike në Komunën e Vitisë, në të cilin projekt janë punësuar 25 punëtor për një periudhë kohore prej gjashtëmuajsh në pastrim të ambientit, dhjetor 2018.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Duke u bazuar në objektivat, gjatë kësaj periudhe në shumë aspekte është bërë një punë e madhe në lehtësimin e dhënies së shërbimeve si në kualitet dhe efikasitet. E tërë kjo punë është paraqitur si edhe në vijim të raportit për periudhën Janar - Dhjetor 2018.

| | | | | | |
|----------|-----|-----|-----|---|---|
| Gjithsej | 417 | 199 | 218 | 0 | 0 |
|----------|-----|-----|-----|---|---|

ZYRA E DREJTORIT TË DSHSM-SË

Punët të cilat janë kryer nga stafi i drejtpërdrejtë i drejtorit janë paraqitur në tabelën si në vijim me të dhënat konkrete të punëve, si ndarja e subvencioneve për ndihmë momentale të cilat janë aprovuar nga komisioni në përbërje të tre anëtarëve, pastaj edhe ato të cilat janë pranuar, të proceduara dhe të aprovuara, si dhe ato që janë refuzuar. Lëndët të cilat janë shqyrtuar nga kjo zyrë për përudhen Janar-Dhjetor 2018 i gjeni në tabelën e mëposhtme.

PËRCJELLJA E POLITIKAVE NË SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Vizitat e shpeshta dhe kontaktimi me punëtorë si dhe me stafin udhëheqës të këtyre dy njësive punese, janë bërë me qëllim të bashkëpunimit dhe të identifikimit të problemeve për një menaxhim sa më efikas. Vizitat e tilla të koordinuara kanë dhënë rezultate të dukshme në afrimin dhe komunikimin ndërinstytucional në mes këtyre dy njësive punuese.

TAKIMI I STAFIT PËR PROMOVIM TË PUNËS EKIPORE

Takimet e tilla janë mbajtur në secilën njësi punuese nga dy here në jave me ekipin udhëheqës, me qëllim të hartimit të strategjive për punë ekipore dhe vendosjen e një plani të detajuar.

Projekte kapitale

1. Renovimi i disa hapësirave të QKMF-së.
2. Renovimi i disa AMF-ve.
3. Digjitalizimin e rëntgenit.
4. Kompletim i laboratorit në QKMF me aparatura medicinale, si: Centrifug dhe aparat hematologjik.
5. Laboratori në QMF në Pozheran me 1 mikroskop.
6. Furnizimi me 2 karrige stomatologjike, një QKMF dhe 1 në QMF Pozheran.
7. Emergjencia është furnizua me aparat për oksigjen, dy monitor, defiblator, autoclav dhe aspirator.
8. QMF në Pozheran është furnizua me aparat oksigjeni, monitor, defiblator, autoclav dhe aspirator për nxjerrjen e trupave të huaj.
9. Vendosja e klimave në objektet si: në QKMF, Emergjencë dhe në QMF Pozheran.
10. Furnizim me dy rrobalarëse dhe 2 frigoriferë në QKMF.
11. Furnizimi me dollap për arkivin në QKMF.
12. Mbjellja e drunjëve dhe rregullimi i ambientit të jashtëm në QKMF, QMF dhe AMF.
13. Përrurim i AMF-së në Skifteraj. Investim mes Komunës dhe bashkatdhetarëve.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

1. Asgjësimi i mbetjeve medicinale në marrëveshje me Spitalin Regjional të Gjilanit.
2. Instituti Regjional i Shëndetësisë Publike në Gjilan vazhdon me kontrollimin e ujit të pijshëm nëpër vendet rurale si dhe në objektet institucionale dhe ato për qytetarë në vende publike.
3. Vazhdon kontrata dypalëshe në mes të Komunës së Vitisë dhe Caritas Kosova për ofrim të shërbimeve mjekësore nëpër familje, ku paraqitet nevoja për ndihmë mjekësore.

DONACIONET

1. Gjatë kësaj periudhe nga KARITAS Kosova janë ndihmuar 34 familje me gjëra ushqimore dhe veshmbathje.
2. Pranimi nga Rotary Club i 4 automanave.
3. Donacion i bashkatdhetarëve nga fshati Skifteraj me shtretër, frigoriferë, karroca të invalidëve dhe disa pajisje të tjera për AMF në Skifteraj.

PROMOVIMI I SHËNDETIT

- Më datë 31 maj në Viti u shënua Dita Ndërkombëtare kundër pirjes së duhanit. Grupi i Edukimit Shëndetësor në kuadër të QKMF-së në Viti, ka shënua Ditën Ndërkombëtare kundër Duhanit, me një ligjëratë në shkollën e mesme teknike "Jonuz Zejnullahu" në Viti. Është ligjëruar para nxënësve të klasave të 10-ta, duke i njoftuar ata me dëmet shëndetësore dhe pasojat afatgjata që shkakton pirja e duhanit. Në fund janë shpërndarë fletushka me njohuri mbi pasojat e duhanit.
- Më 5 shkurt edhe në Viti, është shënua Dita Ndërkombëtare kundër Kancerit. Në kuadër të kësaj dite janë mbajtur ligjërata para personelit shëndetësor.
- Më 21 mars u lansua programin për fillimin e vizitave në shtëpi për "Kujdesin për nëna dhe fëmijë". Ky program, avancoi shërbimet shëndetësore ndaj fëmijëve dhe nënave të kësaj komune. Ky program u mbështet nga Ministria e Shëndetësisë dhe UNICEF-i.
- Më 11 prill, në kuadër të EVP infermierik në Çerdhen e fëmijëve është mbajtur ligjërata "Parandalimi i deformiteteve të fëmijët" dhe traumave pediatrike.

- Më 13 prill kanë vazhduar vizitat mjekësore sistematike të nxënësve dhe ka realizuar kontrollin mjekësor për nxënësit e klasave të II -ta të Shkollës fillore "Dëshmorët e Vitisë". Me këtë rast, pos kontrolleve mjekësore rutinë , ata janë vizituar edhe nga stomatologu i kësaj qendre mjekësorë.
- Më 18 prill në koordinim me Çerdhen e Fëmijëve "Gëzimi Ynë " në Viti dhe QKMF në Viti, konkretisht pediatria dhe mjeku familjar ka kryer kontroll rutinë të fëmijëve të çerdhes, ku janë vlerësuar fëmijët për sëmundjet eventuale.
- Më 18 prill në Viti, u shënuar Dita e të Drejtave të Pacientëve .Gjatë këtij aktiviteti pacientët janë njohur me të drejtat e tyre dhe përgjegjësit brenda institucioneve shëndetësore. Gjithashtu, ata janë njoftuar edhe me numrin pa pagesë që është i vendosur në institucione shëndetësore, ku pacientët mund të lajmërojnë ndonjë parregullsi të mundshme që hasin gjatë marrjes së shërbimeve shëndetësore. Ky aktivitet është shënuar në QKMF -Viti, QMF-Pozheran, AMF-Tërpezë dhe AMF-Gjylekar.
- Më 24 prill vazhduan aktivitetet e edukimit shëndetësorë në komunitet. Ligjërata e radhës u bë në shkollën fillore "Halil Alidema " në Pozheran , me nxënësit e klasës së III. Tema: "Me ambient të pastër kemi shëndet të mirë".
- Më 27 prill Në kuadër të ZHVP ,QKMF në Viti mbajti aktivitet në komunitet në Shoqatën e Pensionistëve të Vitisë, me temën "Menaxhimi i sëmundjeve degjenerative të kockave të moshuarit".
- Më 15 shtator është organizuar aksioni i pastrimit nga stafi shëndetësor nën moton”Ta pastrojmë Kosovën”.
- Më 29 shtator shënohet dita e ‘Zemrës” , me ç’rast mjekët dhe infermierët e QKMF-së kanë bërë matjen e tensionit arterial tek pacientët kalimtarë të rastit dhe janë dhënë këshilla për mënyrën e të ushqyerit të shëndetshëm.
- Më 1 tetor është vendosur mamografi mobil nga ana e QKUK –së në QKMF-në e Vitisë për 3 javë rresht dhe janë kryer mamografitë për 172 gra.
- Më 1 tetor është shënuar edhe dita ndërkombëtare e të moshuarve ku stafi mjekësor ka vizituar zyrën e pensionistëve dhe ka bashkëbiseduar me pensionistët mbi problemet shëndetësore me të cilat përballen ata dhe duke u dhënë njëkohësisht edhe këshilla.
- Më 9 tetor, në kuadër të muajit të luftës kundër kancerit të gjirit është mbajtur ligjëratë me gratë në fshatin Tërpeze dhe me 10 tetor në fshatin Skifteraj.
- Më 16 tetor shënohet dita botërore e ushqimit dhe është mbajtur një ligjëratë në shkollën fillore “Skender Emërllahu” në fshatin Ramjan nga stafi mjekësor i QKMF-së.
- Më 23 tetor mbahet marshi kundër kancerit të gjirit në qytetin e Vitisë me pjesëmarrje të shumtë.
- Më 25 tetor në fshatin Skifteraj dhe më 29 Tetor në fshatin Buzovik është mbajtur ligjëratë me gratë mbi kancerin e gjirit.
- 8 nëntor shoqata e të drejtave të pacientëve (PRAK) mbajti trajnim me stafin shëndetësor të QKMF-së në Viti.
- Më 14 Nëntor shënohet dita botërore e Diabetit dhe një ekip mjekësor i QKMF-së në sheshin e qytetit të Vitisë dhe në Pozheran kreu matjen e sheqerit në gjak për kalimtarët e rastit dhe u dhanë këshilla për mënyrën e të ushqyerit.
- Më 30 nëntor është shënuar dita ndërkombëtare kundër SIDA-s dhe është mbajtur një ligjëratë në ambientet e shkollës së mesme “Kuvendi i Lezhës” në Viti.

- Në kuadër të ZHVP-së në total janë mbajtur 20 ligjërata nga stafi i lartë dhe i mesëm shëndetësor me tema të ndryshme në kuadër të ngritjes profesionale.

QKMF – VITI ME NJËSITË E SAJA NË TERRITORIN E KOMUNËS SË VITISË

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare bëhet ofrimi i shërbimeve mjekësore për qytetarë sipas këtyre kategorive mjekësore:

1. Shërbimet primare:

- a. Mjekësia familjare;
- b. Stomatologjia;
- c. Imunizimi;
- d. Emergjencia;
- e. Diagnostika (Laboratori dhe Shërbimi Radiologjik).

2. Shërbimet specialistike

- a. Pediatria;
 - b. Gjinekologjia;
 - c. Shërbimi i sëmundjeve të brendshme (Internisti).
- Gjithsesi, në QKMF në qytetin e Vitisë punohet 24-orë. Të gjitha shërbimet mjekësore familjare, stomatologjike, pediatrike, interne, laboratorike si dhe radiologjike kryhen vetëm gjatë ndërrimit të pare të orarit të punës.
 - Qendra e emergjencës punon gjatë 24 orëve për çdo ditë të javës.
 - Gjatë këtij gjashtëmuajori, puna në QKMF duke e krahasuar me të kaluarën, mund të vërehen ndryshime të theksuara si në respektimin e orarit të punës si dhe në cilësinë e shërbimeve të ofruara mjekësore.

QMF-TË SI DHE AMF-TË TË CILAT KANË FUNKSIONUAR GJATË KËSAJ PERIUDHE NË KOMUNËN E VITISË

1. QMF – Pozheran;
2. QMF - Sllatinë e Epërme;
3. QMF – Smirë;
4. QMF – Sodovinë;
5. AMF – Beguncë;
6. AMF – Skifteraj;
7. AMF – Letnicë;
8. AMF – Stubëll;
9. AMF – Tërpezë;

GJENDJA NË TERREN

1. Në Qendrën Mjekësore familjare në Pozheran punohet 24 orë pa ndërprerë. Në kuadër të kësaj qendre ofrohen të gjitha shërbimet e mjekësisë familjare, stomatologjike, por edhe kryhen edhe analizat e ndryshme laboratorike gjatë ndërrimit të parë.
2. Qendra e Mjekësisë Familjare në Sllatinë të Epërme, ofron shërbimet infermierie gjatë gjithë javës në orar të rregullt.
3. Në QMF në fshatin Smirë punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, me shërbime infermierie.

4. Në QMF në Sodovinë, shërbimet infermierie ofrohen çdo ditë pune të javës. (Gjatë gjashtë mujorit të dytë QMF-ja ka qenë nën renovim dhe nuk ka qenë në funksion).
5. Në AMF-ne e Skifterajt punohet dhe ofrohen shërbime çdo ditë pune nga ana e infermierëve përveç vikendit.
6. Në AMF në e fshatit Beguncë mjeku ofron shërbime tri herë në javë dhe ato infermiere çdo ditë pune.
7. Në fshatin Tërpezë shërbimet mjekësore ofrohen çdo ditë pune nga infermieret.
8. Në AMF-në e Stubllës ofrohen një ditë pune shërbim nga ana e mjekut ndërsa shërbime infermierie me orar të plotë madje ofrohen edhe vizita shtëpiake.
9. Në fshatin Goshicë Objekti i AMF-së që kishte në bashkëngjitje një objekt banesor i cili ka pësuar djegie dhe me këtë rast është prekur dhe dëmtuar edhe AMF-ja në fjalë.

Shërbimet e ofruara nga QKMF-QMF dhe AMF-të

Shërbimet të cilat u janë ofruar qytetarëve në QKMF, QMF dhe AMF-të për këtë dymbëdhjetë mujor janë dhënë gjithsejtë **448,798.00** shërbime. Për më tepër, të gjitha llojet e shërbimeve janë të paraqitura përmes tabelës që i bashkëngjitet këtij raporti. (Shih tabelën) mjetet e grumbulluara nga participimi për shërbime shëndetësore janë 56,904.40 €. Gjithashtu për çdo muaj veç e veç mundë të shihet në tabelën e bashkëngjitur. (Shih tabelën), ndërsa të hyra nga qiraja për këtë vit janë 7.920.00 €.

Llojet e shërbimeve shëndetësore në QKMF, QMF dhe Amf-të

| RAPORTE | Vizita | Therje | Transfere | Transferdiag | Lidhje | Inhalime | Këshilla | Ekg | Nr. analizave | Nr. nxjerrjeve | Ultrazë | Liruar nga p |
|---------------------|--------|--------|-----------|--------------|--------|----------|----------|------|---------------|----------------|---------|--------------|
| Emergjenca | 54518 | 50053 | 4739 | | 1667 | | | 1103 | | | | 44350 |
| Mjekësia familjare | 23470 | 13155 | 3964 | | | | | | | | | 27355 |
| Mjekësia familjare | 20320 | | 4324 | | | | | | | | | 16204 |
| Stomatologjia | 2716 | | | | | | | | | 104 | | 2574 |
| Rtg. | 1126 | | | | | | | | | | 565 | 869 |
| Ekipi i terrenit | 1478 | 1188 | | | 51 | | | | | | | 1513 |
| Dhoma e infuzione | | 3429 | | | | | | | | | | 2462 |
| Laboratori | 10511 | | | | | | | | 106282 | | | 8456 |
| Pediatria | 3930 | | 21 | 28 | 47 | | 371 | | | | | 3930 |
| Interno | 1024 | | | | | | | 420 | | | | 901 |
| Kontrolla gjinekolo | 989 | 403 | 18 | | | | 363 | | | | | 1577 |
| Shërbimi i vaksinin | 3291 | 11747 | | | | | | | | | | 3291 |
| Inhalime në QKMF | | | | | | 560 | | | | | | 560 |
| Lidhorja | | | | | 2170 | | | | | | | 2065 |
| Ambulanta Smirë | 4 | 301 | | | 353 | | 602 | | | | | 1249 |
| Ambulanca Sadovi | 1 | 8 | | | 18 | | 133 | | | | | 142 |
| Amb.Sllatinë | | 512 | | | 291 | 11 | 110 | | | | | 901 |
| Amb.Pozheran | 44806 | 31080 | 5770 | | 2247 | 77 | 116 | 146 | | | | 33843 |
| Lab.Pozheran | 4287 | | | | | | | | 42020 | | | 3516 |
| Stom.Pozheran | 82 | | | | | | | | | 42 | | 83 |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|--------------------------|------|-------------------|---------------|--------------|-----------|-------------|------------|-------------|-------------|---------------|------------|------------|--|---------------|
| Amb. Terpeze | 20 | 185 | | | 222 | 32 | 180 | | | | | | | 592 |
| Amb.Skifteraj | 7 | 115 | 2 | | 75 | 2 | 147 | | | | | | | 320 |
| Amb.Beguncë | 99 | 222 | | | 184 | | 133 | | | | | | | 621 |
| Amb. Letnicë | | | | | | | | | | | | | | |
| Amb.Stubëll | 1307 | 316 | | | 146 | 9 | 133 | | | | | | | 1467 |
| Amb.Remnik | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | |
| | | 173986 | 112714 | 18838 | 28 | 7471 | 691 | 2288 | 1699 | 148302 | 108 | 565 | | 159163 |
| GJITHSEJ SHËRBIME | | 448,798.00 | | | | | | | | | | | | |

Pasqyra e mjeteve të grumbulluara nga participimi

| Nr. | Shërbimi | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qesho | Korrik | Gusht | Shtato | Tetor | Nënto | Dhjetor | gjithsej |
|-----|--------------|--------|--------|--------|-------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|---------|----------|
| 1 | Emergjenca | 1326 | 1117.5 | 1161.5 | 899 | 1148 | 1089 | 1169 | 1785 | 1135 | 1590.5 | 1086.5 | 1672.5 | 15,179.5 |
| 2 | Arka 1 | 2608 | 2871.1 | 2652.2 | 1528 | 1613.5 | 1681.6 | 1531.9 | 2931.6 | 2021.4 | 1941.3 | 1844.3 | 1378.7 | 24,603.6 |
| 3 | Pozheran | 1763.5 | 1556 | 1339 | 950 | 966.5 | 1123 | 1177.5 | 2180 | 1255 | 1324 | 1580.5 | 1947.5 | 17,162.5 |
| 4 | Gjylekar | | | | | | | | | | | | 8 | 8 |
| 5 | Tërpezë | | | | | | | | | | | | 19 | 19 |
| 6 | Smirë | | | | | | | | | | | | 18 | 18 |
| 7 | Sllatinë | | | | | | | | | | | | | 77 |
| 8 | | | | | | | | | | | | | | |
| 9 | Beguncë | | | | | | | | | | | | | 13 |
| 10 | Sadovin e Je | | | | | | | | | | | | | |
| 11 | Goshicë | | | | | | | | | | | | | |
| 12 | Letnicë | | | | | | | | | | | | | |
| 13 | Stubell e E. | | | | | | | | | | | | | 42 |
| 14 | Gjithsej | | | | | | | | | | | | | 56,904.4 |

ZHVILLIMI DREJT NGRITJES SË CILËSISË SË KUJDESIT SHËNDETËSOR

- Trajnimet e stafit mjekësor dhe infermiereve përmes seminareve dhe trajnimeve të ndryshme. Gjatë kësaj periudhe punëtorët shëndetësorë kanë qenë pjesë e trajnimeve të organizuara në Viti, Gjilan, Ferizaj, Prizeren, Pejë dhe Prishtinë.
- Dërgimi i mjekëve në specializim.
- Aktivitet të edukimit të vazhdueshëm profesional (EVP), ku për gjashtëmujorin e parë janë mbajtur shtatëmbëdhjetë ligjërata nga stafi shëndetësor.

RAPORT NGA QPS-JA, JANAR -DHJETOR 2018

Qendra për Punë Sociale (QPS) është organ publik i administratës, e cila aktivitetin e vet punes e ushtron në kuadër të Administratës Komunale në Viti, njësi e DSHMS-së, ofron shërbime për të gjithë qytetaret që gjenden në territorin e Komunës e që kanë nevojë për këto shërbime. Për periudhën kohore 01.01 deri më 31. 12. 2018, punët në kuadër të QPS-Viti kanë rrjedhë me disa pengesa, nga punëtorët e asistencës është kërkuar angazhim shtesë, për të ofruar shërbime sa më të mira. Numri i punëtorëve të angazhuar në shërbimin e asistencës 2 punëtor, ishte vetëm 1 punëtor, por gjatë kësaj kohe është pranuar

një punëtor i ri, por, ende paraqet problem mungesa e punëtorëve në këtë shërbim që reflekton në punën efikase e pa pengesa në gjithë qendrën. Mungojnë edhe 2 punëtorë pasi që nga pjesa e parë e vitit paraprak dy punëtor kanë dalë në pension të parakohshëm, mungesa e tyre kohë pas kohe është plotësuar me punëtor për shërbime të veçanta, plotësimi këtyre vendeve është nevojë permanente dhe emergjente, pa të cilët nuk jemi në gjendje as ti përmbushim format obligative ligjore gjatë punës, në Shërbimin social janë angazhuar 4 punëtor, shefi shërbimit dhe 3 punëtorë tjerë, të njëjtit kanë munguar kohë pas kohe pasi kanë shfrytëzuar pjesën e mbetur të pushimit vjetor nga viti paraprak, është angazhuar 1 punëtor për administratë e financa dhe Drejtori i QPS-së.

a) SHËRBIMI SOCIAL

Pasqyra statistikore e shërbimeve sociale 01.01.deris më 31.12.2018

| Nr. | Kategoritë e shërbimeve të ofruar për fëmijët | Rastet e vjetra | Rastet e reja | Gjithsejtë |
|-----|--|-----------------|--------------------|------------|
| 1. | Fëmijë të keqtrajtuar seksualisht | 3 | 1. | 4. |
| 2. | Fëmijët e keqtrajtuar fizikisht | 15 | 12 | 27 |
| 3. | Fëmijët në punë të rrezikshme | 0 | 0. | 0. |
| 4. | Fëmijët viktime të trafikimit a-vendor b. Ndërkombëtar | 0 | 0. | 0. |
| 5. | Fëmijët e keqtrajtuar-abuzuar(lënë pas dore) | 0 | 0. | 0. |
| 7. | Fëmijët me sjellje asocial-vështirësi në sjellje | 49 | 12 | 61 |
| 8. | Të miturit në konflikt me ligjin | 101 | 93. | 194. |
| 9. | Kontakt i fëmijëve me prind | 23 | 8. | 31. |
| 10 | Fëmijë pa përkujdesje vendosur në familje streh. | 0 | 1. | 1. |
| 11. | Vendosja e fëmijëve në shtëpi tranzitore | 2. | 0. | 2 |
| 12. | Vendosja e fëmijëve në strehim familjar tek të afërmit | 17 | 1 | 18. |
| 13. | Kërkesa për adoptim ndërkombëtar | 0 | 0. | 0. |
| 14. | Kërkesa për vendosjen në adoptim vendor | 3. | 3. | 6. |
| 15. | Vendosja e fëmijëve në kujdestari | 44 | 4. | 48. |
| 16. | Besimi fëmijëve –raportet e çrregulluara bashkëshorë | 39 | 30. | 69. |
| 17 | Regjistrim i mëvonshëm | 0 | 0. | 0. |
| 18 | Ndryshim i emrit | 0 | 0. | 0. |
| 19. | Vërtetim me shkrim mbi pranimin e atësisë dhe amësisë | 0 | 0. | 0. |
| 20. | Vërtetim për udhëtim të fëmijës jashtë vendit | 0 | 2. | 2 |
| 21. | Martesë e parakohshme | 0 | 0. | 0. |
| 22. | Përfaqësimi në Gjykatë ku përfshihen fëmijët | 0 | 54 | 54 |
| 23 | a. Mbikëqyrja organit, b. Qortim, C. Kujdesi social në familjes, burg(shqiptimi i masave nga Gjykatat) | | a.8, b.9, c. 8. q. | 26 |
| 24 | Mbrojtja e fëmijëve me aftësi të kufizuar | 56 | 13 | 69 |
| | Numri i përgjithshëm i fëmijëve të trajtuar | 352 | 260 | 612 |

Personat madhor dhe të moshuarit në nevojë për shërbime sociale

| Nr. | Kategoritë e shërbimeve ofruar për personat madhor e moshuar | Raste të vjetra | Të reja | Gjithsejtë |
|-----|--|-----------------|---------|------------|
| 1 | Personat madhor viktimë e dhunës në familje | 3 | 28 | 31. |

| | | | | |
|-----|---|---|---------------|-----|
| 2. | Personat madhor viktimë e trafikimit:a.- Vendo Ndërkombëtar | 0 | 0. | 0. |
| 3. | Klient tjerë në nevojë për shërbime | 0 | 79. | 79. |
| 5. | Vërtetim për lënie të nënshtetësisë | 0 | 87. | 87. |
| 6. | Vërtetim për zotësinë e veprimit (për armë) | 0 | 92. | 92. |
| 7 | Vërtetim për zotësinë e veprimit (për punësim) | 0 | 10 | 10. |
| 8. | Shqiptim të masave nga Gjykata për personat madhor sëmundje psikike | 0 | 1. | 1. |
| 9.. | Lëndët për komision mjekësor shkalla e 2 | 0 | 3. e refuzuar | 3. |
| 10 | Përfaqësimi në gjykatë i personave me zotësi të kufizuar v | 0 | 5. | 5. |
| 11. | Verifikim të atësisë | 0 | 0 | 0 |
| 12. | Te moshuarit pa përkujdesje të vendosur në inst. | 0 | 3 | 3 |
| 13. | Personat madhor me aftësi të kufizuar vendosur në insti. | 4 | 0. | 4. |
| 14 | Personat e moshuar pa përkujdesje | 0 | 3 | 3 |
| 15 | Lypsari në rrugë | 0 | 1 | 1 |
| 16 | Tentim vrasje | 0 | 1 | 1 |
| 17 | Përdorues të narkotikëve | 0 | 1. | 1. |
| 18 | Urdhër mbrojtës për viktimat e dhunës në familje | 0 | 4 | 4. |
| 19 | Ankesat e palëve në DPSF | 0 | 1 | 1 |
| | Numri përgjithshëm i klientëve që kanë marrë shë mbrojtëse sociale nga shërbimi social për të gjitha kategor kuadër të QPS-Viti | 7 | 319 | 326 |

Pagesa totale për shërbimet

| Nr. | Kategoria | Shuma 12 mujore e pagesave |
|-----|--|----------------------------|
| 1. | Strehimi familjar te të afërmit | 15,150.00 € |
| 2. | Fëmijët e braktisur në familjen Strehuese | 1,750.00€ |
| 3. | Fëmijët me aftësi të kufizuar-nevoja të veçant | 68,300.00 € |
| | Gjithsejtë | 85,200.00€ |

b) SHËRBIMI I ASISTENCES SOCIALE FAMILJET QË KANË RIAPLIKU-APLIKU 2018

| Muaji | Riaplikim Poz - Neg | Aplikim Poz -Neg | Të nderprituna | Totali |
|------------|------------------------|---------------------|----------------|-----------------|
| Janar-114 | 103-03 | 08-00 | 03.familje | 111.familje.poz |
| Shkurt-90 | 75-01 | 14-00 | 01.familje | 98.familje .poz |
| Mars-97 | 80-03 | 11-03 | 04.familje | 91.familje.poz |
| Prill-87 | 67-02 | 11-03 | 04.familje | 81.familje.poz |
| Maj-52 | 49-00 | 02-01 | 02.familje | 51.familje.poz |
| Qershor-32 | 29-00 | 03-02 | 15.familje | 30.familje.poz |
| Korrik-53 | 37-01 | 04-00 | 15.familje | 41.familje.poz |
| Gusht-43 | 39-02 | 01-01 | 13.familje | 27.familje.poz |

| | | | | |
|------------|-------|-------|------------|----------------|
| Shtator-39 | 34-02 | 03-00 | 07.familje | 30.familje.poz |
| Tetor-45 | 42-00 | 03-00 | 00.familje | 45.familje.poz |
| Nëntor-58 | 50-02 | 05-01 | 00.familje | 55.familje.poz |
| Dhjetor-51 | 44-00 | 06-01 | 05.familje | 50.familje.poz |

FAMILJET QË KANË QENË NË KOMISION MJEKËSORË

| Muaji | Nr. familjeve | Pagesa | | |
|---------|---------------|------------|--|--|
| Janar | 568.familje | 62747.50 € | | |
| Shkurt | 585.familje | 64227.50 € | | |
| Mars | 584.familje | 64807.50 € | | |
| Prill | 569.familje | 62520.00 € | | |
| Maj | 573.familje | 63392.50 € | | |
| Qershor | 555.familje | 60817/50 € | | |
| Korrik | 538.familje | 58057.50 € | | |
| Gusht | 520.familje | 57287.50 € | | |
| Shtator | 511.familje | 55277.50 € | | |
| Tetor | 505.familje | 54887.50 € | | |
| Nëntori | 514.familje | 55440.00 € | | |
| Dhjetor | 510.familje | 54,980.00€ | | |

PASQYRA FINANCIARE SIPAS MUAJVE

| Muaji | Nr.i familjeve | Positive | Negative | N3 shqyrtim |
|----------------|----------------|------------|------------|-------------|
| Janar | 63.familje | 59.familje | 00.familje | 04.familje |
| Shkurt | 27.familje | 24.familje | 02.familje | 01.familje |
| Mars | 34.familje | 30.familje | 04.familje | 00.familje |
| Prill | 32.familje | 32.familje | 00.familje | 00.familje |
| Maj | 19.familje | 18.familje | 01.familje | 00.familje |
| Qershor | 24.familje | 24.familje | 00.familje | 00.familje |
| Korrik | 26.familje | 19.familje | 00.familje | 07.familje |
| Gusht | 17.familje | 15.familje | 01.familje | 01.familje |
| Shtator | 44.familje | 43.familje | 01.familje | 00.familje |
| Tetor | 43.familje | 43.familje | 00.familje | 00.familje |
| Nëntor | 34.familje | 30.familje | 04.familje | 00.familje |
| Dhjetor | 22.familje | - | - | Në shqyrtim |

STATISTIKA E PUNËVE TË KRYERA NË SHËRBIMET E ASISTENCËS SOCIALE

| | |
|----------------------------|-----|
| 1. Riaplikime | 765 |
| a. Pozitive..... | 749 |
| b. Negative..... | 016 |
| 2. Aplikime | 075 |

| | |
|--|------------|
| a. Pozitive..... | 63 |
| b. Negative..... | 12 |
| 3. Komision Mjekësor..... | 359 |
| a. Pozitive..... | 346 |
| b. Negative..... | 13 |
| 4. Kërkesa për Subvencione..... | 06 |
| a. Pozitive..... | 04 |
| b. Negative..... | 02 |
| 5. Vërtetime për Studentë | 09 |
| 6. Ankesa shkalla e pare..... | 12 |
| a Pozitive..... | 02 |
| b. Negative..... | 09 |
| 7.Ankesa Shkalla e dytë..... | 05 |
| a. Pozitive..... | 00 |
| b. Në Shqyrtim..... | 01 |
| 8. Ankesa në Gjykatë..... | 01 |
| 9.Vërtetima pa pagesë..... | 38 |
| 10.Vërtetima me pagesë..... | 224 |
| a. Për shtesa fëmijërore jashtë shtetit..... | 57 |
| b. Për marrje të shtetësisë..... | 05 |
| c. Për mbështetje të rriturve..... | 167 |
| 11. Propozim për Autorizim..... | 02 |

STRUKTURA NACIONALE E FAMILJEVE DHE ANTARVE NË SNS

| Nacionaliteti | N.i Familjeve | % | Nr.i antarve | % | Shuma | % |
|---------------|---------------|--------|--------------|--------|-----------|--------|
| Ashkali | 4.familje | 1.38% | 18.antar | 0.80% | 445.00 | 0.81% |
| Goran | 2.familje | 0.64% | 5.antar | 0.22% | 167.50 | 0.30% |
| Kroat | 5.familje | 0.71% | 8.antar | 0.35% | 330.00 | 0.60% |
| Sërb | 6.familje | 1.55% | 21.antar | 0.93% | 581.50 | 1.07% |
| Shqiptar | 493.familje | 95.71% | 2203.antar | 97.69% | 53,450.00 | 97.22% |

SIPAS KRITEREVE DHE GJINISË

| | | | | | | |
|--------|--------|--------|--------|----------------|--------|----------------|
| M | F | totali | M | F | M | F |
| 760 | 983 | 1743 | 222 | 172-totali.394 | 98 | 18 –totali-116 |
| 43.60% | 56.40% | | 56.35% | 43.65% | 84.48% | 15.52% |

STATISTIKAT GJINORE

NUMRI I ANTARVE SIPAS GRUP MOSHAVE

| | | | | | | |
|--------------|--------|--------|--------|--------|-------|--------|
| Grup mosha | 0-5 | 6-14 | 15-18 | 19-65 | 65+ | Totali |
| Nr.i anuarve | 264 | 585 | 258 | 1094 | 54 | 2255 |
| % | 11.71% | 25.94% | 11.44% | 48.51% | 2.39% | |

Kërkesa për subvencione nga DMS

| | | | |
|----------|----------|-------------|------------|
| Negative | Pozitive | Në shqyrtim | Gjithsejtë |
| 2 | 3 | 1 | 6 |

SIPAS KRITEREVE DHE GJINISË

Totali i pagesave për këtë 12 mujor sipas numrit të familjeve

| | |
|---|----------|
| Totali i numrit të pagesave për familje | 6,532.00 |
| Mesatarja mujore e pagesave për familje | 544.00 |

III.SHERBIMI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE

Totali i të hyrave vetanake për 12 mujor

| | | |
|--------|------------|------------|
| | Inkasuar | Dorëzuara |
| Totali | 2,602.00 € | 2,602.00 € |

| | | | |
|--|-----|-----|--------|
| KRITERET | M | F | Totali |
| 6-Prind vetushqyes | 0 | 11 | 11 |
| 7-Person mbi 18 vjeç, i pa aftë për punë mbi 80% | 133 | 72 | 205 |
| 8-I pa punësuar | 97 | 16 | 113 |
| 9-Kujdestar | 62 | 66 | 128 |
| 10-Persona me pension me aftësi të kufizuara (PPAK) | 7 | 1 | 8 |
| 15-Persona me Pension Bazë | 13 | 1 | 14 |
| 18-Kujdestar-Person me Pension të aftësive të kufizuara (PPAK) | 3 | 1 | 4 |
| 21-Persona të vetëm mbi 18 vjeç i pa aftë për punë mbi 80% | 5 | 22 | 27 |
| TOTALI: | 320 | 190 | 510 |

Drejtoria për Arsim

1. Qëllimi dhe funksionimi i Drejtorisë

Qeverisja Komunale në vazhdimësi gjatë këtij viti ka bërë përpjekje, që në fushën e Arsimit, së bashku me rregullimin e infrastrukturës, kushteve më të mira për nxënësit dhe personelin, vëmendje dhe përkushtim të veçantë i ka kushtuar ngritjes së cilësisë dhe rezultateve të nxënësve, duke monitoruar mësimdhënien dhe mësimnxenien.

Arritjet dhe rezultatet e nxënësve, si në testin e maturës, atë të arritshmerisë apo rezultateve në sukseset e studimeve, garat e ndryshme, si në lëndet shkencore dhe ato shoqërore, sportive dhe kulturore, duke na përfaqësuar në arenën vendore dhe ndërkombëtare, tregojnë për një ngritje të cilësisë dhe për sukseset të cilat janë motive dhe për angazhim edhe me të madh, si për menaxhmentin ashtu edhe për personelin arsimor.

Këto të arritura dhe rezultatet jemi munduar që nxënësve dhe personelit arsimor, s'bashku me donatorët, të ju krijojmë kushtet me të mira dhe me të avancuar të procesit mësimor.

Komuna e Vitisë, s'bashku me Fondacionin Kosove Luksenburg, kemi furnizuar shkollat me pajisje digjitale, duke e bërë Komunën e Vitisë të parën në vend, e cila do të punoj në sektorin e mësimdhënies me metoda të avancuar. Po ashtu përmes Demosit, Helvetasit dhe Qendrës Rinore kemi organizuar trajnime dhe pune praktike për nxënësit e shkollave të mesme, duke i përgatitur për tregun e punës. Po ashtu me UNDP-në dhe ADEN Austriake, kemi promovuar kabinetin e teknologjisë ushqimore.

Jemi të përkushtuar, që të respektojmë gjithëpërfshirjen, duke bërë përpjekje që të gjithë nxënësit t'ju ofrojmë qasje në arsimin fillor dhe të mesëm dhe duke ju ofruar kushte me të mira.

Fillimi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve dhe shkollave, është një nga prioritetet, duke i motivuar mësimdhënësit për ngritje të cilësisë në mësimdhënie dhe ngritjen e vazhdueshme profesionale përmes.

2. Sektori i Arsimit të Mesëm

Gjatë viti 2018, në arsimin e mesëm, konkretisht në tri shkollat e mesme që janë në Komunën e Vitisë, janë realizuar objektivat e punës dhe janë arritur rezultatet duke i përfshirë edhe sfidat dhe pengesat. Si e arritur: Kalueshmëria e testit të maturës dhe sukseset e nxënësve në regjistrimin e studimeve.

Sektori i Arsimit të Mesëm me kohë ka realizuar përgatitjet për testin e maturës dhe atë për dy afatet. Në testin e Maturës në afatin e qershorit për vitin shkollor 2017/18, kanë marr pjesë 695 maturantë, ku 518 maturant e kaluan testin, 177 maturant mbesin për afatin e gushtit. Kalueshmëria është 74.5%.

Testi i Maturës edhe për afatin e gushtit u krye me sukses. Nga 123 nxënës që morën pjesë në test, 81 nxënës e kaluan testin (66%), ndërsa 42 nxënës nuk i kanë arritur pikët e mjaftueshme për të kaluar testin (34%).

Janë kryer përgatitjet dhe janë regjistruar nxënësit në klasën e dhjetë të shkollave të mesme.

Në tri shkollat e mesme për vitin shkollor 2018/19 janë regjistruar 680 nxënës në klasat e dhjeta.

Në shkollat e Mesme vijojnë mësimin gjithsej 2161 nxënës, Gjimnazi "Kuvendi i Lezhës", 1079, Shkolla Profesionale "Januz Zejnullahu", 743 nxënës, Shkolla e Mesme Mikse "Kongresi i Manastirit", 339 nxënës

Janë mbajtur debate, konsulta për tema të ndryshme rreth dukurive negative të nxënësve nëpër shkolla. Nxënësit përmes projekteve, aktiviteteve dhe trajnimeve të organizuara nga organizatat e ndryshme, si ato vendore dhe ndërkombëtare, kanë arritur të çartifikohen rreth 240 nxënës për tregun e punës.

Po ashtu arsimtarët e fushave të ndryshme, me qëllim të ngritjes së tyre profesionale kanë marrë pjesë në trajnime, seminare, debate etj.

Në mënyrë të rregullt është përcjell procesin mësimor në vazhdimësi.

Janë bërë përgatitjet e domosdoshme për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/19.

Janë kontrolluar të gjitha shkollat në aspektin profesional pedagogjik si dhe i gjithë dokumentacioni i nevojshëm.

3. Sektori i Arsimit të Mesëm të Ulët, Fillor dhe Para Fillor

Ky sektor është i organizuar në 17 shkolla, të cilat funksionojnë me paralelet e ndara, të cilat koordinohet dhe menaxhohen nga ana e drejtorëve. Po ashtu edhe Çerdhja e fëmijëve "Gëzimi Ynë".

- ❖ **Sektori i Arsimit të Mesëm të Ulët, Fillor dhe Para Fillor** me kohë i ka bërë të gjitha përgatitjet dhe organizimin e testit të arritshmërisë.
- ❖ Testi i arritshmërisë u mbajt në muajin maj 2018, ku morën pjesë 771 nxënës të klasave të nënta.
- ❖ DKA-ja me kohë ka mbledhur shënimet për numrin e nxënësve të shkollave fillore të cilët duhet të pajisen me tekste mësimore për vitin e ri shkollor 2018/19, të cilat janë shpërnda sipas shkollave.
- ❖ Të gjithë nxënësit e shkollave fillore janë pajisur me tekste mësimore sipas planit të MASHT-it.
- ❖ Janë planifikuar paralelet me nxënësit fillestar që do të regjistrohen në klasën e pare për vitin e ri shkollor.2018/19.
- ❖ Paralele të klasave të para, 45 paralele.
- ❖ Në klasën e parë për vitin shkollor 2018/19, në 17 shkolla fillore dhe 18 paralele të ndara janë regjistruar 678 nxënës.
- ❖ Në vitin shkollor 2018/19, në 17 shkolla fillore amë dhe 18 paralele të ndara.
- ❖ Në shkollat fillore mësimin e vijnë 6503 nxënës, duke përfshirë edhe çerdhen „Gëzimi Ynë” me 65 fëmijë të grup moshave të 1-6 vjeç.
- ❖ Janë mbajtur debate, konsulta për tema të ndryshme rreth dukurive negative të nxënësve nëpër shkolla.
- ❖ Po ashtu arsimtarët e fushave të ndryshme, me qëllim të ngritjes së tyre profesionale kanë marrë pjesë në trajnime, seminare, debate etj.
- ❖ Në mënyrë të rregullt kemi përcjell procesin mësimor në vazhdimësi.
- ❖ Janë zhvilluar shumë aktivitete jashtë shkollore, duke organizuar, gara, programe të ndryshme kulturore si për 1 Qershor, 17 Shkurt, 28 Nëntor dhe në gjitha shkollat janë zhvilluar aktivitete e shumta për ditën e shkollave.

4. Shërbimi psikologjik

- ❖ Është bërë evidentimi i rasteve (nxënësve), të cilët kanë nevojë për shërbim psikologjik.
- ❖ Vazhdim i psikoedukimit me nxënës, duke përfshirë fusha të ndryshme.
- ❖ Administrimi i testeve psikologjike, duke përfshirë ata të inteligjencës, personalitetit, organicitetit etj. (HTP test, Mini School test, Unit test, Bender Gestalt test 1, Bender Gestalt 2, Kohchs test, Raven test, Vineland scale, EPI test, MMPI 201 test etj).
- ❖ Mbajtja e seancave psikoterapeutike.
Nxënësit janë trajtuar me:
 - ❖ Këshillim psikologjik;
 - ❖ Teknika biheviorale;
 - ❖ Psikoterapi pozitive;
 - ❖ Psikoterapi trupore;
 - ❖ Psikoterapi familjare pozitive;

- ❖ Pune e vazhdueshme tek klasa e bashkëngjitur me nxënësit me nevoja të veçanta;
- ❖ Është vazhduar pua e Ekipes për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.
- ❖ Mësimi i shkrim leximit dhe zbatimi i alfabetit Braille, për nxënësit e verbër dhe për ata me vështirësi në të pamurit.
- ❖ Janë organizuar ligjërata me tema të caktuar që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve.
- ❖ Janë mbajtur sesione informuese dhe këshilluese për nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit lidhur me punën individuale të fëmijëve me nevoja të veçanta.
- ❖ Hartimi i draft-udhëzuesve në MASHT, për garat në nivel komunal, republikan dhe rajonal.
- ❖ Takim dhe shkëmbim i përvojave me psikologët e komunave tjera.
- ❖ Takime me TMR-në (tryeza e menaxhimit të rasteve) në Qendrën për Punë Sociale (QPS) dhe trajtimi i rasteve të referuara nga QPS-ja.

5. Sektori i personelit dhe ai juridik

- ❖ Në periudhën kohore janë pranuar 350 lëndë të natyrave të ndryshme;
- ❖ Kemi marr pjesë në 24 përfaqësime në Gjykatën Themelore - Dega në Viti si dhe 36 përgjigje në padi për gjykatën Themelore Dega në Viti, 2 ankesë në Gjykatën e Apelit;
- ❖ Janë hartuar 250 vendime, përgjigje në kërkesa, vërtetime, pëlqime të ndryshme për palët dhe mësimdhënësit;
- ❖ Janë lëshuar 3 urdhëresa;
- ❖ Janë 8 konkurse publike për mësimdhënësit;
- ❖ Janë shpallur 4 konkurse publik për pozitat drejtor shkollash dhe 5 drejtorive ju është vazhduar mandati në bazë të udhëzimit administrativ;
- ❖ Të gjitha shkollat menaxhohen me drejtor të zgjedhur, asnjë shkollë nuk udhëhiqet me ushtrues detyre;
- ❖ Kemi zhvilluar procedurën e rekrutimit të punëtorëve arsimor;
- ❖ Me kohë kemi shpallur konkursin publik për kuadër arsimor për vitin e ri shkollor 2018/19;
- ❖ Me kohë i kemi pajisur punëtorët arsimor me kontrata të punës (akt-emërime);
- ❖ Të gjitha vendet e lira i kemi mbuluar përmes konkurseve publike;
- ❖ Si dhe punë të tjera juridiko-administrative të natyrave të ndryshme: përgjigje në kërkesa, shqyrtimin e ankesave, njoftime të ndryshme etj.
- ❖ I kemi dërguar raportin MASHT-it për numrin e nxënësve, të mësimdhënësve, të objekteve shkollore të hapësirave gjelbëruese.
- ❖ Me kohë kemi shpallur konkursin publik për kuadër arsimor për vitin e ri shkollor 2018/19. Kemi pranuar kërkesat, njoftimet nga shkollat për vendet e lira të punës.
- ❖ Me rastin e rekrutimit (pranimit) të personelit arsimor, kemi zbatuar normativin në fuqi, duke filluar nga Ligji për Arsim dhe aktet tjera nënligjore.
- ❖ Me rastin e pranimit të personelit arsimor, nuk kemi asnjë rast ku kemi bërë shkelje ligjore apo shkeljen e të drejtave të aplikantëve, sepse nuk kemi lejuar të anashkalohej kualifikimi, rezultatet e testit me shkrim dhe me gojë. Për këtë e dëshmon që nga 57 pozitat për mësimdhënësit e pranuar dhe nga 4 pozitat për zgjedhjen e drejtorëve, asnjë pozitë nuk është anuluar nga shkalla e dytë.
- ❖ Gjatë punës ky sektor gjithmonë ka parasysh parimin e efikasitetit në punë, me rastin e shqyrtimit të kërkesave, ankesave, qasjen në dokumente publike dhe veprimeve tjera procedurale, duke respektuar afatet ligjore dhe zyrtare.

Personeli Arsimor dhe ai Administrativ në sektorin e Arsimit

| Administrata e Arsimit | Çerdhja “Gëzim | Arsimi fillor | Arsimi i Mesëm | Totali |
|------------------------|----------------|---------------|----------------|------------|
| 16 pozita | 15 pozita | 616 pozita | 169 pozita | 816 pozita |

6. Sektori i Financave dhe Investimeve Kapitale

- Sektori I Financave në vazhdimësi i ka përcjellur të gjitha kërkesat dhe nevojat e shkollave, duke përfshirë edhe punët dhe shërbimet mujore, siç është përgatitja dhe deklarimet e mësimdhënësve dhe personelit në sektorin e Arsimit.

Gjatë vitit 2018 shkollat janë furnizu me kohë me të gjitha kërkesat dhe nevojat të paraqitura në DKA.

- Shpërndarje e parave të imta në shkolla (peti keshi).
- Ndryshime në listat e pagave, ku përfshihen: largime nga listat, punëtor të rinj, ndryshime (ndërrim institucioni, ndalesë mjekësore dhe e lehonisë, ndalesë për mungesa etj), pagesa retroaktive, ndërrim llogarisë bankare, ku gjithsej kanë qenë 431.
- Përgatitja e planit të prokurimit për vitin 2019.
- Pranimi shpërndarja dhe kompletimi me nënshkrime I listave të pagave.
- **Furnizimi me dru** zjarri për vitin shkollor 2018-19 ku janë blerë 2865 metra, me çmim 42.90€, gjithsej shuma 122908.50€
- Furnizimi me ditarë dhe material pedagogjik.
- Furnizime me tonera letër dhe material hargjues.
- **Furnizim me inventarë në shkollat:** Gjumnazi” Kuvendi i Lezhës”, ”Dëshmoret e Vitisë”, ”Ndre Mjeda”, ”Nazmi Pajaziti”, ”Bafti Haxhiu”, ”Dëshmoret e Lubishtës”, ”Kenan Halimi”, “ Halil Alidema”, “Skender Emerllahu”.
- Ndërrimi I dyerve në disa shkolla si:”Bafti Haxhiu”, ”Dëshmoret e Vitisë”,Drobesh,”Mirali Sejdiu” Gërmovë.
- Furnizimi i çerdhës me perde dhe tepison.
- Përgatitja e buxhetit për vitin buxhetor 2019.
- Mbyllja dhe barazimi I petikeshave të shkollave.
- Renovimi I tërësishëm i çerdhës” Gëzimi Ynë” në Viti.
- **Renovimi i 14 objekteve shkollore** me të hyra vetanake
- Renovimi i shkollës së mesme” Kongresi i Manastirit” në Pozheran.
- Renovimi i shkollës Sllatinë e Epërme “Njazi Rexhepi” Tek lagjja, renovimi e shkollës Devajë “Renovimi i shkollës Vërban, Renovimi i shkollës Ramjan, Renovim i shkollës Fshati i RI, Renovim i shkollës Radivojc, Renovimi i shkollës Gërmovë, Renovim i shkollës “Bafti Haxhiu” Viti, Renovimi i shkollës Binçë. Ka përfunduar vendosja e rrethojave në shkollën e fshatit Goshicë, Sllatinë e Epërme si dhe Tërstenik si dhe në fshatin Radivojcë.
- **Janë ndërtuar këto fusha sportive:** Ramnishtë, Trestenik, Buzovik, Ballancë, Sllatinë e Epërme, Gërmovë, Radivojc, Beguncë.
- **Rregullimi i parqeve në oborret e shkollave:** Shkolla “Jonuz Zejnullahu” Viti, Shkolla “Kongresi i Manastirit” Pozheran, Shkolla “28 Nëntori” Sadovin e Jerlive, Shkolla “Dëshmorët e Lubishtës” Lubishtë, Shkolla “Ndre Mjeda” Kabash, Shkolla “Nazim Pajaziti” Radivojc, Shkolla “Njazi Rexhepi” Sadovin e Çerkezve, Shkolla “Skender Emërllahu” Ramjan, Shkolla “28

Nëntori” Vërban, Shkolla “Njazi Rexhepi” Sllatinë e Ulët, Shkolla “Dëshmorët e 5 Prillit” Smirë, Shkolla “Safet Rexhepi” Zhiti, Shkolla “ Dëshmorët e Vitisë” Viti.

- Janë furnizuar shkollat me material harxhues: si toner, letër pajisje të imta etj
- Janë furnizuar shkollat me material hixhenik dhe kërkesa tjera për mirëmbajtjen e hapësirave në shkollë.

7. Bashkëpunimet dhe Donatorët

- ❖ Bashkëpunime me organizatat dhe donatorë.
- ❖ Me Fondacionin Kosovë Luksenbur janë pajisur shkollat me llaptop, projektor, printer-copy dhe është instaluar sistemi i rrjetit.
- ❖ Bashkëpunimi me Peace Corpes Kosova (vullnetaret amerikan) ne dy shkolla në Ramjan dhe Pozheran.
- ❖ Fillimi i projektit me USAID dhe Programin ASSET (rregullimi i qendrës së inovacionit dhe ndërmarrësisë) në Gjimnazin “Kuvendin e Lezhës”.
- ❖ Rregullimi i qëndresën së inovacionit në shkollën e mesme profesionale dhe ne shkollën e mesme mikse në Pozheran.
- ❖ Me fondacionin Kosovë Luksemburg dy shkollat në Sodovinë të Jerlive dhe në Gëmovë janë pajisur me kabinetet, mjetet konkretizimi, rregullim te bibliotekave dhe të klasave të parashkollloreve.
- ❖ Ne SHFMU” Kenan Halimi” është furnizuar shkolla me dollap për libra.
- ❖ Me projektin e GIZ-it janë trajnuar 150 mësimdhënës.
- ❖ 6 Shkollat fillore janë përzgjedhur nga GIZI në projektin të mësuarit së bashku.
- ❖ Let’s Do Kosova ka mbajtur trajnim me 35 mësimdhënës të fushës së ambientit.
- ❖ Projekti i Bankës Botërore kanë financuar në Shkollën “5 Prilli” në Smirë për teknologji informative, kabinet te informatikës, trajnime dhe aktivitetet tjera.
- ❖ SHFMU” Halil Alidema” eshë pjesë e projektit të Këshillit të Evropës “HELLO”.

8. Vështirësitë të cilat kanë qenë evidente gjatë vitit shkollor 2018

- ❖ Po ashtu edhe shkolla fillore në Pozheran është objekti vjetër dhe pa dyshim paraqet pengesë për zhvillimin normal të procesit mësimor.
- ❖ Kemi një rënie të numrit të nxënësve në zonat rurale ku na ka sjellë vështirësi pasi ndarja e grandit specifik të buxhetit për arsim ndahet për nxënës kemi pasur një zvogëlim të këtij grandit.
- ❖ Zvogëlimi i vazhdueshëm i numrit te nxënësve, si pasoje e rënies se natalitetit, dhe migrimit po reflektohet ne shuarjen e paraleleve dhe për pasoj po vie deri te reduktimi i vendeve te punës së mësimdhënësve. Mirëpo ne vazhdimisht po kërkojmë zgjidhje duke planifikuar me kohë dhe duke bërë transferimin e mësimdhënësve nëpër shkolla.
- ❖ Numri i vogël i zyrtarëve në DKA-së, po paraqet sfidë për realizimin e të gjitha objektivave.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Ky raport është i bazuar në kërkesat dhe detyrave te cilat jemi të obliguar, që në harmoni me planet qe janë të dala nga: “Plani zhvillimor Komunal” nr.01-013/126 i datës 07.02.2011,”Plani zhvillimor Urban” me nr. 01-013/126, i datës 07. 02. 2011.

Planet rregulluese: “Zona Qendrore dhe Jugore dhe Lumi” me nr.01-013/1275, i datës 21.02.2013 si dhe “Zona Veriore” me nr.01-013/869, i datës 08.10.2013.

Implementimin e kriterëve ndërtimore të dalë nga: ”Rregullorja për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve në Komunën e Vitisë” nr. 01-013/317, të datës 15.03.2011.

Kontrollimi i planeve rregulluese detale të miratuara në raport me kërkesat për ndërtim nga qytetaret.

Kërkesa për dhënie të informatave për parcelat të ndryshme, se çfarë destinimi kanë me plane zhvillimore komunale dhe urbane.

Gjatë periudhës vjetore të vitit 2018, kjo drejtori ka kryer këto punë dhe aktivitete të përshkruara sipas planit të punës për vitin 2018:

Kjo drejtori ka kryer këto punë dhe aktivitete të përshkruara sektor për sektor:

Sektori i Urbanizmi

Gjithsej 26 kërkesa

| | |
|---|-----------|
| ❖ Kërkesa për pëlqime urbanistik | 10 |
| • Të shqyrtuara | 10 |
| • Të miratuara | 08 |
| • Të refuzuara | 02 |
| • Në proces | 00 |
| | |
| ❖ Kërkesa për leje ndërtimore | 16 |
| • Të shqyrtuara | 15 |
| • Të miratuara | 10 |
| • Të refuzuara | 05 |
| • Në proces..... | 01 |

Sektori i Planifikimit

- Është marr Vendimi për fillimin e hartimit të Plnit Zhvillimor Komunal dhe është aprovuar në Kuvend.
- Aktivitete në përgatitjen e procesit të Hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK).
- Në proces të krijimit të Bazës së të dhënave (DTB-së) në bashkëpunim me GIZ-in Gjerman.
- Janë formuar këshillat dhe grupet punuese për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal(PZHK).

Në sektorin e planifikimit janë shqyrtuar 41 kërkesa të ndryshme

Kërkesa për dhënie të informatave urbanistike

Nga **33** kërkesa, gjithsej

- **33** të shqyrtuara,
- s’ka në proces.
- vërtetime me pagesë
- vërtetime të liruara nga pagesat janë

Kërkesa për dhënie të kushteve urbanistike - ndërtimore

Nga **9** kërkesa gjithsej të shqyrtuara:

- kërkesa në proces.....
- vendime për kushtet e ndërtimit të miratuara.....

- vendime për kushtet e ndërtimit të refuzuara.....5

Spektori i Mjedisit

Shpallja e vitit 2018 “vit i ambientit në Komunën e Vitisë”, me vendim të kryetarit të Komunës së Vitisë z.Sokol Haliti:

- Është punuar projekti për muajin e pastrimit, nga 1 Prilli deri më 22 Prill Dita Ndërkombëtare e Tokës;
- Është punuar në grumbullimin dhe sistemimin e informatave për Planin Lokal të Veprimit në Mjedis;
- Gjatë tre muajve të fundit janë larguar 223 tonë mbeturina dhe janë eliminuar një numër i madh i deponive ilegale në disa fshatra të Komunës së Vitisë, ku dhe janë aktivizuar një numër i madh i vullnetarëve;
- Në këtë vit është miratuar në Kuvend Planin Lokal të Veprimit në Mjedis;
- Gjatë muajit shkurt është punuar në rishikim dhe plotësim të Rregullorja për Leje Mjedisore Komunale;
- Janë vizituar dhe listuar objektet dhe zonat e mbrojtura të natyrës;
- Është punuar në ekip komunale për vlerësimin e zbatueshmerisë së dokumenteve të Planifikimit PZHK dhe PZHU-së dhe përgatitjen për hartimin PZHK dhe HZK;
- Është punuar në hartimin e Planin e Menaxhimit të Mbeturinave;
- Jemi në proces të punës për hartimin e Rregullores për Mbeturina;
- Është bërë lista e veprimtarive të cilat duhet të pajisen me LMK në gjithë territorin e Komunës së Vitisë;
- Në terren janë identifikuar disa nga djeponit ilegale të mbeturinave si dhe janë kalkuluar;
- Në vazhdimësi është bërë vlerësimi i gjendjes mjedisore është bërë grumbullim i informatave nga terreni lidhur me çështjet mjedisore;
- Gjatë gjithë muajit prill është bërë aksion për grumbullim të mbeturinave me moton “Pastro dhe Ruaj”. Aksioni është zhvilluar në gjitha fshatrat dhe ka përfunduar në qytetin e Vitisë;
- Në muajin Maj janë bërë përgatitjet për të shënuar “Ditën e Tokës”;
- Me 24 maj është mbajtur aksioni simbolik “Ta Pastrojmë Kosovën”, me ç’rast janë larguar disa deponi të mbeturinave komunale;
- Në muajin Qershor është shënuar “Dita e Mjedisit” me 5 qershorit, ku janë zgjedhur larguar po ashtu disa deponi në disa fshatra;
- Është përmirësuar databaza për hapësirat publike në bashkëpunim me Projektin DEMOS.
- Në bashkëpunim me projektin GIZ, të përkrahur nga qeveria Gjermane, është punuar në sistemimin e Gjeodatabazës në sistemin GIS;
- Në bashkëpunim me Komisionin për dhënien e lejeve mjedisore komunale janë shqyrtuar 5 raporte të vlerësimit të ndikimit në mjedis për dhënien e lejeve mjedisore komunale dhe janë lëshuar 8 leje mjedisore komunale për veprimtari të ndryshme;
- Gjithashtu kemi marr informacione nga kompanitë e shërbimeve publike “Hidromorava” për ujësjellësin dhe “EkoHigjena” e kontraktuar për mirëmbajtjen e qytetit;
- Përgjigje palëve dhe kërkesave të tyre, sidomos për atë se çka parasheh PZHK dhe PZHU për Zona të ndryshme, duke e zëvendësuar sektorin e Planifikimit.

- Kemi lëshuar informacione për qytetar dhe grupe tjera te interesit, për atë se çka është e paraparë në dokumentet e planifikimit sa i përket fushës së mjedisit dhe hapësirës;
- Në vazhdimësi është duke u punuar në Planin Lokal të Biodiversitetit, jemi në fazën e grumbullimit të informacioneve dhe sistemimin e tyre.

Zyra e Adresave

Gjatë kësaj kohe ne si sektor I adresave kemi shqyrtuar 4 kërkesa nga palët për krijimin e rrugëve të reja, ku të gjitha kërkesave ju ka përgjigjur dhe ka dalë dhe verifiku edhe në teren si dhe ka dhënë përgjigje adekuate, pasëshqyrtimit të lëndëve:

- 4 me përgjigje negative për arsye se nuk kanë qenë të kompletuara.

Gjate kësaj periudhe kohore si sektor I adresave kemi pasur edhe shumë palë të cilat kanë qenë të interesuar që të kenë informacione më të shumta rreth sistemit të adresave dhe te marrin informacione për ankesat dhe kërkesat e tyre që kanë bërë për riemërtimin dhe ndryshimin e rrugëve ku nuk janë shqyrtu ende nga komisioni dhe kuvendi komunal dhe ne si sektor i adresave jemi munduar që t'i informojmë realisht rreth shqetësimeve të tyre sa i përket këtyre çështjeve.

Sfidat:

- Një ndër sfidat kryesore të kësaj drejtorie është pamundësia e harmonizimit të kërkesave ndërtimore, sepse ekziston një dallim shumë i madhe në mes të PZHK-së, planeve rregulluese dhe kërkesave të qytetarëve për ndërtim.
- Numër i vogël i personelit profesional, na mungon një ndërtimtar, një specialist i GIS-it dhe një jurist i specializuar për fushën e ndërtimit e që me Ligjin mbi Administrimin e Pushtetit Lokal nuk na lejohet rritja e punëtorëve.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Punët dhe aktivitetet e kryera në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për periudhën Janar – Dhjetor 2018, janë zhvilluar në bazë të programit të punës dhe kërkesave të parashtruara nga qytetarët dhe fermerët në lëmin e prodhimit bujqësor.

Në këtë periudhë raportuese, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural i ka kryer te gjitha procedurat për fermerët që kanë të bëjnë më plotësimin e aplikacioneve, dhënien e këshillave dhe dorëzimin e tyre në MBPZHR, ne mënyrë qe këta fermer te jenë përfitues te mundshëm te subvencioneve dhe grandeve të ndarë nga niveli qendror dhe komuna.

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, gjatë vitit 2018 ka kryer këto aktivitete të punës, gjithmonë bazuar në planin vjetor të punës, të hartuar për vitin kalendarik Janar – Dhjetor 2018.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer këto punë:

- Hartimi i planit të punës vjetor për vitin kalendarik 2018;
- Planet e punës mujore;
- Planet e punës gjashtëmujore;
- Raportet e mujore të punës;
- Punët rutine të kryera;
- Seminare dhe takime të ndryshme;

- Hartimi i projekteve;
- Vizita ne teren, regjistrime, evidenca, statistika, këshilla etj.

1.1 Sektori për Bujqësi dhe Blegtori

- Gjatë këtij viti janë bërë vizita të shumta në teren për grumbullimin e shënimeve në ferma, (është bërë rifreskimi i të dhënave mbi gjendjen në përgjithësi të të gjithë sektorëve të bujqësisë me të dhëna te reja.
- Hartimi i planeve mujore të vizitave në teren, për grumbullimin e shënimeve në ferma.
- Hartimi i planit të mbjelljeve pranverore për vitin 2018.
- Përcjellja e statistikave bujqësore, 64 vizita për këtë qëllim.
- Kontrollimi i tregjeve të gjelbër dhe të kafshëve, 35 kontrollime në bashkëpunim me inspektorët.
- Kontrollimi i materialit fidanor, gjithsej 10 kontrollime.
- Kontrollimi i barnatoreve bujqësore, gjithsej 24 kontrollime.
- Kontrollimi dhe vizita në ferma blegtorale, gjithsej 150 vizita.

Pranimi dhe plotësimi i formularëve si dhe regjistrimi i pronave të fermerëve për subvencione si: grurë, miser, perime në fushë të hapur, pemë, lopë qumështore, dele, dhi, derra, bletë, qumësht sipas cilësisë dhe pula vojse, ku janë pranuar gjithsej **2040 aplikacione**.

- Për subvencione të grurit kanë aplikuar, 676 ermer.
- Për subvencione të misrit kanë aplikuar 430 fermer.
- Për subvencione të perimeve kanë aplikuar, 381 fermer.
- Për subvencione të pemëve kanë aplikuar, 133 fermer.
- Për subvencione të bletëve kanë aplikuar, 80 fermer.
- Për subvencione të deleve kanë aplikuar, 53 fermer.
- Për subvencione të dhive kanë aplikuar, 19 fermer.
- Për subvencione të lopëve qumështore kanë aplikuar, 226 fermer.
- Për subvencione të derrave kanë aplikuar, 3 fermer.
- Për subvencione të qumështit, sipas cilësisë, kanë aplikuar 35 fermer.
- Për subvencione të pulave vojse kanë aplikuar, 4 fermer.
- Vizitë ,(inspektim), mullinjve për verifikimin e masave të marra për kryerjen e 3 DDD. Janë vizituar të gjitha depot e mullinjve (2 mullinj), së bashku me inspektorin e bujqësisë.
- Sektori për bujqësi dhe blegtori ka përcjellur fushatën e korrje shirjes gjatë muajit korrik. Në komunën tonë kanë qenë të mbjellur 5006 ha me grurë, ndërsa numri i autokombajnereve të angazhuar në fushatë ka qenë 104 autokombajner. Fushata ka filluar më 04.07.2017 dhe ka përfunduar më 05.08.2018. Rendimenti mesatar në komunën e Vitisë ka qenë 3800 kg/ha.

1.2 Sektori për Pylltari dhe Zhvillim Rural

- Përgatitja e planit të prerjes në bashkëpunim me APK-në.
- Kryetari i Komunës së Vitisë. ka shpallur vitin 2018 vit të mbrojtjes së pyjeve.
- Në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës së Vitisë, DBPZHR-ja ka hartuar planin operativ për mbrojtjen e pyjeve.
- Vizita në paralelet e prerjes.
- Shqyrtimi i kërkesave për prerje në pyjet private.
- Takime te rregullta me stafin e pylltarisë, realizimi i detyrave të punës.
- Konfiskimi i masave të druve të vëna në qarkullim pa dokumentacionin e nevojshme, ku janë konfiskuar 56.20 m³ dru.

- Gjatë vitit 2018 janë mbyllë me ekskavator mbi 7 rrugë në pyje, me qëllim të pengimit të prerjeve ilegale të pyjeve, ku kanë ndikuar mjaftë në zvogëlimin e dëmeve.
- Gjatë vitit 2018 janë mbajtur disa takime me kryetarin e komunës, komandantin e Stacionit Policor në Viti dhe kryetarin e Gjykatës Themelore - Dega në Viti me qëllim të koordinimit të aktiviteteve për ndalimin e prerjeve ilegale.
- Në bashkëpunim me policinë janë realizuar disa kontrolla rutine në tregje dhe rrugë kyqe, që kanë rezultuar me konfiskim të masës drusore të prerë ilegalisht.
- Gjatë periudhës një vjeçare nga ana e rojeve të pyllit janë bërë gjithsejtë 177 fletëparaqitje për dëme në pyje.
- Gjatë vitit 2018 janë konfiskuar 56.20 m³ dru zjarri.
- Kërkesa të parashtruara për pyje private gjithsej 56 kërkesa.
- Të shqyrtuara dhe miratuara, 56 kërkesa,
- Më datë 01.08.2018, për nderë të ditës së Diasporës, në qendër të qytetit të Vitisë u mbajt panairi bujqësor me moton “T’i ruajmë vlerat tona tradicionale”. Ky panair u organizua nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Grupi Lokal i Veprimit “VITIA”, në bashkëpunim me organizatën Suedeze IKC, ku këtë vit është mbështetur nga Helvetas projekti APR. Qëllimi i këtij panairi ka qenë, që pjesëmarrësit t’i promovojnë prodhimet e tyre, si ato bujqësore, blegtorale, përpunuesit e ujit dhe pijeve alkoolike, ushqime tradicionale, punime artizanale etj.
- Në Fshatin Debelldeh u shënua Dita e Patatës, aktiviteti I organizuar nga DBPZHR-ja dhe Organizata IKC. Ku për qëllim kishe promovimin e patates që prodhohet në Debelldeh dhe cila është e njohur për cilësinë e saj në tërë Kosovën.

1.3 Aktivitete Rutinore

- Gjatë vitit 2018, komisionet komunale për vlerësimin e dëmeve në Bujqësi dhe Blegtori, kanë bërë vlerësimin e dëmeve të shkaktuar nga faktor të ndryshëm, si klimatik, në fusha të ndryshme të bujqësisë dhe blegtorisë, ku vlera totale e dëmeve është **615.995.5 Euro**.
- Organizimi i 30 trajnimeve në bashkëpunim me shërbimin këshillimor të MBPZHR.
- Grumbullimi i të dhënave statistikore.
- Menaxhimi i fermave bujqësore, mbajtja e kontabilitetit dhe librave në ferma (këshilla praktike).
- Grumbullimi i të dhënave statistikore.
- Vizitë të gjithë kombajnerëve rreth përgatitjes teknike të kombajnave dhe verifikimi i numrit të tyre, gjithsej në komunën tonë janë 104 kombajna.
- Takime me organizata të ndryshme: si: APR nga Helvetas, IKC, Agro/USAID, Karitasi i Luksemburgut, etj.

1.4 Të hyrat nga taksat komunale që i përkasin Drejtorisë së Bujqësisë

Duke u bazuar në të hyrat që krijohen nga grumbullimi i taksave komunale nga domeni i bujqësisë, paraqitet kjo gjendje:

Të hyrat nga :

- Ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në atë ndërtimore, 8,056.00 €;
- Certifikata për veprimtari bujqësore, 140 €;
- Të hyrat nga shitja e masës drusore të konfiskuar, 2,736.72 €.

Gjithsej të hyra : 10,932.72 €

1.5 Shqyrtimi i kërkesave të drejtuara përmes arkivit të komunës

Gjatë këtij viti, nga arkivi i komunës kanë arritur gjithsej 119 kërkesa, prej tyre:

| Të bartura viti paraprak | Të pranuar në 2016 | Gjithsej të pranuar | Të miratuara | Të refuzuara | Gjithsej të shqyrtuara |
|--------------------------|--------------------|---------------------|--------------|--------------|------------------------|
| | 119 | 119 | 116 | 3 | 119 |

Kurse, sa i përket kërkesave që i drejtohen drejtorisë pa procedurë të arkivit, numri i tyre është i madh dhe kryesisht kanë të bëjnë me shqyrtimin e mundësisë së subvencionimit të kulturave bujqësore që kultivohen nga ana e tyre.

1.6 Investimet nga komuna dhe organizatat (donatorët) në fushën e bujqësisë gjatë vitit 2018

Komuna e Vitisë dhe Organizata IKC:

1. Janë përkrahur me farë të patates 28 fermer në fshatin Debelldeh.

Vlera e projektit është 10,000.00 euro

Totali: 10,000.00Euro

Komuna e Vitisë dhe projekti Aftësim Për Punësim Rural nga Helvetas:

1. Në muajin Qershor, Komuna e Vitisë ka shpërndarë 22 Motokultivator, ku kanë përfituar 22 fermer. (Bashkëfinancim me Helvetas projekti APR)

Vlera e projektit, 4,158 Euro

2. Në muajin Shtator, kemi shpërndarë 88 bidona të qumështit për 44 fermer

Vlera e projektit, 3,432.00 Euro

3. Në muajin Tetor, kemi shpërndarë 38 rezervuar për ujitje në sektorin e Pemëtarisë:

Vlera e projektit, 2,964.00 Euro

Po ashtu në Tetor kemi shpërndarë 50 hudhëse të plehut mineral për fermerët e sektorit të Lavërtarisë.

Vlera e projektit, 10,200.00 Euro

si dhe 74 Arka druri për fermerët që dorëzojnë prodhimin e tyre në piken grumbulluese dhe përpunuese “Bio-Fruti”

Vlera e projektit, 2,600.00 Euro

Totali i investimeve nga Komuna e Vitisë dhe APR është, 26,354.00

Komuna e Vitisë dhe projekti AGRO/USAID

1. Në muajin Mars është bërë vendosja e stacionit meteorologjik në fshatin Vërban, e cila do t’ju shërbej fermerëve për marrjen e të dhënave meteorologjike.

Vlera e projektit, 3,000 Euro

Investimet nga Komuna e Vitisë dhe Fondacioni Kosovë-Luksemburg

- Përkrahja e fermerëve me serra (Sadovinë e Jerlive dhe Gërmovë) nga FKL dhe Komuna e Vitisë:

1. Janë përkrahur 5 fermer me serra, 1.5 ari në Sadovinë të Jerlive.

Vlera e projektit, 8,762.90 Euro

2. Janë përkrahur 4 fermer me serra, 1.5 ari dhe 1 serrë 2.5 ari në Gërmovë.

Vlera e projektit, 9,940.98 Euro

3. Në Skifteraj 17 fermer janë përkrahur me repromaterial për kultivimin e shalqirit

Vlera e projektit, 12,945.50 Euro (Finacuar nga Fondacioni Kosovë-Luksemburg)

4. Janë shpërndarë 5 serra nga 5 ari:

Vlera e projektit, 26,000.00 Euro

Totali i investimeve nga Komuna dhe Fondacioni Kosovë-Luxemburg për vitin 2018 është, 57,649.38€.

Investimet nga Komuna e Vitisë dhe UNDP-ja

1. Janë përkrahur 35 fermer me serra, nga 2 ari
Vlera e projektit, 75,215€
2. Janë përkrahur 10 përfitues me grande nga LDF
Vlera e projektit, 80,000€
3. Janë ndërtuar 13 shtëpiza nga druri
4. **Vlera e projektit, 22,000€**
5. Janë trajnuar 10 persona për biznese fillestare dhe janë pajisur me mjete të punës,
Vlera e projektit, 7,000€

Totali i investimeve nga Komuna e Vitisë, ne bashkëparticimim me UNDP-në për vitin 2018 është, 184,215.00€

Vlera e donacioneve në fshatrat e Komunës së Vitisë nga organizata Women for Women (përkrahur nga Agro/USAID), është:

| Nr | Fshati | Lloji i imputit | vlera€ | Projekti |
|----|--------------|--|----------------|------------------|
| 1 | Skifteraj | Gypa dhe foli për serra, pleh mineral | 3500 | Subgrant nga ë4ë |
| 2 | Skifteraj | Fidane për bimë mjekësore, aromatike | 5900 | Agro USAID |
| 3 | Debelldeh | Fidane për bimë mjekësore, aromatike | 2700 | Agro USAID |
| 4 | Beguncë | Fidane për bimë mjekësore, aromatike | 1080 | Agro USAID |
| 5 | Goshicë | Fidane për bimë mjekësore, aromatike | 720 | Agro USAID |
| 6 | Skifteraj | Tharëse 24 m ² për terjen e B M A | 17000 | Agro USAID |
| | Totli | | 30,900€ | |

Totali i investimeve në Bujqësi nga Komuna me donator është, 302,118.38 €

Investimet e Komunës së Vitisë ne infrastrukturën rrugore bujqësore dhe lumenjve

- Rregullimi i rrugëve bujqësore, thuajse në të gjitha fshatrat e Komunës së Vitisë. Gjithsej janë rregulluar 10 rrugë bujqësore, në gjatësi prej: 11019 m gjatësi (11.02 km)

Vlera e projektit, 74,955.00 Euro

- Pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe proçkave, ku është pastruar një pjesë e shtratit të lumit “Morava”, prrocka Kabash-Gilbush, Prrocka Smirë-Drobesh, Prrocka Beguncë-Viti dhe Prrocka Goshicë-Gërmovë-Gilbush

Vlera e projektit, 49,020.00 Euro

Totali i investimeve nga Komuna e Vitisë në rrugë bujqësore dhe lumenj, 123,975.00 €

1.7 Investime nga MBPZHR

- **Grandet**
 - a. Nga Ministria e Bujqësisë kanë përfituar grande 6 fermer, të fushave të ndryshme të bujqësisë. Vlera te investimeve nuk është e publikuar nga MBPZHR-ja.
- **Pyllëzimet**
 - b. Gjatë vitit 2018 janë pyllëzuar 20/ha nga MBPZHR, gjegjësisht Agjensionin Pyjor i Kosovës.
- **Subvencionet**
 - c. Gjatë vitit 2018 kanë përfituar subvencione 2040 fermer nga fusha të ndryshme të bujqësisë.

Vlera totale e përfituar nga ana e fermerëve vitias është, 871,790.42€.

1.8 Shuma e përgjithshme e investimeve në bujqësi, nga Komuna, Ministria dhe donatorët gjatë vitit 2018

| INVESTUESI | SHUMA |
|---|----------------------|
| Komuna e Vitisë dhe donatorët | 302,118.38 € |
| Ministria e Bujqësisë (vetëm subvencionet pa grande) | 871,790.42 € |
| Investimet e Komunës së Vitisë ne infrastrukturën rrugore bujqësore | 123,975.00 € |
| Totali i investimeve për vitin 2018 | 1,297,883.8 € |

Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi

Me qellim te rritjes se transparencës ndaj qytetarëve dhe obligimeve ligjore, të bazuar me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë dhe udhëheqjen e Pushtetit lokal, akteve tjera të cilat në mënyrë të veçantë rregullojnë punët dhe shërbimet që i ofron Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi, janë si bazament kryesor i paraqitjes se këtij raporti vjetor për periudhën Janar-Dhjetor 2018.

Puna dhe objektivat e DKPGJ-se, kanë qenë të bazuar ne planin e punës për vitin 2018, po ashtu kërkesave te palëve si te personave fizik ashtu edhe te atyre juridik. Shërbimet e ofruar nga DKPGJ-ja ne vitin 2018, kanë qenë 100% ne shërbim te qytetarëve, duke i tejkaluar planifikimet. Kjo e bënë qe te rritet performanca dhe transparenca ne raport me qytetarin. Duke u rritur rëndësia e shërbimit me efikas dhe brenda kornizave ligjore po rritet edhe transparenca e DKPGJ-së ndaj qytetarit.

Synimi ynë në 2018 ka qenë shërbimi dhe shqyrtimi i të gjitha kërkesave/lendeve brenda afateve ligjore dhe ne mënyrën me te mirë te mundshme, te cilin synim e kemi arritur. Ketë mund ta vëreni edhe ne kapitujt e mëposhtëm te këtij raporti.

Sektori i Kadastrit

Puna në Sektorin e Kadastrit është e bazuar në dispozitat ligjore, të cilat e rregullojnë këtë sektor, i cili është përgjegjës për kujdesen dhe mirëmbajtje e të gjitha regjistrave kadaslral, ku përfshihet e gjithë paluajtshmeria komunale, si dhe regjistri i paluajtshmerive, hipotekave, servituteve digjitale dhe manual, si shërbim kryesor për qytetarët si shërbimi me lëshimin e fletave poseduese, çertifikatave personale dhe social.

Gjatë kësaj periudhe në këtë sektor janë kryer këto shërbime kadastrale:

| Muaji | Fleta poseduese Me/pa pagës | Certifikata për 1 sociale | Hipoteka | Transaksione Pronësore |
|---------|-----------------------------|---------------------------|----------------|------------------------|
| Janar | 238me/7pa | 66copë | 5regj/5c'regj | 44 lëndë |
| Shkurt | 435me/18 pa | 39 copë | 5 regj/3ç'regj | 51 lëndë |
| Mars | 1290 me/3 pa | 88copë | 8 regj/4ç'regj | 66 lëndë |
| Prill | 610me/5pa | 35cop | 3regj/3ç'regj | 63lëndë |
| Maj | 239me/7pa | 40cop | 6regj/3ç'regj | 67 lëndë |
| Qershor | 221me/9pa | 75cop | 7 regj/1ç'regj | 69lëndë |
| Korrik | 278 me/10pa | 94copë | 5regj/5c'regj | 60 lëndë |
| Gusht | 329me/9 pa | 80 copë | 3regj/2c'regj | 123 lëndë |

| | | | | |
|----------------|------------|---------|-----------------|----------|
| Shtator | 294me/5pa | 48 copë | 3regj/6c'regj | 75 lëndë |
| Tetor | 287me/3pa | 58 copë | 9 regj/4c'regj | 99 lëndë |
| Nëntor | 199me/3pa | 35copë | 6regj/3c'regj | 50 lëndë |
| Dhjetor | 324me/4pa | 38 copë | 7regj/2c'regj | 84 lëndë |
| Totali | 4744/83 pa | 696copë | 67regj/41ç'regj | 851lëndë |

Tabela nr.1 Shërbimet kadastrale 2018




Fig.1 Shërbimet kadastrale sipas llojit të shërbimit

Sektori i Pronës

Sektori i pronës ka përgatitë 9 propozim vendime për Bordin e Drejtove dhe Kuvendin Komunal. Në lidhje me natyrën e punëve në drejtori, në vazhdimësi ka bërë interpretimin e normave ligjore që janë në fuqi, ka kryer punë administrative në drejtori: përpilimin e aktvendimeve, urdhëresave dhe akteve tjera, ka lëshuar vërtetime për pronat që komuna nuk ka interes t'i blejë ato. I ka pranuar kërkesat e drejtuara drejtorisë, i ka shqyrtuar ato dhe ju është përgjigjur me shkrim. Ka zhvilluar procedurat për eksproprijim të tokave në pronësi private për interesa të përgjithshme publike.

Sektori i Gjeodezisë

Sektori i Gjeodezisë për gjatë vitit ka kryer këto shërbime për palët dhe Komunën, si: ka mirëmbajt kadastrën digjitale në sistemin kosovar f01, ka përcjell vektorizimin e raster planeve, ka përgatitë dhe mbikëqyrë të dhënat për kompanitë dhe gjeodetët e licencuar, ka përgatitë raportet ditore për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ka pranuar lëndët e kryera nga kompanitë dhe gjeodetët e licencuar dhe të njëjtat i azhurnon në sistemin zyrtar (SIKTK-T dhe SIKTK-G), ka bërë azhurnimin e ndarjeve fizike në librat e regjistrimeve të ndarjeve kadastrale, ka bërë Hartimin e kopjeve të Planit, kontroll të vazhdueshëm, kualitetit të të dhënave grafike kadastrale dhe atyre tekstuale, projektim të rrjeteve referente, të rendit të tretë të shtruar me GPS, Identifikim i parcelave në zyrë. Futja e të dhënave grafike në datamodelin zyrtar (SIKTK-G).Konsulta dhe këshilla profesionale në lëminë e Gjeodezisë dhe Kadastrës, për palët e interesuara në kuadër të shërbimeve kadastrale.

| Muaji | Lëndë nga te Me pag. | Kopjet planit Me pag/pa pag | Produkte për kompanitë pr | Ndarje/azhurnime | Bashkim i pa | Ndërrim kulture |
|---------------|----------------------|-----------------------------|---------------------------|--------------------------|--------------|-----------------|
| Janar | 0 | 66cop/2 cop | 10 | 10ndarje/970azhurim | 2bashki | |
| Shkurt | 1 lënd | 73cop/2cc | 12 | 50 ndarje | 5bashki | |
| Mars | 0 | 153 copë/2cc | 9 | 9ndarje/25azhurim | 1bashki | |
| Prill | 1 lënd | 89cop/2cc | 5 | 5ndarje/15azhurim | 1 | |
| Maj | 1 lënd | 71cop/2cc | 9 | 3ndarje/30azhurim | 0 | |
| Qershor | 1 lënd | 66 copë/2cc | 6 shërbir | 6ndarje/12azhurime | 0 | 1 |
| Korrik | 4 lënd | 95cop/2cc | 16 | 15ndarje/45azhurim | 2 | |
| Gusht | 3 lëndë | 115cop/2cop | 11 | 15ndarje/47azhurime | 1bashkim2b | 1ndërrim |
| Shtator | 5 | 100cop/1cop | 17 | 16ndarje/72azhurime | me | 4ndrrime |
| Tetor | 2 lëndë | 118cop/0 | 18 | 18ndarje/48azhurime | 3bashkim | 2 ndërrime |
| Nëntor | 1 lëndë | 93cop/0 | 11 | 12ndarje | 2bashkim | |
| Dhjetor | 1 lëndë | 116cop/0 | 10 | 9ndarje | 0 | |
| Totali | 12 lëndë | 1155cop/17 | 134 | 168 ndarje/1264azhurnime | 19 | 8 ndërrime |

Tabela Nr.3 Shërbimet në sektorin e Gjeodezisë




Fig.3 Llojet e shërbimeve kryesore në sektorin e Gjeodezisë

Të hyrat financiare

Në Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi, planifikimi i të hyrave buxhetore, duke përfshirë të gjithë sektorët, ka qenë 81,000.00 €, kurse realizimi i të hyrave për këtë periudhë është 85,737.55€, pra, kemi arrit të tejkalojmë planifikimin e të hyrave financiare dhe të arrijmë të përmbushim një nga objektivat kryesore të punës së kësaj drejtorie, ku kthyer në përqindje tejkalohen 105.85%.

Sfidat

Pengesat të cilat i përcjell këta Sektor janë:

- Mungesa e shënimeve prej vitit 1985 – 1999.
- Lidhjet e dobëta digjitale në bazën e të dhënave dhe shpeshherë ndërprerja e tyre kohë pas kohe me Agjencinë Kadastrale të Republikës së Kosovës.
- Mungesa e shënimeve gjeodezike nga viti 1985 – 1999.
- Mungesa e planeve/skicave për zonat kadastrale. të cilat janë pjesë të komasacionit.

Propozim masat të cilat duhet të merren për efikasitet janë:

- Insistimi i faktorëve institucional, vendor dhe ndërkombëtar tek Institucionet e Serbisë për kthimin e shënimeve kadastrale dhe gjeodezike, respektivisht planeve gjeodezike.
- Insistimi i institucioneve vendore dhe i mekanizmave ndërkombëtar tek institucionet e Serbisë, për kthimin e dokumentacionit kadastral, të konfiskuar (grabitur gjatë luftës).
- Përpjekjet për përmirësimin e lidhjeve digjitale në bazën e të dhënave me Agjencionin Kadastral të Republikës së Kosovës

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

a. Sektorët DKRS-së: Kulturë, Rinidhe Sport

DKRS, gjatë vitit 2018 ka subvencionuar 18 organizata Jo-qeveritare në vlerë 82,045.60€ për implementimin e projekteve, krahas kësaj ka realizuar të gjitha aktivitetet sipas kalendarit në planin e punës, duke shënuar aktivitetet nga kalendari statutar, mbarëkombëtar, ndërkombëtar dhe nga kalendari inovativ.

Përveç aktiviteteve tradicionale dhe atyre zyrtare, si: “17 Shkurti – Dita e Pavarësisë së Kosovës”, Manifestimi Kulturor dhe Sportiv “Flakadani i Karadaku”, Manifestimi Tradicional “Takimet e Dom Mikeli”, Maratona e Fotografisë, Festivali për Fëmijë “Tingulli Fest”, Ditët e Rinisë, Ditët e Diasporës, Dita e Dëshmorëve të Atdheut, Dita e Çlirimit të Komunës së Vitisë 14 Qershor, 28 Nëntori Dita e Flamurit Kombëtar, Dita e Evropës, Dita e Fëmijëve, Dita Botërore e Lirisë së Shtypit, DKRS këtë vit nga kalendari inovativ ka realizuar aktivitete si Shfaqje të filmave në Kinemanë e Qytetit, Shfaqje Teatrale, Ekspeditë një ditore “Hiking for 4th“, Ekspozitë e veprave Artizanale, Ekspozita Artistike mbarëkombëtare dhe ndërkombëtare, Promovime të Librave, Shfaqje Baleti, Koncerte të muzikës burimore, Koncerte të Muzikës modern, Koncerte të muzikës Rock, Turnire Futbollit, Turinire në Ping-Pong, Tryeza të rrumbullakëta, Përfshirja e OJQ-ve dhe OSHC-ve në vendimmarrje dhe Aktivitete për rëndësinë dhe njoftimin me Trashëgiminë Kulturorë.

b) Sektori Bibliotekës Publike Komunale

Aktivitetet e zhvilluara gjatë kësaj periudhe janë përfshirë në këtë raport, sipas rëndësisë së aktiviteteve. Është me rëndësi të përmendet, se angazhimi i stafit të bibliotekës ka qenë në nivel, kështuëshu që, performanca e tyre në punë ka qenë e kënaqshme dhe angazhimi i tyre ka qenë në funksion

të përmirësimit të shërbimeve për lexuesit, që njëherë është edhe mision parësor i Bibliotekës, ofrimi cilësor i shërbimeve.

Autorët të cilët dhuruan bibliotekës tonë, botimet e tyre:

A U T O R Ë T T I T U J E K Z E M P L A R Ë

- **Feri ARIFI** – dhuroi tre tituj me dhjetë ekzemplarë
- **GAZMEND AVDI ARIFI** - katër ekzemplarë
- **Bleona SYLEJMANI** – Vërban, dhuroi pesë ekzemplarë
- **Hamdi V. THAQI** - dhuroi pesë ekzemplarë
- **Berat LUZHA** - dhuroi katër ekzemplarë
- **Sinan GASHI** - dhuroi trembëdhjetë ekzemplarë me trembëdhjetë tituj;
- **Marjan SOPI** - dhuroi pesë tituj, me dhjetë ekzemplare
- **Nazif LAÇI** – dhuroi tre ekzemplarë
- **Hasan HASANI** - dhuroi dy ekzemplarë
- **Tahir DALIPI**, dhuroi tre ekzemplarë
- **Mursel Sh. MURSELI** - dhuroi tre ekzemplarë
- **Zymer HALITI** - dhuroi tre ekzemplarë
- **Xhavit SAHITI** - dhuroi tre ekzemplarë
- **Isa DEMIRI - KALAVESHI** - dhuroi pesë ekzemplarë
- **Shaban SHEMSIU** - dhuroi gjashtë ekzemplarë
- **Nijazi AZEMI** - dhuroi dy ekzemplarë
- **Jusuf BUXHOVI** - dhuroi 19 tituj me 25 ekzemplarë

Biblioteka Publike Komunale, është mirënjohëse për gjithë ata që dhurojnë botimet e tyre, por edhe ata të cilët japin donacion.

Në këtë vit, fondi i librave në Bibliotekë është pasuruar me;

T I T U J E K Z E M P L A R Ë235715

Takime dhe angazhime tjera

Gjatë muajit dhjetor 2017 dhe janar 2018, kemi hartuar dhe kemi raportuar me kohë të gjitha institucioneve përgjegjëse, që janë kërkuar në formë fizike apo elektronike:

- Raporti vjetor, Janar – Dhjetor 2017, DKRS – Viti.
- Plani i Punës për vitin 2018, DKRS- Viti.
- Hartimi i projektit, për pasurimin e fondit librar, dorëzuar MKRS-it.
- Statistika e Bibliotekës për vitin 2017, dorëzuar BKK - Prishtinë.

Ç’ do fillim te vitit, lexuesit pajisen me librezat e reja.

Pas përpunimit (klasifikimit, katalogimit, inventarizimit), gjatë këtij viti janë shpërnda nëpër sektor dhe degë të bibliotekës këto libra:

Spektori për të vegjlit 81 tituj me 360 ekzemplarë,
Spektori për të rriturit70 tituj me 120 ekzemplarë,
Dega e Bibliotekës në Pozheran103 tituj me 189 ekzemplarë,
Dega e Bibliotekës në Sllatinë të Epërme..... 136 tituj me 176 ekzemplarë.

Në këtë vit janë përpunuar **390** tituj me **845** ekzemplarë

Përpunimi i librave është bërë në kohë të duhur, sipas rregullave bibliotekare si dhe sipas klasifikimit, **KDU**

Biblioteka është me e frekuentuar ne sektorin e te vegjelve ne muajin janar, ndërsa në sektorin e te rriturve ne muajt korrik, gusht ,shtator nga studentet.

Regjistri i lexuesve sipas numrit për vitin 2018

| Bibliotekat | Amë për të | Amë për të rr | Dega Pozheran | Dega Sllatinë Epërme | Gjithsej |
|--------------------------------------|------------|---------------|---------------|----------------------|----------|
| Numri i përgjiths anëtarëve | 418 | 242 | 381 | 373 | 1414 |
| Numri i përgjiths librave të lexuara | 2353 | 3235 | 3302 | 4134 | 13024 |

| | |
|--|-----|
| Totali i titujve të dhuruar BPK-së, nga autorë të ndryshëm | 235 |
| Totali i ekzemplarëve të dhuruar BPK-së, nga autorë të ndryshëm | 715 |

Rritja e Fondit Librar gjatë vitit 2018:

| Tituj | Ekzemplarë |
|-------|------------|
| 31 | 25 |

Sektori i Arkivit Historik gjatë vitit 2018

Arkivi Historik Komunal ka për qëllim promovimin dhe avancimin e punës rreth mirëmbajtjes në përgjithësi të lëndës arkivore që gjendet nën menaxhimin e Arkivit, dhënies së këshillave për fondkrijuesit në procesin e klasifikimit, ruajtjes, asgjësimit dhe dorëzim-pranimit të lëndës, e cila ka afat të përhershëm të ruajtjes në Arkiv. Arkivi Historik punon në planin e brendshëm, duke u bazuar në funksionimin e tri referateve kryesore si: Shërbimi i brendshëm që ka për detyrë rregullimin e lëndës në Arkiv, shërbimi jashtëm që merret me kontrollimin e lëndës tek fondkrijuesit dhe puna me palë apo dhënia në shfrytëzim e lëndës për nevoja private dhe zyrtare.

Këtë vit është bërë evidentimi dhe klasifikimi I tërë materialit arkivor në kuadër të Arkivit Historik.

| Kërkesa të shqyrtuara | Kërkesa të realizuara | Kërkesa të Refuzuara |
|-----------------------|-----------------------|----------------------|
| 188 | 114 | 74 |

Aktivitetet në Qendrën e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”

Hapësirat e qendrës së kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani” gjatë vitit 2018, janë shfrytëzuar nga Institucionet Komunale, organizatat tjera qeveritare, organizata Jo-Qeveritare vendore dhe ndërkombëtare, partitë politike për aktivitetet e tyre përkatëse.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur numri i aktiviteteve sipas muajve:
Statistika tabelare e aktiviteteve për periudhën Janar- Dhjetor/2018

| Pasqyra tabelare e aktiviteteve të mbajtura në Shtëpinë e Kulturës, në periudhën janar – dhjetor/ 2018 | | | | | | | | |
|--|------------------------|-------------|------------|---|-------------|------------------------|------------|--------------|
| | Institucionet komunale | OJQ-të | Ekspozita | - Çfaqje filmi -Dokumentar -Teatri -Baleti | Promovimi | Personat p (Libri). | Partitë p | Gjithsej |
| Nr.i aktiviteteve për kalendarik Janar-dhjetor | 108 | 105 | 7 | 7 | 9 | 4 | 1 | 241 |
| Nr. i pjesëmarrësve | 8397 | 3441 | 570 | 2100 | 1380 | 650 | 100 | 16638 |
| Nr. i aktiviteteve gjatë vitit 2018 | Gjithsej 241 | | | | | | | |

Investime kapitale

1. Rehabilitimi i kulmit të Shtëpisë së Kulturës, si projekt i Bashkimit Evropian, i kontraktuar nga Sh.p.k”Rafi”,nga Rahoveci ka kushtuar = 1,82000.00 €.
2. Rehabilitimi i Objektivit në hapësirat e jashtme dhe të brendshme, si projekt MKRS-së dhe Komunës së Vitisë, është kontraktuar nga Ndërmarrja ”Enginjeering”, nga Vitia në afat dyvjeçar në vlerë 2,48605.55 €.

Fusha e Sportit dhe Rinisë

RAPORT FINANCIAR

Aplikimi me projekte infrastrukturore në ministrin e kulturës, rinisë dhe sportit

- Projekti për fushën sportive në Beguncë.
- Projekti për fushën sportive (Futboll, Volejboll, Basketboll) te Palestra sportive.
- Projekti i fushës sportive për Tenis te Palestra sportive.
- Projekti i fushës sportive për Volejboll me rërë te Palestra sportive.

Investimet kapitale në infrastrukturën sportive dhe moniterimi


- **Vazhdimi i ndërtimit të Palestrës sportive në Drobesh** – vazhdimi punës sipas planit dinamik nga 2017 dhe 2018, përfundim i punimeve të vrazhda.
- Pas çdo vizite në vend punishte të Palestrës janë publikuar foto materiale nga progresi i punimeve në ndërtimin e Palestrës. Fotot janë publikuar në internet në rrjetin social FCB, dkrs.viti@facebook.com
- **Vazhdimi i renovimit dhe ndërtimit të stadiumit të KF. Vitisë** – vazhdim nga 2017 por në 2018 rifillimi i punimeve filloj pas shtatorit me vërejtje serioze nga inspeksioni i MKRS. Punimet nuk kanë shkuar sipas planit dinamik me vonesa te pa arsyeshme.

- Në vazhdimësi është monitoruar procesi i punimeve në ndërtimin e stadiumin e qytetit të Vitisë dhe secilën here janë bërë foto dhe janë publikuar në faqen e internetit, si dëshmi për ecurinë e zhvillimit në implementimit te projektit në renovim dhe ndërtim te stadiumit.
- **Renovimit dhe ndërtimit të stadiumit të KF “Vllaznia” në Pozheran - 419,000€.** Punimet nuk janë zhvilluar sipas dinamikës së parapa. Gjatë vizitës kryesia e klubit shpreh pakënaqësitë për ngecjet e punimeve në stadium.
- Monitorimi i zhvillimit te punimeve në stadiumin e KF “Vllaznia” në Pozheran është bërë kohë pas kohe, duke bërë fotografi dhe publikuar ato ne faqen e internetit, rrjeti social FCB dksr.viti@facebook.com. Fotografitë janë dëshmi materiale të punimeve.
- **Ndërtimi i stadiumit ndihmës ne Sodovinë J.** - Projekti i nënshkruar me 22 Janar/2018, financuar nga MKR 100,000€, FFK 120,000€ dhe Komuna 30,000€ =, **250,000€.** Punimet akoma nuk kanë përfunduar sipas parashikimeve. Ngecin punimet në hapjen e kanalit për rrjedhën e ujit të drenazhimit nga stadiumi.
- Procesi i ndërtimit të stadiumit është monitoruar nga fillimi i ndërtimit deri në fund të viti 2018 në zhvillimin e punimeve në stadium, kohë pas kohe janë bërë fotografi janë publikuar ato ne faqen e internetit, rrjeti social FCB dksr.viti@facebook.com
- **Ndërtimi i 8 fushave sportive ne lokalitetet:** Trestenik, Buzovik, Ramnisht, Ballancë, Sllatin E, Gërmovë, Radivojc dhe Beguncë me vlerë prej = **76,655 €**
- Monitorimi i punimeve në ndërtimin e 8 fushave sportive në 8 fshatra ku janë bërë fotografi dhe janë postuar ato ne faqen e internetit, rrjeti social FCB dksr.viti@facebook.com


Totali i investimeve kapitale në infrastrukturën sportive, 745,655. €

Tabela grafike paraqet përfituesit e subvencioneve nga fondet e DKRS-së dhe kryetarit Komunës në shumë prej = 63,795.60€.

Tabela grafike paraqet përfituesit e subvencioneve nga fondet e DKRS-së dhe kryetarit komunës në shum prej = 63,795.60€



Subvencionimi sipas përqindjes %



Fusha e sportit

- Investimet kapitale në ndërtimin e infrastrukturës sportive në vazhdimin e ndërtimit të Palestrës së Sporteve, Stadiumit të qytetit të Vitisë, Stadiumit të Pozheranit, Stadiumit të Sadovinës të Jerlive si dhe ndërtimin e 8 fushave sportive në 8 lokalitete te komunës së Vitisë.
- Mbështetja financiare e të gjitha e klubeve sportive nga kodi buxhetor me subvencione si dhe me shërbime dhe mallra.
- Mbështetja financiare e të gjitha garave sportive disa me shërbime dhe mallra, disa me subvencione.
- Fuqizimin e turneve sportive si nga ato të rregulluara me statut po ashtu edhe ato gara që organizohen nga komunitetet sportive (fshatrat) .
- Mbështetja dhe fuqizimi i iniciativave nga grupet sportit formale dhe joformale për aktivitete të ndryshme.


Fusha e rinisë

- Bashkëfinancimi i disa projekteve me organizatat ndërkombëtare në ngritjen e kapaciteteve. për vetëpunësim për rini si “Helvetas”, “Help”, “USAID”, etj.
- Subvencionimin e KVRL si përfitues i 15% nga fondet e DKRS-së.
- Subvencionimin e organizatave tjera rinore për shërbime rinore.
- Promovimin e talenteve të rinj në fushat e rinisë.
- Përmirësimin e shërbimeve rinore me Qendrën Rinore.

Shpërndarja e subvencioneve për projektet në fushën e kulturës

Subvencionet për kulturë

| Nr. | Përshkrimi | Shuma |
|----------------|-------------------------------------|--------------------|
| 1 | AKV "Kemajl Azizi" | 6,000.00 |
| 2 | AKVB "Dasma" | 2,000.00 |
| 3 | OJQ " Tingulli" | 2,300.00 |
| 4 | OJQ " Legjenda" | 1,200.00 |
| 5 | OJQ Q. K. "Anamorava" | 2,400.00 |
| 6 | Manifestimi "Takimet e Dom Mikelit" | 2,000.00 |
| 7 | SHKA "Jonuz Ramadani" | 1,450.00 |
| 8 | Autori vendor Sami Arifi | 400.00 |
| 9 | Erta Ramadani | 700.00 |
| Totali: | | € 18,450.00 |



| Përfituesit e subvencioneve | | | Kodi buxhetor | | Totali në | Totali për kod buxh | | Totali bux për të kodet |
|-----------------------------|----------------------|----------|------------------------------|-----------|-----------|---------------------|----------|-------------------------|
| Nr. | Organizata | Spektori | Drejtoria Kulturë, dhe Sport | Zyra e Kr | | DKRS | ZK | |
| | | | | | DKRS; Z | 15,050.00 | 3,400.00 | 18,450.00 |
| 1. | AKV "Kemajl Azizi" | Kulturë | 6,000.00€ | | 6,000.00 | | | |
| 2. | AKVB "Dasma" | Kulturë | 2000.00 € | | 2,000.00 | | | |
| 3. | SHKA "Jonuz Ramdani" | Kulturë | 1,150.00 € | 300.00 € | 1,450.00 | | | |

| | | | | | |
|----|---|---------|------------|------------|----------|
| 4. | OJQ "Tingul" | Kulturë | 2,300.00 € | | 2,300.00 |
| 5. | OJQ "Legjend" | Kulturë | 1,200.00 € | | 1,200.00 |
| 6. | OJQ "Anamorava" | Kulturë | 2,400.00 € | | 2,400.00 |
| 7. | Manifestimi tradicional "Takimet e Mikelit" | Kulturë | | 2,000.00 € | 2,000.00 |
| 8. | Erta Ramda Festivali ndërkombëtar | Kulturë | | 700.00 € | 700.00 € |
| 9. | Sami Arifi - vendor | Kulturë | | 400.00 € | 400.00 € |

| Kulturë | Rini | Sport |
|--------------|-------------|-------------|
| 18,450.00 € | € 11,555.60 | 52,040.00 |
| Shuma Totale | | 82,045.60 € |

Indikatorët e suksesit

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në vazhdimësi bënë rishikimin dhe analizat e politikave publike, ku vlerëson punën e bërë, opinionet e qytetarëve, hulumtimet nga matja e barometrit të rezultateve nga organizatat të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

Indikatorët e suksesit:

- I. Konsultimi dhe pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje.
- II. Transparenca
- III. Pjesëmarrja e grupeve Formale dhe Joformale dhe e qytetarëve në aktivitete si dhe në implementimin e aktiviteteve
- IV. Publiciteti multimedial i informimit të publikut
- V. Pasqyrimi i kronikave dhe transmetimeve të drejtpërdrejta televizive për qytetarë nga aktivitetet
- VI. Prezantimi i aktiviteteve për opinionin publik përmes TV, Radiove, Rrjeteve sociale, faqeve zyrtare të internetit, etj.
- VII. Shikueshmëria e video materialeve të aktiviteteve të drejtorisë të transmetuara në televizion dhe në arkiv të televizionit lokal "Plus TV"

- VIII. Informimi dhe komunikimi i publikut përmes internetit veçanërisht faqet zyrtare të informimit si dhe rrjeteve sociale nën menaxhimin zyrtar
- IX. Qasja e qytetarëve në informata
- X. Kycja e grupeve vullnetare në aktivitete
- XI. Vlerësimi i qytetarëve për aktivitetet dhe punën e Drejtorisë
- XII. Formularët e aplikimit për përfitimin e subvencioneve përmes projekt propozimit

Viti, Janar 2019

Kryetari i Komunës
Sokol HALITI
